

SiCRED
Shoqëri Sigurimi Jete


RAPORTI VJETOR 2019

Përmbajtja

1. Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm.....5
2. Mbi shoqërinë SiCRED sh.a. 6
3. Pronësia dhe Organet Drejtuese të SiCRED sh.a. 7
4. Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2019 10
   4.1 Treguesit financiarë kryesorë të SiCRED sh.a. në periudhën 2015-2019.....12
   4.2 SiCRED rishikon strategjinë e saj, shet një pjesë të kuotave aksionare të zotëruara në CREDINS Invest.....13
   4.3 Bashkëpunime dhe përfitime ekstra për publikun.....13
   4.4 Platforma e rezervimit online të takimeve.....13
   4.5 Zgjerimi i Rrjetit Mjekësor SiCRED.....15
   4.6 Pjesëmarrje të suksesshme.....15
   4.7 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore.....16
   4.8 SiCRED dorëzon fondin e sigurimit për besnikërinë "Jeta me Kursim", për të tretin vit radhazi.....17
5. Objektivat e shoqërisë SiCRED sh.a. për vitin 2020.....18
6. Zhvillimet kryesore të shoqërisë CREDINS Invest sh.a. gjatë vitit 2019.....19
7. Një përmbledhje e ngjarjeve të 2019 për SiCRED Assistance.....20

RAPORTI I AUDITIT TË BRENDSHËM 22

Të dhënat për SiCRED sh.a. (31 Dhjetor 2019):



1. Mesazhi i Drejtorit të Përgjithshëm



Lexues të nderuar,

Kam kënaqësinë të ndaj me ju Raportin Vjetor dhe ngjarjet më të rëndësishme të shoqërisë SiCRED sh.a. për vitin 2019!

Për shoqërinë SiCRED sh.a., viti 2019 ishte një vit pozitiv në tërësinë e tij, i cili u pasqyrua me rritjen e të ardhurave dhe përmirësimin e treguesve kyçë financiarë të shoqërisë.

Gjatë vitit 2019, primet e shkruara bruto arritën në 289 milionë lekë dhe 47 milionë lekë ishin dëmet e paguara. Kryesisht pozitiv ishte ky vit për produktet afatgjata të sigurimit të jetës me elementë kursimi, ku, gjatë këtij viti, Sigurimi Jetë me Mbijetesë, një produkt sigurimi jete me Shumë të Garantuar për jetë dhe mbijetesë, shënoi një rritje prej 50%, e ndërsa vijoi tradita e shpërndarjes së përfitimeve nga Fondi i Besnikërisë "Jeta me Kursim", për brezin e tretë të punonjësve, që përmbyllën me sukses kohëqëndrimin 7-vjeçar në punë.

Aktiviteti i SiCRED Assistance sh.p.k., për vitin 2019, solli vlera të reja për shoqërinë, të cilat siguruan bilanc pozitiv, si dhe likuiditetet e nevojshme për të mbështetur sfidat e aktivitetit.

Ndër arritje të tjera, viti 2019 shënoi realizimin e dy kontratave të para të ndërmjetësimit në punësim, duke konfirmuar kështu aftësitë dhe kapacitet e shoqërisë për të vepruar në këtë sektor me vetëbesim edhe profesionalizëm.

Viti 2019 shënoi një qasje pozitive edhe ndaj promovimit të veprimtarisë së subjektit SiCRED Assistance sh.p.k.. Shoqëria, në bashkëpunim me subjektin Isttituto Auxologico Italiano, realizoi, në Tetor të vitit 2019, konferencën rajonale me subjekt "Të përmirësojmë shëndetin së bashku".

CREDINS Invest, me Fondin e Pensionit Vullnetar "CREDINS Pension" dhe Fondin e Investimeve "CREDINS Premium", vijoi ecurinë pozitive edhe gjatë vitit 2019, duke punuar në rritjen e numrit të klientëve, shtimin e vlerës së aseteve të fondeve dhe përmirësimin e cilësisë së shërbimit.

Gjatë vitit 2020 sfida të reja na presin. Do të vijojmë punën e nisur në 2019-ën, për të ofruar produkte të reja të sigurimit, të cilat do të jenë një risi në tregun shqiptar, me më tepër përfitime dhe avantazhe për klientët. Do të vijojmë me përpjekjet për të punuar drejt edukimit të publikut mbi fushën e sigurimit të jetës, me artikujt në blog, informacionet në rrjetet sociale, reportazhe e artikuj në media etj. Bashkëpunimi me klientët do të jetë më i ngushtë edhe përmes trupëzimit të teknikave inbound dhe implementimit të platformës CRM.
Do të punojmë në përmirësimin e imazhit të shoqërisë në degë, për të ofruar komoditet dhe ambiente mikpritëse për klientët, si dhe synojmë të jemi më pranë komunitetit, në të cilin jetojmë, duke dhënë kontributin tonë në nevojat e shoqërisë.

Së fundi, dua të falënderoj klientët tanë, të cilët janë shtysa jonë për të ecur përpara; falënderoj bashkëpunëtorët dhe partnerët shqiptarë dhe të huaj; aksionarët tanë dhe pa dyshim stafin e SiCRED, të cilët me punën, aftësitë dhe përkushtimin e tyre, janë një vlerë e shtuar në tregun e sigurimeve.

Duke ju falënderuar, Ju ftoj të ndajmë së bashku Raportin Vjetor 2019.

Genc Koxhaj
Drejtor i Përgjithshëm

2. Mbi shoqërinë SiCRED sh.a.

Shoqëria SiCRED sh.a. është themeluar në 7 Tetor 2003, duke qenë kështu e para dhe e vetmja shoqëri sigurimi private në Shqipëri me kapital 100% vendas e licencuar për të vepruar në fushën e sigurimit të Jetës. Shoqëria operon në përputhje të plotë me kërkesat ligjore dhe kuadrin rregullator, në bazë të Autorizimit për të vepruar si shoqëri sigurimesh Nr.8 datë 19.07.2004 (zëvendësuar me Licencën Nr.8/2004, datë 22.06.2012), si dhe të Lejes për Ushtrimin e Veprimtarisë në Sigurime, Nr.8/1 datë 10.09.2004.

Me qëllim diversifikimin e aktivitetit, përballimin e rritjes së konkurrencës, ofrimin e një game më të gjerë përfitimesh për klientin dhe zgjerimin e pjesës së tregut, shoqëria SiCRED sh.a. është aksionare në dy shoqëri:

— CREDINS Invest sh.a. - Shoqëria Administruese e Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, e cila ka nën administrim fonde të pensionit vullnetar dhe fonde të investimit. SiCRED sh.a. zotëron 12% të aksioneve të kësaj shoqërie.

— SiCRED ASSISTANCE sh.p.k., e cila ofron shërbime në përputhje me legjislacionin në fuqi, për Sigurinë dhe Shëndetin në punë; Ndërmjetësimin në Punësim dhe Ndërmjetësimin në Shërbime Shëndetësore. SiCRED sh.a. zotëron 100% të kapitalit të kësaj shoqërie.

Punonjësit tanë cilësohen si elementi më i rëndësishëm i suksesit tonë. Stafi i shoqërisë përbëhet nga individë me eksperiencë të suksesshme shumëvjeçare në tregun e sigurimeve, si dhe të shkolluar e trajnuar në institucionet arsimore më prestigjioze vendase dhe të huaja. Puna me sukses në grup, energjia dhe mosha relativisht e re, si dhe investimi që SiCRED sh.a. ka bërë në burimet njerëzore, janë kyçi i suksesit të arritjeve të deritanishme dhe baza e qëndrueshmërisë për periudhat e ardhshme. Aftësitë dhe përkushtimi i këtij stafi cilësor ka krijuar vlerë të shtuar të produkteve dhe shërbimeve tona, duke krijuar një emër të mirë në treg.

1.1 Vizioni ynë

Klienti është fokusi ynë. Vizioni ynë për të ardhmen është që të bëhemi mbështetja kryesore dhe zgjedhja e padiskutueshme e klientit.

1.2 Misioni ynë

Ne synojmë që të operojmë konform standardeve më të larta të etikës, si mënyra e vetme dhe e pranueshme për të bërë një emër të mirë, e forcuar kjo nga premtimi ynë për të përcjellë besueshmëri, duke mbajtur gjithnjë parasysh atë që është më e mirë për klientët tanë. Përmes produkteve tona, synojmë që të krijojmë një kulturë të re sigurimesh në mjedisin shqiptar. Klientët dhe partnerët tanë të biznesit duhet të ndihen plotësisht të kënaqur me zgjedhjen e tyre dhe besimin që kanë treguar duke përzgjedhur shoqërinë SiCRED sh.a. për sigurimin e tyre.





3. Pronësia dhe Organet Drejtuese të SiCRED sh.a.

Organet e larta drejtuese të shoqërisë përbëhen nga :

A. Asambleja e Aksionarëve
B. Këshilli Mbikëqyrës
C. Drejtoria e Përgjithshme

A. Asambleja Aksionare e shoqërisë SiCRED sh.a., e renditur sipas kuotës së aksioneve, përbëhet nga:

		Kuota Aksionare
1.	Z. Aleksandër PILO	46.39 %
2.	Z. Renis TËRSHANA	30.16 %
3.	Z. Maltin KORKUTI	4.75 %
4.	Znj. Monika MILO	4.75 %
5.	Z. Kristino KROMIDHA	4.05 %
6.	Z. Egi SANTO	2.37 %
7.	Znj. Emi SANTO	2.37 %
8.	Z. Arben TAIPI	2.06 %
9.	Z. Petraq SHOMO	2.06 %
10.	Z. Artan XHORI	1.03 %

B. Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës të shoqërisë SiCRED sh.a.:

1.	Z. Artan XHORI	Kryetar
2.	Z. Selman LAMAJ	Anëtar
3.	Znj. Julinda Molla Kasmi	Anëtar


C. Drejtoria e Përgjithshme:

1.	Z. Genc KOXHAJ	Drejtor i Përgjithshëm

Komitetet dhe organizma të tjera të Shoqërisë SiCRED:

1. **Komiteti i Auditimit/Njësia e Auditimit të Brendshëm** funksionon në mënyrë të pavarur dhe objektive, duke ushtruar kontrolle në sistemin e brendshëm të shoqërisë, për të siguruar përputhshmërinë e aktivitetit të shoqërisë në pajtueshmëri me kuadrin rregullator dhe aktet e brendshme të shoqërisë SiCRED sh.a. si dhe për të dhënë opinion të specializuar në funksion të përmirësimit të veprimtarisë së shoqërisë së sigurimit.
2. **Komiteti i Administrimit të Rrezikut** ka si funksion identifikimin e risqeve dhe mbajtjen e tyre nën kontroll, ku në mënyrë periodike kryhet edhe monitorimi përkatës dhe raportimi i çdo incidenti apo luhatjeje.
3. **Këshilli i Shëndetit dhe Sigurisë në Punë** sigurohet që ambientet e punës të jenë të sigurta dhe komode si dhe sigurohet që të zbatohen dispozitat e ligjit nr.10237, datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” si dhe aktet nënligjore të tij.
4. **Njësia e Parandalimit të Pastrimit të Parave** sigurohet që të zbatohen dispozitat e ligjit nr.9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, nëpërmjet sistemeve efektive që kontrollojnë përputhjen me praktikat më të mira dhe rekomandimet e AMF-së dhe organizatave të tjera.

Organigrama e SiCRED sh.a.



Organigrama e mësipërme është miratuar me Vendimin nr. 15 datë 30.11.2017, të Këshillit Mbikëqyrës të SiCRED sh.a..

Bordi i Drejtorëve



Petrina Duka
Drejtore
Drejtoria e Administrimit dhe Aktuaristikës

Mirjeta Luca
Drejtore
Drejtoria e Shitjeve dhe Dega Tiranë

Matilda Thoma
Audit i Brendshëm

Genc Koxhaj
Drejtor i Përgjithshëm

Gladiola Jani
Drejtore
Drejtoria e Marrjes në Sigurim dhe Korporatave

Teuta Locaj
Drejtore
Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit

Vjosa Bodo
Drejtore
Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore

4. Zhvillimet kryesore gjatë vitit 2019

4.1 Treguesit financiarë kryesorë në periudhën 2015-2019
4.2 SiCRED rishikon strategjinë e saj, shet një pjesë të kuotave aksionare të zotëruara në CREDINS Invest
4.3 Bashkëpunime dhe përfitime ekstra për publikun
4.4 Platforma e rezervimit online të takimeve
4.5 Zgjerimi i Rrjetit Mjekësor SiCRED
4.6 Pjesëmarrje të suksesshme
4.7 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore
4.8 SiCRED dorëzon fondin e sigurimit për besnikërinë "Jeta me Kursim", për të tretin vit radhazi

Tregu i sigurimeve në Shqipëri gjatë vitit 2019 ka njohur një rritje të Primit të Shkruar Bruto prej 4.11%, krahasuar me një vit më parë, ndërsa ka pësuar rënie të Dëmeve të Paguara Bruto prej 8.58%. Kjo rritje e Primit të Shkruar Bruto ka ardhur si rezultat i ecurisë pozitive, si të tregut të Jetës (6.46%) ashtu edhe të Jo-Jetës (3.88%). Ndërkohë në ecurinë e Dëmeve të Paguara ka ndikuar rënia në pagesën e Dëmeve të Paguara për Fond Kompensimi.

Tregu i Jetës vijon të mbetet i orientuar drejt sigurimit të Jetës së Debitorit, si produkti kryesor rreth të cilit realizohen rreth 60% të totalit të primit të shkruar nga shoqëritë e sigurimit të jetës. Ndërkaq vihet re një rritje e ndjeshme e volumit të primit për produktin Cash Plan.

Primet e shkruara bruto të sigurimit 2018-2019*

Veprimtaria	Primet e shkruara bruto (në mijë lekë)		Ndryshimi në % 2019/2018
	2018	2019	
Jeta	1,142,044	1,215,777	6.46
Jo-Jeta	15,726,568	16,337,199	3.88
Risigurimi	53,960	64,611	19.74
Total	16,922,573	17,617,588	4.11

*Burimi: Buletini Statistikor, Tregu i Sigurimeve, AMF, Viti 2019

Dëmet e paguara bruto 2018-2019*

Veprimtaria	Primet e shkruara bruto (në mijë lekë)		Ndryshimi në % 2019/2018
	2018	2019	
Aktiviteti i Jetës	230,985	205,260	(11.14)
Aktiviteti i Jo-Jetës	5,735,277	5,568,184	(2.91)
Dëme të Paguara Fond Kompesimi	1,009,420	603,820	(40.18)
Total	6,975,682	6,377,264	(8.58)


*Burimi: Buletini Statistikor, Tregu i Sigurimeve, AMF, Viti 2019


Në këtë tablo të tregut të sigurimeve, SiCRED pati 289 milionë lekë prime të shkruara bruto dhe 47 milionë lekë dëme të paguara.

Në fund të vitit 2019 shoqëria SiCRED sh.a. kishte 12 produkte të licencuara pranë AMF, si vijon:

1. **Sigurimi i Jetës për Hua,** i cili ofron mbulim në rast të humbjes së jetës së personit të siguruar (kredimarrësit) për shkaqe natyrore apo aksidentale. Ky sigurim është një garanci financiare si për institucionin kredidhënës ashtu edhe për kredimarrësin (personi i siguruar), duke çliruar familjen e personit kredimarrës nga pagesa e kredisë së mbetur.
2. **Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit (CASH PLAN),** i cili, përveç sigurimit të jetës, ofron një gamë të gjerë përfitimesh, si mbulim të shpenzimeve mjekësore në rast sëmundjeje apo aksidenti etj., tërësisht të personalizuara sipas kërkesave për sigurim të klientit.
3. **Sigurimi i Jetës (me Mbijetesë),** i cili përbën një skemë afatgjatë sigurimi dhe kursimi. Personi paguan çdo vit primin e sigurimit, një pjesë e të cilit investohet dhe një pjesë shkon për sigurimin e jetës. Polica ka të përcaktuar një shumë sigurimi të cilin personi e përfiton në fund të kontratës së sigurimit, ose e përfitojnë trashëgimtaret e tij nëse i siguruari ndërron jetë gjatë periudhës së sigurimit.
4. **Sigurimi i Jetës dhe Aksidenteve në Grup,** i cili ofron mbrojtje financiare për të siguruarin në rast të ndodhjes së aksidenteve: për mbulim të shpenzime mjekësore, paaftësisë së përhershme apo të përkohshme, etj.
5. **Sigurimi i Jetës së Nxënësve dhe Studentëve,** i cili ofron një garanci në rast të çdo të papriture shëndetësore apo aksidentale të nxënësit/studentit, mbulimin e rrezikut të shfaqjes së sëmundjeve kritike, rrezikun e humbjes së jetës së personit, etj.
6. **Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit në Udhëtim,** i cili ofron mbulim për një sërë rreziqesh që mund të ndodhin gjatë periudhës së udhëtimit, për të siguruarit që udhëtojnë jashtë Shqipërisë.
7. **Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit të Studentëve,** i cili përbën një garanci financiare për shëndetin e studentëve që zgjedhin të studiojnë jashtë Shqipërisë. Ofron mbulim të shpenzimeve për probleme shëndetësore si pasoje e sëmundjeve apo aksidenteve, shpenzime për evakuim urgjent, riatdhesim, etj.
8. **Sigurimi i Jetës me Kursim,** i cili ofron një mbështetje financiare për personin e siguruar, i cili përfiton për mbijetesë në maturim të kontratës, si dhe për pasardhësit e tij në rast të humbjes së jetës së personit të siguruar.
9. **Sigurimi i Kombinuar i Jetës,** është një produkt i përshtatshëm për skema profesionale, i cili ofron mbulim për çdo ngjarje të papritur, për shkaqe natyrale apo aksidentale si dhe shfaqjen e sëmundjeve kritike, etj.
10. **Sigurimi i Jetës së Depozitarit,** një produkt i cili u adresohet depozituesve në njërën nga bankat e nivelit të dytë. Ofrohet në partneritet me institucionin bankar.
11. **Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit të Vizitorit,** i cili ofrohet për personat e huaj që vizitojnë Shqipërinë, apo që qëndrojnë në Shqipëri për periudha deri në një vit.
12. **Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit të Sportistëve,** i cili ofron mbulim të shpenzimeve mjekësore në rast aksidenti, mbulon rrezikun e vdekjes së të siguruarit (sportistit) për shkaqe natyrore apo aksidentale, rrezikun e dëmtimeve fizike (trupore) si pasojë e aksidentit, etj.


Ndarja e Primit të Shkruar Bruto sipas produkteve kryesore gjatë viteve 2018 - 2019 ka qenë si vijon:






4.1 Treguesit financiarë[2] kryesorë të SiCRED sh.a. në periudhën 2015-2019


Primi i Shkruar Bruto




Primi i Vitit Financiar




Dëmet e paguara në total




Numri i dëmeve të paguara




Fitimi Neto




Aktivi Total i SiCRED sh.a.



Aktivet e Konsoliduara[3]




Kapitali Themeltar



2 Sipas Pasqyrave Financiare të Veçuara të Shoqërisë SiCRED sh.a.
3 Sipas Pasqyrave Financiare të Konsoliduara të Shoqërisë SiCRED sh.a..





4.2 SiCRED rishikon strategjinë e saj, shet një pjesë të kuotave aksionare të zotëruara në CREDINS Invest

Shoqëria SiCRED sh.a., gjithmonë në kërkim të rinovimit, përmirësimit të shërbimit ndaj klientëve dhe ofrimit të risive, rishikon strategjinë e saj, duke shitur 12% të kuotave të saj aksionare të zotëruara në Shoqërinë e Administrimit të Fondeve të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive CREDINS Invest sh.a..

Ky vendim vjen si rezultat i synimit të SiCRED për të rritur përqendrimin dhe fokusin në aktivitetin e sigurimit të jetës, për të sjellë për klientët produkte të reja sigurimi, të cilat do të përbëjnë risi për tregun shqiptar të sigurimit.

Aktualisht SiCRED sh.a. zotëron 12% të kuotave aksionare të Shoqërisë CREDINS Invest sh.a..

4.3 Bashkëpunime dhe përfitime ekstra për publikun

Ka vijuar edhe gjatë vitit 2019 bashkëpunimi midis SiCRED dhe CREDINS Bank, ku kategori të ndryshme të klientëve të bankës kanë përfituar FALAS produkte sigurimi të shoqërisë SiCRED.

- Kartëmbajtësit MasterCard World dhe MasterCard Gold përfituan:
  1. Sigurimin Jetë dhe Shëndet në Udhëtim falas, me zonë mbulimi Europën!

Gjatë vitit 2019, falë një bashkëpunimi shumevjeçar, tashmë, midis SiCRED sh.a. dhe CREDINS Invest sh.a., anëtarët e Fondit të Pensionit “CREDINS Pension”, përfituan falas:

1. Sigurimin Jetë dhe Aksidente për një vit!
2. Kartën e Sigurimit nga SiCRED.
3. Zbritje deri në 60% në mbi 100 klinikat dhe spitalet e rrjetit mjekësor SiCRED.

4.4 Platforma e rezervimit online të takimeve

Në vitin 2019, SiCRED lancoi platformën e rezervimit online të takimeve, si shoqëria e parë e sigurimeve që ofron një risi të tillë për publikun.
Në vetëm pak klikime, klienti mund të përzgjedhë ditën, orarin, ekspertin e SiCRED dhe produktin për të cilin interesohet dhe merr menjëherë konfirmimin për takimin.
SiCRED u jep kështu mundësinë klientëve të njihen më mirë me produktet e sigurimit të jetës dhe të zbulojnë produktin e duhur për ta!

MJAFT MË ME RADHË TË GJATA,
REZERVO ONLINE TAKIMIN!





KUDO KU TË JESH...

- Rezervo online takimin!
- Informohu nga ekspertët tanë mbi produktet e sigurimit!
- Zbulo produktin e duhur për ty!

SiCRED
Shoqëri Sigurimi Jete

Në duar të sigurta!

SiCRED sh.a.
Adresa: Njësia Bashkiake Nr.5,
Rr. Brigada VIII", Vila nr.3/1, Tiranë
Tel: +355 4 22 37 549
Fax: +355 4 22 37 530
Cel: +355 69 20 84 026
e-mail: contact@sicred.com.al

4.5 Zgjerimi i Rrjetit Mjekësor SiCRED

Gjatë vitit 2019 ka vijuar puna për zgjerimin e Rrjetit Mjekësor SiCRED. Subjekte të tjerë mjekësorë i janë shtuar gjeografisë së spitaleve dhe klinikave private më prestigjioze, që bashkëpunojnë me SiCRED, brenda dhe jashtë Shqipërisë.
Klientët tanë përfitojnë shërbim profesional shëndetësor, trajtim preferencial; dhe me disponimin kartës së sigurimit, zbritje deri në 60% për kërkesat e tyre shëndetësore.

Në fund të 2019-ës rrjeti mjekësor SiCRED numëronte mbi 120 klinika dhe spitale:

Brenda Republikës së Shqipërisë:

- 69 subjekte mjekësore (spitale private, klinika dhe laboratorë)
- Jashtë Republikës së Shqipërisë:
- Kosovë – 8 spitale dhe klinika
- Itali – 3 spitale dhe një grup spitalor i përbërë nga 11 spitale dhe qendra mjekësore
- Austri – 5 klinika
- Turqi – 23 spitale dhe klinika
- Greqi – 4 spitale

4.6 Pjesëmarrje të suksesshme

Gjatë vitit 2019 SiCRED ka qenë pjesë dhe ka dhënë kontributin e saj në disa panaire të punës dhe karrierës, për të ndihmuar të rinjtë të krijojnë një perceptim të tregut të punës, si dhe për orientimin e karrierës së tyre.

- **SiCRED në Panairin e Karrierës pranë Universitetit Metropolitan**





- **SiCRED në Panairin e Karrierës 2019 pranë UNYT**





- **SiCRED pjesë e Panairit të gjashtë të Karrierës në Universitetin Epoka**





- **SiCRED pjesë e panairit "Dita e Karrierës" në Fakultetin e Ekonomisë**





4.7 Menaxhimi i Burimeve Njerëzore

Të dhëna kyçe për burimet njerëzore të SiCRED (Dhjetor 2019):

- Numri i punonjësve 53 të punësuar
- Mosha mesatare e punonjësve: 35 vjeç
- Punonjëse femra 77.36%
- Punonjës meshkuj 22.64%
- Vjetërsia mesatare në punë 5.7 vjet

Trajnimi i vazhdueshëm i skuadrës SiCRED dhe edukimi i publikut mbi produktet e sigurimit të jetës

Në tregun e sigurimit të jetës problematika, që haset vazhdimisht, mbetet niveli i njohurisë së publikut mbi produktet e sigurimit të jetës dhe mungesa e nxitjes për t'u orientuar drejt kujdesit personal dhe mbrojtjes së të ardhmes së familjes.
SiCRED vazhdimisht ka vijuar përpjekjet për të kontribuuar në edukimin e publikut lidhur me sigurimin e jetës dhe investimet financiare dhe gjatë vitit 2019 ka lancuar platformën e rezervimit online të takimeve.

Edhe pse në vetvete kjo platformë nuk shërben si një burim informacioni, ajo jep një mundësi të shkëlqyer edukimi përmes takimeve personalisht me profesionistët e SiCRED. Niveli i informacionit të përfituar nga këto takime do të ndihmojë në kanalizimin e njohurive dhe përzgjedhjen e produktit më të përshtatshëm për individin, familjen apo grupin e interesuar.

Në këtë kuadër, SiCRED ka vijuar trajnimin e rregullt të stafit të saj duke u kujdesur që ekipi i ekspertëve të shoqërisë të jetë plotësisht i përgatitur për t'ju përgjigjur sa më mirë kërkesave dhe nevojave të publikut.

Trajnimet e tilla mbeten një ndër prioritet e SiCRED.





4.8 SiCRED dorëzon fondin e sigurimit për besnikërinë "Jeta me Kursim", për të tretin vit radhazi

Shoqëria SiCRED, është e vetmja shoqëri në tregun e sigurimeve dhe e para në tregun shqiptar në tërësi, që përqafon shpërblimin e punonjësve për performancë të mirë dhe besnikëri në punë.

Për të tretin vit radhazi SiCRED dorëzoi shpërblimin nga Fondi i Besnikërisë "Jeta me Kursim" për gjeneratën e tretë të maturimit të këtij produkti.

Eventi i dorëzimit të shpërblimeve u mbajt pranë ambienteve të Shoqërisë SiCRED. Në fjalën e saj përshëndetëse, Drejtoresha e Burimeve Njerëzore, znj. Vjosa Bodo, falënderoi dhe shprehu mirënjohjen ndaj punonjësve, që kanë dhënë kontributin e tyre të çmuar për shoqërinë përgjatë një periudhe mbi 7 vjeçare.

Nëpërmjet produktit të sigurimit "Jeta me Kursim", SiCRED synon të japë shembull e t'u hapë rrugën kompanive shqiptare për të përqafuar këtë skemë, si një mënyrë për të siguruar marrëdhënie korrekte e më afatgjata punëdhënës – punëmarrës.



5. Objektivat e shoqërisë SiCRED sh.a. për vitin 2020

- Rritja e Volumit të Primeve Vjetore – Shoqëria synon të rrisë volumin e primeve vjetore të sigurimit për vitin 2020 me 18.6%.
- Zgjerimi i Gamës së Produkteve – SiCRED synon gjatë vitit 2020 të ofrojë për publikun produkte sigurimi të cilat vijnë si risi për tregun shqiptar, e të cilat u ofrojnë klientëve më tepër përfitime dhe avantazhe.
- Menaxhimi i Kujdesshëm i Kostove dhe Shpenzimeve të Përgjithshme – Shoqëria synon të ulë raportin e shpenzimeve administrative dhe ato të marrjes në sigurim, duke rritur shkallën e eficencës së produkteve të saj pa cenuar cilësinë e shërbimit ndaj klientëve, interesat e punëmarrësve, si dhe interesat e aksionarëve.
- Diversifikimi i Investimeve Financiare – Sipas politikave të investimeve të shoqërisë, SiCRED synon të diversifikojë investimet financiare me qëllim shmangien e rrezikut të tepërt të humbjes dhe arritjen e një kthimi të arsyeshëm nga investimi.
- Edukimi i Publikut mbi Sigurimin e Jetës – SiCRED synon të vijojë përpjekjet për të ndërgjegjësuar dhe rritur informimin e publikut mbi sigurimin e jetës dhe rëndësinë e tij. Synohet puna me artikujt informues në blog dhe rrjetet sociale të shoqërisë, si dhe reportazhe e artikuj në media.
- Përgjegjësia Sociale – SiCRED synon të rrisë ndikimin e saj në shoqëri, duke dhënë kontribut në arritjen e politikave sociale të përbashkëta dhe duke rritur investimet në komunitet.
- Zgjerimi i Rrjetit Mjekësor – Gjatë vitit 2020 shoqëria synon të vijojë shtrirjen territoriale të rrjetit të saj mjekësor brenda dhe jashtë vendit, për të ofruar shërbim sa më cilësor në të gjithë specialitetet që mbulon sigurimi.



6. Zhvillimet kryesore të shoqërisë CREDINS Invest sh.a. gjatë vitit 2019

6.1 Ecuria e Fondit të Pensionit Vullnetar "CREDINS Pension" gjatë vitit 2019

Gjatë vitit 2019, Fondi i Pensionit Vullnetar "CREDINS Pension" ka vijuar ecurinë pozitive duke arritur 17,137 të anëtarësuar, krahasuar me 15,320 anëtarë të fundit të vitit 2018. Sipas ndarjes së tregut më 31 Dhjetor 2019, CREDINS Pension mbante vendin e parë, me 60.61% të anëtarëve.

Klientët që i janë bashkuar Fondit të Pensionit Vullnetar "CREDINS Pension" deri në fund të vitit 2019 janë ndarë si më poshtë:


Skema profesionale (shoqëri ose të vetëpunësuar)	3,332
Individë	13,805
Totali i klientëve	17,137

Vlera Neto e Aseteve të Fondit më 31 Dhjetor 2018 ishte 580,591,026 Lekë dhe më 31 Dhjetor 2019 arriti në 825,972,127 Lekë.

Pjesa më e madhe e portofolit të Fondit është investuar në bono dhe obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.

Vlera e aseteve për kuotë më 31 Dhjetor 2017 ishte 1,353.79 Lekë dhe më 31 Dhjetor 2018 arriti në 1405.82 dhe më 31 Dhjetor 2019 arriti në 1,474.57. Norma neto e kthimit të portofolit të Fondit gjatë 2019-ës ka qenë 4.89 %.

Ecuria e çmimit për kuotë ndër vite paraqitet si më poshtë, deri më 31 Dhjetor 2019:



6.2 Ecuria e Fondit të Investimit "CREDINS PREMIUM" gjatë vitit 2019

Avantazhet e Fondit të Investimit:


- Fondi ka profil risku të ulët pasi investohet në tituj të Shtetit Shqiptar.
- Likuiditet i lartë: mundësia e tërheqjes në çdo kohë brenda 7 ditëve pa penalitet dhe pa humbur interesin.
- Normë më e lartë kthimi krahasuar me depozitat.
- Mund të investohet me shumë të menjëhershme ose me plan investimi periodik, ku shuma minimale e investimit është vetëm 2,000 Lekë.
- Mundësi diversifikimi të investimeve.
- Menaxhim profesional i investimeve.
- Në çdo moment mund të aksesohet llogaria online.

Vlera neto e aseteve të fondit më 31 Dhjetor 2018 ishte 1,956,538,948 Lekë dhe më 31 Dhjetor 2019 arriti në 3,789,529,368 Lekë.
Pjesa më e madhe e portofolit të Fondit është investuar në bono dhe obligacione të Qeverisë së Republikës së Shqipërisë.
Të dhëna të tjera për Fondin:

- Çmimi i kuotës 1,282.29
- Kthimi nga investimi (31.12.2018- 31.12.2019)* 5.18 %
- Kohëzgjatja e Modifikuar 3.04 vite

* Tarifa e administrimit është zbritur përpara llogaritjes së kthimit nga investimi.

7. Një përmbledhje e ngjarjeve të 2019 për SiCRED Assistance



Fjala e Administratorit, znj. Vjosa Bodo

Në gati një dekadë në drejtim të SiCRED Assistance sh.p.k., tashmë jam e bindur për qëllimin, reputacionin, vlerat dhe talentin e padiskutueshëm të punonjësve të Assistance.

Në fillim të kësaj përmbledhje për vitin 2019, doja të falënderoja të gjithë bashkëpunëtorët e SiCRED Assistance, si dhe aksionarët e saj. Pa mbështetjen tuaj, ambiciet e shoqërisë për 2019 do të kishin mbetur një ëndërr.

Performanca përgjatë 2019

SiCRED Assistance sh.p.k., përmbylli vitin 2019 me fitim. Vlerat e krijuara përgjatë këtij viti siguruan bilanc pozitiv, si dhe likuiditetet e nevojshme për të mbështetur sfidat e aktivitetit. Të ardhurat e realizuara, ishin më pak se kufiri i parashikimeve.

Ky rezultat, mund të shpjegohet edhe si rrjedhojë e shitjes së aseteve të investuara, ofertuesit më të parë, si dhe ngadalësimit në disa tregje të punës. Gjithsesi, ne jemi të vendosur dhe të përkushtuar për të punuar e arritur pritshmërinë përgjatë 2020, mbështetur edhe në direktivat e pronarëve tanë, megjithëse tregjet do të kenë shumë vështirësi edhe gjatë këtij viti.

Ngjarje të vitit 2019

Shërbimet e sigurisë dhe shëndetit në punë mbeten fokusi kryesor i aktivitetit të SiCRED Assistance. Ky aktivitet i shoqërisë, përgjatë vitit 2019, siguroi një tjetër qasje ndaj klientëve të shoqërisë për këtë shërbim. U realizuan, sipas kontratave me subjektet partnere, raportet e para të riskut për pozicion pune.

Këto raporte erdhën jo vetëm si parakushte kontraktuare për të cilat Assistance ishte angazhuar me përgjegjësi, por edhe si materiale që trajtonin riskun për pozicion pune, sipas standardeve më të mira evropiane dhe botërore, me synim të pastër evitimin në maksimum të çdo risku në çdo pozicion pune.

Viti 2019 shënoi realizimin e kontratës së parë për ndërmjetësim në punësim, si një aktivitet për të cilin shoqëria kishte vite që kërkonte të identifikohej me finalizim kontrate për këtë treg. Në të njëjtin vit ekonomik, 2019, u realizua edhe kontrata e dytë e ndërmjetësimit në punësim nga SiCRED Assistance.

Shërbimi i dhënë nga SiCRED Assistance përgjatë vitit 2019 në përzgjedhjen e punonjësit të përshtatshëm për punë specifike, konfirmoi aftësitë dhe kapacitet e shoqërisë për të vepruar në këtë sektor me vetëbesim dhe profesionalizëm.

Ndërkaq, në aspektin financiar, të ardhurat e realizuara nga kjo veprimtari siguruan edhe rezultatin pozitiv të aktivitetit ekonomik të Assistance për vitin e mbyllur në 31 Dhjetor 2019, duke siguruar kështu, pozitat e treguesit pozitiv në pasqyrat e të ardhurave dhe shpenzimeve, pavarësisht se në nivel shifrash, ky rezultat pozitiv mbetet me natyrë simbolike.

Shoqëria SiCRED Assistance sh.p.k., në Qershor të vitit 2019, transferoi me shitje kuotat e saj aksionare që zotëronte pranë subjektit ASSIBORKER sh.a., tek njëri nga bashkë-aksionarët e kësaj shoqërie, i vetë-ofruar si blerës. Me përfundimin e transaksionit të shitjes, SiCRED Assistance sh.p.k. nuk zotëron më asnjë aksion pranë subjektit ASSIBROKER sh.a., që prej Korrikut të vitit 2019.

Viti 2019, shënoi një qasje pozitive ndaj promovimit të veprimtarisë së subjektit SiCRED Assistance sh.p.k.. Shoqëria, në bashkëpunim me subjektin Isttituto Auxologico Italiano, realizoi në Tetor të vitit 2019 konferencën rajonale me subjekt “Të përmirësojmë shëndetin së bashku”.

Konferenca adresoi në nivel shkencor çështje të kardiologjisë, endokrinologjisë, ortopedisë, urologjisë, si një qëllim për shkëmbimin e metodave më të mira në trajtimin dhe kurimin e pacientëve, që shfaqin sëmundje të këtyre kategorive. Në të njëjtën konferencë u theksua mundësia e bashkëpunimit me subjektin italian, për trajtime të specializuara dhe cilësore në fushat e kardiologjisë, endokrinologjisë, ortopedisë, urologjisë.





Mundësia e trajtimit të shtetasve shqiptarë në Milano për shërbime mjekësore të organizuara, e po ashtu edhe rëndësia e kontrolleve shëndetësore, duke përdorur shërbimet e ndërmjetësimit nga SiCRED Assistance, në përzgjedhjen e institucionit të përshtatshëm spitalor, u trajtua dhe u diskutua posaçërisht në konferencë, duke analizuar në mënyrë sintetike të mirat e këtij shërbimi.

E ardhmja e tregut të punës

Shoqëria jonë po ndryshon vazhdimisht, ajo po merr tendenca të larmisë dhe fragmentarizmit. Megjithëse njerëzit po ndër-veprojnë gjithnjë e më shumë mes tyre, ndarja mes grupeve socio-ekonomike dhe atyre me përkatësi politike është e dallueshme.

Ndryshimet pasqyrohen edhe në mënyrën se si realizohet dhe kryhet puna. Nën këto forma ndryshimi, biznesi duhet të përshtatet për të pasur hierarkinë dhe efektivitetin e duhur administrativ, ndërkohë edhe role e mënyra të reja e novatore të punës, e kuptohet hapësira edhe më të mëdha edhe për punëtorë me aftësi të ndryshme.

Gjithsesi, këto kohë kërkojnë demonstrim të aftësive të fleksibilitetit të punëdhënësve, për t'ju krijuar punëmarrësve punë të denjë e të drejtë, gjithë-përfshirjen, punë të përshtatshme për aftësitë dhe kapacitetin e tyre, nxitjen, larminë e komfortin në punë për të qenë të aftë e të lirë, të vijojnë të japin kontributin e tyre në punën që u jepet e të mësojnë prej saj.

Talenti e transformimi për të gjetur shtegun e duhur në marrëdhëniet e punësimit, janë vlera të cilat priten të demonstrohen nga menaxherë të përgjegjshëm.

Optimistë se së bashku mund të gjejmë punësimin, sigurinë në punë dhe shëndetin!

Sinqerisht,

Av. Vjosa Bodo Mujo
Administrator i SiCRED Assistance sh.p.k.

RAPORTI I AUDITIT TË BRENDSHËM



1. Baza ligjore

Njësia e Auditit të Brendshëm në ushtrimin e funksionit të vet mbështetet në ligjet dhe aktet nën ligjore me qëllim arritjen e objektivave.

- Ligji Nr.52 datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit.
- Rregullorja "Për procedurat dhe parimet minimale në lidhje me kontrollin e brendshëm dhe aspekte të tjera të sistemit të informimit të shoqërisë së sigurimit" miratuar me vendim të Bordit të AMF nr. 135 datë 31.10.2014.
- Rregullorja "Për veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm dhe Komitetit të Auditimit në shoqërinë e sigurimit" miratuar me vendim të Bordit të AMF nr. 153 datë 23.12.2014.
- Udhëzimi i Shoqërisë SiCRED sh.a "Për veprimtarinë e Njësisë së Auditit të Brendshëm, Komitetit të Auditimit" miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 12 datë 10.08.2015.
- Ligji Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" i ndryshuar.

2. Organizimi

- **Misioni i Auditit të Brendshëm**

Misioni i auditit të brendshëm është të mbështesë menaxhimin e lartë për kryerjen e përgjegjësive të tyre. Njësia e auditit të brendshëm kryen funksione në mënyrë të pavarur dhe objektive, duke dhënë një opinion të specializuar në funksion të përmirësimit të veprimtarisë së shoqërisë. Në përfundim të procesit të auditimit jepen rekomandime dhe propozime për të përmirësuar funksionimin aty ku rezulton e nevojshme.

- **Funksioni i Auditit të Brendshëm**

— Auditi i brendshëm, përveç të tjerash, përfshin krijimin, zbatimin dhe ruajtjen e një plani auditimi të bazuar në risk, për të shqyrtuar dhe vlerësuar fusha të përgjithshme apo të veçanta bazuar në masa parandaluese.
— Siguron që fushat me risk janë subjekte të përzgjedhura të auditimit të përshtatshëm, si kontabiliteti, politikat financiare, aftësia paguese, analiza e shpenzimeve, ngjarjet e sigurimit dhe demet për t'u paguar etj.
— Kryen vlerësime të rregullta në funksion të auditit dhe auditimit të sistemeve të brendshme duke përfshirë përmirësimet e nevojshme.
— Siguron që risqet e identifikuara dhe masat e marra për t'i adresuar ato janë të sakta dhe aktuale.
— Auditi i brendshëm, për të gjitha fushat dhe çështjet e shqyrtuara, ka hartuar raporte për të siguruar dëshminë e tyre me kalimin e kohës.

- **Objekti i Auditit të Brendshëm**

Objektivi i auditit të brendshëm konsiston në kontrolleve të thelluara dhe tematike, pranë drejtorive dhe degëve përkatëse, në kohë dhe me efektivitet, për të bërë të mundur vlerësimin e rreziqeve në kohë. Auditi i brendshëm përveç të tjerash përfshin krijimin, zbatimin dhe ruajtjen e një plani auditimi të bazuar në risk, për të shqyrtuar dhe vlerësuar fusha të përgjithshme apo të veçanta bazuar në masa parandaluese.

Auditi i brendshëm kontrollon dhe vlerëson sistemet e informacionit dhe raportimit duke përfshirë sistemet e teknologjisë si dhe informacionit dhe saktësinë e të dhënave.
Siguron që risqet e identifikuara dhe veprimet e marra për t'i adresuar ato janë të sakta dhe aktuale si dhe sistemi i administrimit të rrezikut është zbatuar nga shoqëria.
Kryerjen e vlerësimeve të rregullta në funksion të auditit dhe auditimit të sistemeve të brendshme duke përfshirë përmirësimet e nevojshme.
Siguron që fushat me risk janë subjekte të përzgjedhura të auditimit të përshtatshëm, si kontabiliteti, politikat financiare, aftësia paguese, analiza e shpenzimeve, ngjarjet sigurimit dhe demet për t'u paguar etj.

- **Organizimi i Burimeve Njerëzore dhe Financiare të Auditit të Brendshëm**

Auditi i brendshëm vepron në zbatim të ligjit nën cilësinë e një strukture të posaçme. Auditi i brendshëm është punonjës i shoqërisë i emëruar në Njësinë e Auditit të Brendshëm. Njësia e Auditit ushtron detyrën në mënyrë të pavarur dhe të integruar duke vlerësuar procesin e qeverisjes, administrimit të rrezikut brenda shoqërisë. Auditimet për vitin 2019 janë kryer nga një audituesi i emëruar nga Këshilli Mbikëqyrës. Audituesi i brendshëm i Shoqërisë ka profil ekonomist dhe një përvojë pune prej 17 vitesh në fushën e sigurimeve. Angazhimi në shoqërinë SiCRED sh.a. në rolin e auditit të brendshëm është prej 9 vjetësh. Gjatë këtyre viteve, auditi ka ndjekur trajnimet profesionale të auditit "Audit Ekonomik–Financiar" dhe të standardeve të kontabilitetit. Audituesi ekziston i regjistruar në regjistrin e ekspertëve fiskalë me nr. 184 që prej vitit 2012. Eksperienca e gjatë në fushën e sigurimeve dhe atë financiare ndihmon në realizimin me profesionalizëm të punës brenda Shoqërisë.
Komiteti i Auditimit, në përputhje me kërkesat e Ligji Nr.52 datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit", ka ushtruar funksionet e veta në mënyrë të pavarur. Gjatë vitit 2019 komiteti i auditimit ka zhvilluar 4 mbledhje përkatësisht në datat: 18.02.2019; 24.04.2019; 18.10.2019; 26.12.2019. Mbledhjet janë dokumentuar me proces-verbale të minutave dhe diskutimeve të kryera.
Njësia e Auditit të Brendshëm gjatë vitit 2019 ka qenë e angazhuar plotësisht për të kryer auditime pranë shoqërisë SiCRED sh.a.. Njësia e Auditit të Brendshëm, në zbatim të detyrave dhe përgjegjesive që i ngarkon ligji, në planin e punës për vitin 2019 ka përfshirë në tematikë edhe problematikat e evidentuara nga inspektimi në vend gjatë vitit 2018, sipas metodologjisë së mbikëqyrjes me fokus rreziku. Buxheti financiar i njësisë së auditimit përbëhet nga shpenzimet për paga, sigurime shoqërore, dieta dhe shpenzime trajnimi përfshirë në zërat përkatës të plan-buxhetit në kuadrin e gjithë stafit të shoqërisë. Shpenzimet e trajnimit lidhen me trajnimet e vazhdueshme e të detyrueshme të cilat miratohen nga Këshilli Mbikëqyrës dhe Drejtori i Përgjithshëm.

3. Analiza e Veprimtarisë së Auditit të Brendshëm

Gjatë vitit 2019 Auditi i brendshëm ka ushtruar veprimtarinë e tij duke u bazuar në planin vjetor të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës. Kontrollet janë zhvilluar sipas tematikave duke u fokusuar në analizën e proceseve, risqeve dhe të dhënave të grumbulluara në dokumentacionin që shoqëria SiCRED sh.a. përdor. Gjithsej, gjatë vitit 2019, janë kryer 20 misione auditimi. Auditimi ka qenë i plotë ose i pjesshëm në varësi të tematikave. Auditimet e kryera janë përqendruar kryesisht në zyrat qendrore ku SiCRED sh.a. zhvillon veprimtarinë, por dhe në degët e shoqërisë. Për sa u përket auditimeve, janë marrë parasysh treguesit me rrezik të lartë në mënyrë që t'u paraprihet problematikave që mund të ndodhin në kohë. Gjithashtu, auditime janë kryer në zbatim të rekomandimeve të lëna si dhe problematikave që mund të kenë dalë gjatë punës së përditshme. Gjithashtu janë kryer dhe auditime të cilat nuk kanë qenë planifikuar, por që kanë dalë si të nevojshme për t'u kryer gjatë periudhës së vitit 2019. Në hartimin e dokumentacionit të kontrollit janë zbatuar standardet kombëtare dhe ndërkombëtare. Njësia e auditit gjatë vitit 2019 ka kryer 4 (katër) mbledhje të komitetit të auditimit, të dokumentuar me proces-verbalet dhe mbajtjen e minutave përkatëse. Shoqëria për vitin 2019 zbaton SNRF 16 për njohjen, matjen fillestare, matjen e mëpasshme, paraqitjen dhe shënimet shpjeguese të qirasë duke filluar me 1 Janar 2019. Në fund të çdo raporti janë lënë rekomandimet për përmirësimin e gjendjes. Të gjitha rekomandimet e dhëna nga auditimi janë pranuar nga drejtuesit.

- **Analiza e misioneve të auditit**

Auditimet e kryera gjatë vitit 2019 janë përqendruar kryesisht në zyrat qendrore ku SiCRED sh.a. zhvillon veprimtarinë, por dhe në degët e shoqërisë. Në disa prej misioneve të realizuara janë konstatuar elementë për t'u përmirësuar dhe për secilën nga ato janë dhënë rekomandimet përkatëse, të cilat janë pranuar nga drejtimi. Gjithashtu një vëmendje të veçantë i është kushtuar dhe rekomandimeve të dhëna në periudhën e mëparshme. Auditimet gjatë vitit 2019 janë kryer pranë:

- Drejtorisë së Financës dhe Kontabilitetit..
- Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore.
- Drejtorisë së Marrjes në Sigurim dhe Korporatave.
- Drejtorisë së Administrimit dhe Aktuaristikës.
- Drejtorisë së Shitjeve etj.

1. **Pranë Drejtorisë së Financës dhe Kontabilitetit** janë ushtruar kontrolle në lidhje me treguesit kryesore të pasqyrave financiare sipas tremujorëve dhe vitit 2019, vlerësimin e riskut bazuar në raportet përkatëse, administrimin e policave të sigurimit të shitura dhe rakordimi i primeve ndërmjet drejtorive, kontrollin e procedurave të blerjes dhe faturat e pashlyera, gjendjes monetare të arkës, analiza e normës se likuiditetit, analiza e shpenzimeve operative 3 mujore dhe vjetore, evidentimi i debitorëve dhe analiza për arkëtimin e tyre në kohë etj.
2. **Pranë Drejtorisë Juridike dhe të Burimeve Njerëzore** janë ushtruar kontrolle në lidhje me trajtimin e ngjarjeve të sigurimit në zbatim të ligjshmërisë dhe plotësimit të dosjeve të dëmeve, si dhe nga ana teknike rezulton që dokumentacioni që përmban çdo dosje e paguar është i plotë dhe në përputhje me kërkesat e ligjit. Kontroll mbi implementimin dhe ndryshimet që pëson legjislacioni për sa i përket ndryshimeve fiskale dhe ato të punës etj.
3. **Pranë Drejtorisë së Marrjes në Sigurim dhe Korporatave** janë ushtruar kontrolle në lidhje me praktikat e marrjes në sigurim të policave fakultative, si dhe mbi regjistrimin kronologjik, administrimin dhe ruajtjen e tyre në dosjet përkatëse.
4. **Pranë Drejtorisë së Administrimit dhe Aktuaristikës** janë ushtruar kontrolle në lidhje me administrimin dhe nënshkrimin e policave Jetë për Hua; analiza e policave të shitura dhe rakordimi midis Drejtorisë së Aktuaristikës dhe Drejtorisë së Financës.
5. **Pranë Drejtorisë së Shitjeve** janë ushtruar kontrolle në lidhje me inventarizimin dhe administrimin e policave.

Kontrolle të tjera me objekte të veçanta.

— Kontrolli i parandalimi të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
— Kontrolle tematike.
— Etj.

4. Konkluzione dhe rekomandime

- Shoqëria SiCRED sh.a. ka plotësuar nivelin e aftësisë paguese në përputhje me kërkesat e ligjit 52/2014.
- Raporti i shpenzimeve në tremujorin e parë 31.03.2019 krahasuar me 3 tremujorët e vitit 2018 ka pësuar ulje dhe është brenda kufirit 50% të lejuar. Për periudhat ku raporti ka rezultuar në nivelin me të lartë, shoqëria SiCRED sh.a. ka marrë masa për uljen e shpenzimeve administrative dhe ato të marrjes në sigurim, të cilat rezultojnë me ndikim të drejtpërdrejtë në këtë raport. SiCRED sh.a. duhet të kujdeset edhe për periudhat në vazhdim për të ulur shpenzimet të cilat rezultojnë me ndikim në raportin e shpenzimeve.
- Treguesit e 3 mujorit të katërt të vitit 2019 kanë ardhur duke u përmirësuar dhe janë brenda kufirit të vlerave të pranuara.
- Aktivet në mbulim të provigjioneve janë në masën: 110 %, 116.67%, 127.95 %, 124.77 % (sipas çdo tre mujori).
- Norma e likuiditetit për vitin 2019 rezulton mbi nivelin e kërkuar.
- Shoqëria SiCRED sh.a., për periudhën e vitit 2019, rezulton në përputhje me nenin 6 të Rregullores nr. 56 datë 28.04.2016 “Mbi administrimin e likuiditetit nga shoqëritë e sigurimit dhe risigurimit” për sa i përket normës së likuiditetit, e cila është në nivelin e kërkuar >=1.
- Shoqëria ka ndërmarrë masa në lidhje me përmirësimin e tregueseve financiarë.
- Raporti dëme/prime neto rezulton brenda kufirit të lejuar gjatë vitit 2019.
- Raporti i mbajtjes ka rezultuar brenda kufirit të lejuar gjatë vitit 2019.
- Marzhi i aftësisë paguese rezulton në nivelin: 114.16 %,115.35 %,114.03 %,115.95 % (sipas çdo tre mujori).
- Kthimi ndaj kapitalit (ROE) më datë 31.12.2019 rezulton në nivelin 7.41%.
- Në mbyllje të pasqyrave të vitit 2019, shoqëria SiCRED sh.a. rezulton me fitim.
- Shoqëria është në stadin e implementimit të sistemit të integruar dhe me certifikimin e tij.
- Shoqëria SiCRED sh.a. duhet të kujdeset dhe për periudhat në vazhdim për të ruajtur parametrat brenda normës së lejuar.

5. Pohimi i pavarësisë

Auditimi i brendshëm kryhet sipas kuadrit ligjor e rregullator dhe nuk i është nënshtruar asnjë ndikimi tjetër nga individë, qofshin dhe në pozicion drejtues brenda shoqërisë. Puna e auditit të brendshëm ka qenë në përputhje me politikën ligjore dhe rregullat për pajtueshmërinë ligjore. Audituesi i brendshëm respekton rregullat e etikes dhe të sjelljes brenda shoqërisë. Audituesi mban qëndrim të paanshëm dhe i shmanget konfliktit të interesit. Auditi i brendshëm, si funksion themelor për sistemin e kontrollit të brendshëm në Shoqërinë SiCRED sh.a., ka funksionuar si një njësi e pavarur që prej krijimit të Shoqërisë. Në përshtatje të formës dhe funksionimit është ngritur njësia e auditit të brendshëm në përputhje me rregulloren e miratuar. Referuar një programi metodologjik, kronologjik, gjithëpërfshirës dhe adekuat, auditi ka raportuar me shkrim dhe me efektivitet punën e kryer pa u ndikuar nga organizimi. Audituesi ka shfaqur nivel të lartë të gjykimit profesional në mbledhjen vlerësimin dhe transmetimin e informacionit mbi proceset që janë audituar. Auditi ka ushtruar kontroll pa u influencuar nga interesat personale.

6. Plani i auditimit për vitin 2020

Objektivat e planit të auditimit për vitin 2020 do të arrihen nëpërmjet harmonizimit të kontrolleve të thelluara dhe tematike, duke kryer vlerësimin e rreziqeve në kohë dhe me efektivitet. Në përcaktimin e risqeve me të cilat do të haset shoqëria gjatë vitit 2020, do të bazohet kryesisht në risqet e hasura gjatë vitit të shkuar, si dhe në rekomandimet e dhëna nga organet rregullatore. Auditimi përfshin dhe menaxhimin e risqeve të sigurimit dhe risigurimit, riskun financiar dhe të kontabilitetit, riskun ligjor, riskun në lidhje me ngjarjet e sigurimit. Për sa i përket menaxhimit të riskut, Shoqëria SiCRED sh.a. ka ngritur Komitetin e Administrimit te Riskut. Komiteti i Administrimit të Riskut vepron në zbatim të ligjit nën e cilësinë e një strukture të posaçme dhe funksionon si njësi në mënyrë të pavarur dhe objektive, duke dhënë opinion të specializuar në funksion të përmirësimit të veprimtarisë së shoqërisë. Në mbledhjen e komitetit të auditimit, të zhvilluar më datë 26.12.2019, është shqyrtuar programi i auditimit për vitin 2020, i cili është miratuar me vendimin e këshillit mbikëqyrës nr.7 datë 27.12.2019.

Për vitin 2020 puna audituese do të përfshijë drejtoritë dhe degët si më poshtë:

1. Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit.
2. Drejtoria Juridike dhe e Burimeve Njerëzore.
3. Drejtoria e Marrjes në Sigurim dhe Korporatave.
4. Drejtoria e Administrimit dhe Aktuaristikës.
5. Sektori i Administrimit të Rrjetit të Degëve dhe IT-së.
6. Drejtoria e Shitjeve dhe Dega Tiranë.
7. Degët në rrethe.

Kontrolle me risk të lartë

- Analiza e shpenzimeve operative dhe minimizimi i shpenzimeve, që kanë efekt në rezultatin e shoqërisë, duke mbajtur parasysh nivelin e pranueshëm dhe të krahasueshëm me normën e tregut.
- Norma e likuiditetit dhe mbajtja në nivelin e kërkuar.
- Aftësia paguese, provigjionet teknike, aktivet në mbulim të provigjioneve.
- Administrimin e policave të shitura të sigurimit, rakordimi i primeve me kontabilitetin.
- Implementimi i programit të integruar.

Kontrolle me risk të mesëm

- Treguesit kryesorë të pasqyrave financiare, raportet statistikore dhe kontabël, analiza e shpenzimeve administrative dhe ato të marrjes në sigurim, analiza e zërave të veçantë të pasqyrave financiare.
- Kontroll i kërkesave për arkëtim dhe detyrimeve të debitorëve, mosha e krijimit të tyre, afatet e pagesave si dhe arkëtimi i tyre në kohë.
- Procedurat e blerjeve dhe shpenzimet që lidhen me to.
- Qiratë e ambienteve dhe investimet e kryera për përmirësimin e tyre.
- Transaksionet me palët e lidhura dhe raportimet përkatëse pranë autoritetit.
- Administrimi i policave të shitura të sigurimit, rakordimi i primeve me kontabilitetin, llogaritja e shpenzimeve

të marrjes në sigurim, efektiviteti i këtyre shpenzimeve, zbatimi i udhëzimit të marrjes në sigurim.
- Marrja në sigurim, tarifimi dhe administrimi i produkteve të sigurimit të jetës, kontratat e bashkësigurimit, kontratat fakultative.
- Inventarizimi i policave të shitura dhe ato gjendje si në qëndër dhe në deget ku ushtrohet aktiviteti i shoqërisë.
- Trajnimi i stafit.
- Praktikat e ngjarjeve të sigurimit, zbatimi i ligjit dhe i udhëzimeve të brendshme, likuidimi i tyre.
- Zbatimi i proceduarave të ruajtjes dhe administrimit të policave të sigurimit, si dhe vlerave të tjera monetare dhe materiale, dokumentimi i tyre.
- Procedura e rekrutimit të punonjësve të rinj, trajnimi i stafit, pagesa e punës, kohëshënuesi i punonjësve, shpërblimet e stafit, etj.
- Parandalimi i pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.
- Ndjekja e rekomandimeve.

Kontrolle me risk të ulët

- Procedura e rekrutimit të punonjësve të rinj.
- Vendimet e rekrutimit dhe largimit.
- Vlerësimi i performancës.
- Pagesa e punës, kohëshënuesi i punonjësve, shpërblimet e stafit.
- Inventarizimi në degë.
- Administrimi i policave që anullohen.
- Ndjekja e rekomandimeve.

Identifikimi i risqeve

- Risku financiar dhe i kontabilitetit.
- Risku i sigurimit dhe risigurimit.
- Risku ligjor.
- Risku në lidhje me ngjarjet e sigurimit.

Kontrolli dhe vlerësimi


- Sistemet e administrimit të riskut të zbatuar nga shoqëria SiCRED sh.a.
- Përputhshmëria e shoqërisë me ligjet dhe aktet nënligjore, procedurat e brendshme të shoqërisë, zbatimi i politikave dhe arritja e objektivave të vendosura.
- Sistemi i informacionit dhe i raportimeve duke përfshirë saktësinë e të dhënave.

7. Opinioni i Njësisë së Auditit të Brendshëm

Njësia e Auditit të Brendshëm ka realizuar detyrat e planifikuara bazuar në planin auditit të miratuar nga Këshilli Mbikëqyrës për vitin 2019.
Gjatë punës së kryer janë evidentuar elementë me risk të lartë të cilat do të sillnin një impakt në zhvillimin e aktivitetit të Shoqërisë për të cilat ka dhënë rekomandimet përkatëse. Për çdo kontroll të kryer janë nxjerrë konkluzionet dhe atje ku janë konstatuar elementë për t'u përmirësuar janë dhënë rekomandimet të cilat janë pranuar nga drejtimi. Njësia e Auditit duke kryer procedurat dhe verifikimet përkatëse ka ndikuar në identifikimin, kontrollin dhe administrimin e risqeve që mbulon secila drejtori apo degë.



Njësia e Auditit të Brendshëm
Matilda THOMA



SiCRED sh.a.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

Përmbajtja

Raporti i Audituesit të Pavarur.....29
Pasqyra e Konsoliduar e Pozicionit Financiar.....32
Pasqyra e Konsoliduar e të Ardhurave gjithëpërfshirëse.....33
Pasqyra e Konsoliduar e Lëvizjeve të Kapitalit.....34
Pasqyra e Konsoliduar e Fluksit të Parasë.....35
Shënimet Shpjeguese të Pasqyrave Financiare të Konsoliduara.....37-73

Grant Thornton Sh.p.k.
Rr. Sami Frasheri , kompleksi T.I.D
Hyrja B.Kati 1
1000 Tirana
Albania

T +355 44 525 880
M +355 69 4014 701
www.grantthornton.al
contact@al.gt.com

Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionerët e Sicred sh.a,

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Sicred sh.a ("Grupi"), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar me datën 31 dhjetor 2019, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar te ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të rrjedhës së parasë për vitin që mbyllet me këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat e konsoliduara financiare, përfshirë një përmbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare te konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të konsoliduar te Bankës me datën 31 dhjetor 2019, dhe performancën e konsoliduar financiare dhe flukset e konsoliduara te parasë për vitin që mbyllet në këtë datë, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Konsoliduara.* Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesioniste të njohur nga Bordi Ndërkombëtar i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), kërkesat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

Përgjegjësitë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare të Konsoliduara

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontrolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përmbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Grupin ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjetër reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtrimit dhe konsiderohen materiale nëse, indiviualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojme gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë proçedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i moszbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtrimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtrimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretime, ose shkelje të kontrolleve të brendshme.
- marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmërinë e kontrolleve të brendshme të Grupit.
- vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.

- konkludojmë mbi përdorimin e duhur te parimit kontabël të vijimësisë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojme që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tona janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që Grupi të ndalojë së vazhduari në vijimësi.
- vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përmbajtjen e pasqyrave financiare te konsoliduara, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare te konsoliduara paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrijnë një prezantim të drejtë.
- marrim evidence të mjaftueshme të auditimit në lidhje me informacionin financiar të subjekteve ose aktiviteteve të biznesit brenda Grupit për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për drejtimin, mbikëqyrjen dhe performancën e auditimit të Grupit. Ne jemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojme me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin dhe kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të theksuar në kontrollin e brëndshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë proçesit të auditimit.

Grant Thornton sh.p.k.

Tiranë, Shqipëri
22 qershor 2020

Kledian Kodra, FCCA

Grant Thornton Sh.p.k. NIPT K 91923007 M Tirana ALBANIA

PASQYRA E KONSOLIDUAR E POZICIONIT FINANCIAR

më 31 dhjetor 2019

		31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
	Shënime	në LEK	në LEK
AKTIVET			
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	8	29,046,016	38,193,393
Depozita me afat	9	404,355,990	381,738,817
Investime në letra me vlerë	10	148,846,354	139,193,922
Fond investimi	11	15,141,330	-
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi	12	35,592,371	43,030,129
Aktive të risigurimit	14	9,849,108	8,663,205
Shpenzime të marrjes në sigurim të shtyra	13	21,432,593	12,721,480
Parapagim i tatimit mbi fitimin		114,001	1,020,748
Aktiv tatimor i shtyrë		289,120	-
Aktive të tjera	15	12,817,119	14,380,303
Investime në pjesëmarrje	16	6,320,556	4,921,353
Aktivet e trupëzuara, neto	18,19	40,215,262	42,263,062
Aktive ne përdorim (Ambiente me qira)	18	76,220,816	-
Aktivet e patrupëzuara, neto	17	6,732,700	6,332,700
TOTALI I AKTIVEVE		**806,973,336**	**692,459,112**
DETYRIMET			
Detyrime të tjera	20	14,746,045	19,493,926
Detyrime për qira te aktiveve ne përdorim	19	77,395,572	-
Llogari të pagueshme sigurimi dhe risigurimi	21	11,853,170	9,317,518
Detyrime ndaj institucioneve financiare	22	3,198,735	359,531
Detyrim tatimor i shtyre		289,120	-
Detyrimet për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve për humbjen	23	30,430,503	15,621,509
Rezerva për primin e pafituar	24	139,867,964	154,143,270
Rezerva të tjera	25	35,348,623	37,267,672
Totali i Detyrimeve		**313,129,732**	**236,203,426**
KAPITALI			
Kapitali i paguar	26	490,062,000	490,062,000
Fitimi/Humbje të mbartura		(33,806,313)	(43,098,337)
Fitimi/Humbja e vitit		37,587,917	9,292,024
Totali i kapitalit i kredituar te pronaret		**493,843,604**	**456,255,687**
Interesi jo-kontrollues		-	-
Totali kapitalit		**493,843,604**	**456,255,687**
TOTALI I DETYRIMEVE DHE KAPITALI		**806,973,336**	**692,459,113**

Genc Koxhaj
Drejtor i Përgjithshëm

SHOQERIA E SIGURIMIT TE JETES SICRED DREJTORIA E PERGJITHSHME TIRANE

Teuta Locaj
Drejtore e Drejtorisë së Financës dhe Kontabilitetit

Shënimet shoqëruese në faqet 37 deri 73 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.

PASQYRA E KONSOLIDUAR E TË ARDHURAVE GJITHPËRFSHIRËSE

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019 në LEK	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018 në LEK
Të ardhura nga primet e shkruara bruto	27	259,724,961	257,648,069
Prime të shkruara bruto të risiguruesit	28	(15,295,313)	(13,872,494)
Prime të shkruara neto		**244,429,648**	**243,775,575**
Ndryshimi neto në rezervën e primeve të pafituara	24	14,275,308	3,461,079
Ndryshimi neto në rezerva të tjera	25	1,919,049	15,732,994
Ndryshimi neto në rezervën e risiguruesit	13	1,185,903	(2,038,960)
Ndryshimi neto në shpenzime të shtyra	14	8,711,113	(4,292,187)
Të ardhura neto nga primi i sigurimit		**270,521,021**	**256,638,501**
Të ardhura financiare	29	7,578,496	3,841,970
Të ardhura nga shitja e aksioneve		-	132,177
Fitim/(Humbje) në ndryshimin e vlerës së mbartur të investimit në pjesëmarrje		-	(4,921,353)
Përqindja e Fitimit/humbjes tek pjesëmarrja për periudhën	16	1,399,203	1,038,805
Të ardhura të tjera operative	30	14,156,190	8,931,466
Totali i të ardhurave		**293,654,910**	**265,661,566**
Dëme të ndodhura të sigurimit	23	(62,233,557)	(54,740,724)
Kostot e marrjes në sigurim	31	(64,972,029)	(73,388,171)
Shpenzime personeli	32	(69,642,758)	(69,449,118)
Shpenzime administrative	33	(39,645,297)	(50,606,794)
Amortizimi	18	(18,666,605)	(8,184,735)
Totali i shpenzimeve		**(255,160,246)**	**(256,369,542)**
(Humbje)/Fitimi para tatimit		**38,494,664**	**9,292,024**
Tatimi mbi fitimin	34	906,747	-
(Humbja)/Fitimi i vitit, neto		**37,587,917**	**9,292,024**
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse		-	-
Totali i (humbjes)/fitimit gjithëpërfshirës të vitit		**37,587,917**	**9,292,024**
(Humbja)/Fitimi alokuar tek:			
Pronarët e Shoqërisë		37,587,917	9,292,024
Interesi jo-kontrollues			
		37,587,917	**9,292,024**
Totali i (humbjes)/fitimit gjithëpërfshirës alokuar tek:			
Pronarët e Shoqërisë		37,587,917	9,292,024
Interesi jo-kontrollues			
		37,587,917	**9,292,024**

Shënimet shoqëruese në faqet 37 deri 73 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.

PASQYRA E KONSOLIDUAR E LËVIZJEVE TË KAPITALIT

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Kapitali i paguar	Fitim i akumuluar	Totali	Interesa jo-kontrollues	Totali Kapitalit
	në LEK	në LEK	në LEK	në LEK	në LEK
Gjendja më 31 dhjetor 2017	**481,000,000**	**(44,228,189)**	**436,771,811**	**-**	**436,771,811**
Rregullim për diferencën e vlerës kontabël të investimit në pjesëmarrje		1,129,852	1,129,852		1,129,852
Fitimi i vitit	-	9,292,024	9,292,024	-	9,292,024
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi	-	-	-	-	-
Totali i fitimeve përmbledhëse për periudhën	**-**	**10,421,876**	**10,421,876**	**-**	**10,421,876**
Transaksione me pronarët e Shoqërisë					
Regjistrimi i kapitalit	9,062,000	-	9,062,000	-	9,062,000
Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë	**9,062,000**		**9,062,000**	**-**	**9,062,000**
Gjendja më 31 dhjetor 2018	**490,062,000**	**(33,806,313)**	**456,255,687**	**-**	**456,255,687**
Fitimi/Humbja e vitit	-	37,587,917	37,587,917		37,587,917
Të ardhura të tjera përmbledhëse, neto nga tatimi	-				
Totali i humbjeve përmbledhëse për periudhën	**-**	**37,587,917**	**37,587,917**		**37,587,917**
Totali i transaksioneve me pronarët e Shoqërisë	**-**	**-**	**-**	**-**	**-**
Gjendja më 31 dhjetor 2019	**490,062,000**	**3,781,604**	**493,843,604**	**-**	**493,843,604**

Shënimet shoqëruese në faqet 37 deri 73 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.

PASQYRA E KONSOLIDUAR E FLUKSIT TË PARASË

për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

	Shënime	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2019 në LEK	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2018 në LEK
Fluksi i parasë nga aktivitetet operative			
(Humbja)/Fitimi neto për vitin		**38,494,664**	**9,292,024**
Rregullime për:			
Amortizimin	18	18,657,438	8,184,733
Humbje nga nxjerrja jashtë përdorimit e aktiveve të qëndrueshme	18	707,385	484,453
Ndryshimi në rezervën për primet e pafituara	24	(14,275,308)	(3,461,079)
Ndryshimi në rezervën e risigurimit	13	(1,185,903)	2,038,960
Ndryshimi në rezerva të tjera	25	(1,919,049)	(15,732,994)
Ndryshimi në humbje dhe shpenzimet e rregullimit të humbjeve	23	14,808,994	(3,794,493)
Zhvlerësim për borxhin e keq	12	3,171,079	1,297,399
Shpenzime interesi	29	3,965,774	41,228
Të ardhurat nga interesi	29	(12,506,429)	(13,296,792)
Fluksi i parasë përpara ndryshimeve ne aktive dhe detyrime		**49,918,645**	**(14,946,561)**
Humbje në ndryshimin e vlerës së mbartur të investimit në pjesëmarrje	16	(1,399,203)	3,882,548
Ndryshime në aktivet dhe detyrimet operative:			
Ndryshimi në kostot e marrjes në sigurim	13	(8,711,113)	4,292,187
Ndryshimi në te ardhura te shtyra			
Ndryshimi në llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe risigurimit	12	4,266,679	29,089,447
Ndryshimi në aktivet e tjera	15	655,081	1,019,991
Ndryshimi në mjetet monetare të kushtëzuara	8	(2,850,215)	396,137
Ndryshimi në llogari të pagueshme të sigurimit dhe risigurimit	21	2,535,652	(8,873,101)
Ndryshimi në detyrime të tjera	20	(4,747,881)	(30,102,870)
Ndryshimi në llogaritë me palët e lidhura	15	620,614	-
Ndryshimi në llogaritë e aktiveve ne përdorim	19	(9,761,076)	-
Interes i arkëtuar	29	12,506,429	13,296,792
Interes i paguar	29	(3,965,768)	(41,228)
Tatim fitimi i paguar		-	2,074,308
Flukset monetare të gjeneruara nga operacionet		**39,067,844**	**87,650**
Flukset monetare nga aktivitetet investuese			
Blerja e aktiveve të trupëzuara	18	(6,093,705)	(636,051)
Blerja e aktiveve të patrupëzuara	17	(400,000)	(2,333,100)
Investimi në pjesëmarrjet		-	13,927,823
Rritja në depozita me afat	9	(22,617,173)	31,343,240
Letra me vlere të blera		(25,000,000)	(30,117,380)
Letra me vlerë të maturuara	10	16,180,000	
Investimi në letra me vlerë	11	(15,141,330)	-
Flukset monetare të përdorura për aktivitetet investuese		**(53,904,640)**	**12,184,532**
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet financuese			

Rritje kapitali		-	9,062,000
Shlyerje e huasë		-	(12,469,987)
Përdorimi i overdraftit		385,372	359,531
Qiraja financiare	22	2,453,832	-
Flukset monetare të përdorura në aktivitetet financuese		**2,839,204**	**(9,048,456)**
Rritje/(rënie) neto për mjetet monetare dhe ekuivalente		**(11,997,592)**	**9,223,728**
Mjete monetare dhe ekuivalentë në fillim të vitit	8	36,646,732	27423007
Efekti i ndryshimeve të këmbimeve valutore		-	(3)
Mjete monetare dhe ekuivalentë në fund të vitit	8	**24,649,140**	**36,646,732**

Shënimet shoqëruese në faqet 37 deri 73 janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave të konsoliduara financiare.

1. TË PËRGJITHSHME

SiCRED sh.a ("Shoqëria") u krijua më 7 tetor 2003 si një Shoqëri Sigurimi Jete me vendndodhje në Shqipëri. Shoqëria u licencua nga Autoriteti Mbikëqyrës i Sigurimeve ("Autoriteti") dhe filloi aktivitetin e saj të sigurimit më 1 tetor 2004.

Shoqëria ka degë të vendosura kryesisht në Tiranë, Durrës, Shkodër, Fier, Vlorë, Gjirokastër, Elbasan, dhe Korçë. Tregu i Sigurimeve në Shqipëri, është i rregulluar me ligjin Nr. 52/2014 datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit."

Grupi SiCRED Sh.a përbëhet nga SiCRED Sh.a në cilësinë e mëmës, SiCRED Assistance Sh.p.k, ku SiCRED Sh.a zotëron 100% të kuotave, "CREDINS INVEST - Shoqëria administruese e Fondeve të Pensioneve dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive, ku SiCRED sh.a. zotëron 12% të aksioneve. Informacion për Grupin paraqitet në shënimin 7.

Pasqyrat Financiare të konsoliduara përfshijnë Shoqërinë dhe Filialet e saj (së bashku të referuara si "Grupi"). Më 31 dhjetor 2019, Grupi kishte të punësuar 56 punonjës dhe personel drejtues (2018: 60).

Adresa e zyrave qendrore të bankës dhe vendit kryesor të ushtrimit të aktivitetit është: Rruga "Vaso Pasha," Nr. 8, Tiranë, Shqipëri.

2. BAZAT E PËRGATITJES

a) Baza e Përputhshmërisë

Pasqyrat financiare te konsoliduara janë përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), lëshuar nga Bordi i Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit. Pasqyrat financiare te konsoliduara janë përgatitur në bazë të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF 10 dhe SNK 8).

b) Baza e përgatitjes

Pasqyrat financiare janë përgatitur në bazë të parimit të kostos historike, përveç fondeve të investimit të cilat mbahen me vlerën e drejtë.

c) Monedha funksionale dhe e prezantimit

Këto pasqyra financiare janë të prezantuara në Lek, që është dhe monedha funksionale e Grupit. Përveç rasteve ku specifikohet ndryshe, informacioni financiar është i prezantuar në Lek.

d) Përdorimi i vlerësimeve dhe gjykimit

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që drejtuesit të kryejnë gjykime, vlerësime dhe supozime të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave kontabël dhe shumat e raportuara të aktivëve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësimeve. Vlerësimet dhe bazat e llogaritjes rishikohen në mënyrë të vazhdueshme.. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimet rishikohen dhe për periudhat e ardhshme të cilat ndikohen nga rishikimi. Në veçanti, informacioni rreth fushave më kryesore për llogaritjen e gjykimeve të pasigurta dhe kritike në aplikimin e politikave kontabël që kanë efektin më të rëndësishëm në shumat e njohura në pasqyrat financiare përshkruhen në shënimet 5, 11, 12, dhe 23.

e) Bazat e konsolidimit

Pasqyrat financiare të konsoliduara përbëhen nga pasqyrat financiare të Grupit dhe të filialeve të tij më 31 dhjetor 2019. Kontrolli arrihet kur Grupi ekspozohet ose ka të drejta mbi fitimet e ndryshueshme si pasojë e përfshirjes së tij me të investuarin dhe ka aftësinë për të ndikuar mbi ato kthime nëpërmjet zotërimit që ka mbi të investuarin. Në mënyre specifike, Grupi kontrollon investimin nëse dhe vetëm nëse Grupi përmban të gjitha karakteristikat në vijim:

- Fuqinë mbi të investuarin (p.sh. të drejta ekzistuese që japin mundësinë për të drejtuar aktivitetet e kryesore të të investuarit)
- Ekspozimi ose të drejtat ndaj kthimeve të ndryshueshme nga përfshirja me të investuarin.

2. BAZAT E PËRGATITJES (vazhdim)

e) Bazat e konsolidimit (vazhdim)

- Aftësia për të përdorur fuqinë mbi të investuarin për të ndikuar në shumën e kthimit nga investimi.

Zakonisht ekziston një supozim se shumica e të drejtave të votave rezulton në kontroll. Për të mbështetur këtë supozim dhe kur Grupi ka më pak se shumica e të drejtave të votave ose të drejtave të ngjashme të një të investuari, Grupi merr në konsideratë të gjitha faktet relevante dhe rrethanat në vlerësimin nëse ka fuqi mbi të investuarin, duke përfshirë:

- Marrëveshje kontraktuale me votëmbajtësit e tjerë të të investuarit
- Të drejta që rrjedhin nga marrëveshje kontraktuale të tjera
- Të drejtat e votës se Grupit dhe të drejtat potenciale të votës.

Grupi rivlerëson nëse ai ka kontroll mbi të investuarin, nëse fakte ose rrethana tregojnë se ka ndryshime në një ose më shumë nga tre elementët e kontrollit. Konsolidimi i një filiali fillon kur Grupi merr kontrollin mbi filialin dhe mbaron kur Grupi humbet kontrollin mbi të. Aktivet, detyrimet, të ardhurat dhe shpenzimet e një filiali të blerë ose të shitur gjatë vitit përfshihen në pasqyrat financiare të konsoliduara nga data në të cilën Grupi fiton kontrollin deri në datën në të cilën Grupi nuk ka më kontroll mbi filialin.

Fitimi apo humbja dhe çdo element i pasqyrës së të ardhurave përmbledhëse i atribuohen mbajtësve të kapitalit të mëmës së Grupit dhe interesave jo-kontrolluese, edhe pse kjo mund të rezultojë në një kontroll jo-zotërues me balancë deficite. Kur është e nevojshme, bëhen rregullime të pasqyrave financiare të filialeve për të vendosur politikat e tyre kontabël në të njëjtën linjë me politikat kontabël të Grupit. Të gjitha aktivet dhe detyrimet e kompanive të Grupit, kapitali, të ardhurat, shpenzimet dhe flukset e parasë të lidhura me transaksionet mes pjesëtarëve të Grupit eliminohen plotësisht gjatë konsolidimit.

Një ndryshim në pronësinë e interesit të një filiali, pa humbje kontrolli, regjistrohet si një transaksion në kapital.

Nëse Grupi humbet kontrollin mbi një filial, ai çregjistron aktivet e lidhura (përfshirë emrin e mirë), detyrimet, interesat jo-kontrolluese dhe përbërës të tjerë të kapitalit, ndërkohë që çdo fitim apo humbje që rezulton njihet në fitim ose humbje. Çdo investim i mbajtur njihet fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas si pjesë e aseteve neto të të investuarit (për bashkëpunëtorët ose sipërmarrjet e përbashkëta).

f) Parimi i vijimësisë

Pasqyrat financiare te Grupit përgatiten në përputhje me parimin e vijimësisë, i cili nënkupton se Grupi do të vazhdojë operacionet e tij në një periudhë kohe të papërcaktuar, në të ardhmen e parashikueshme.

Kapitali i mjaftueshmërisë

Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019, shoqëria mëmë ka rezultuar me kapital prej 59,251,386 lekë (2018: 22,156,642 Lek), i cili përbën dhe aftësinë paguese, dhe aktive në mbulim të provigjioneve teknike prej 124.77% (2018: 100.5 %) mbi nivelin e normave të kërkuara nga ligji dhe aktet rregulluese të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare. Informacioni shpjegues rreth ligjit dhe rregulloreve në fuqi deri në datën e raportimit për llogaritjen e këtyre raporteve është paraqitur në skedulet suplementare të pasqyrave financiare individuale.

Impakti i Covid 19

Në 11 Mars 2020, Organizata Botërore e Shëndetit deklaroi gjendjen e COVID-19 si një pandemi në nivel global. Duke iu përgjigjur kërcënimit potencialisht serioz që COVID - 19 paraqet për shëndetin publik, në 12 Mars 2020 autoritetet qeveritare të Shqipërisë kanë ndërmarrë masa për kontrollimin e përhapjes, duke përfshirë futjen e kufizimeve në lëvizjen ndërkufitare të njerëzve, kufizimet e hyrjes për vizitorët e huaj në pritje të zhvillimeve të mëtejshme. Në veçanti, shkollat, universitetet, restorantet, kinematë, teatrot, muzetë dhe objektet sportive, shitësit me pakicë, duke përjashtuar shitësit e ushqimit, dyqanet ushqimore dhe farmacitë ishin të mbyllura. Disa biznese në Shqipëri gjithashtu kanë udhëzuar punonjësit të qëndrojnë në shtëpi dhe kanë zvogëluar ose pezulluar përkohësisht operacionet e biznesit.

Bazuar në informacionin e disponueshëm publikisht, në datën kur këto pasqyra financiare ishin të autorizuara për dorëzim, Drejtimi konsideroi një numër skenarësh në lidhje me zhvillimin e mundshëm të shpërthimit dhe ndikimin e tij të pritshëm në njësinë ekonomike dhe mjedisin ekonomik në të cilin ajo operon, përfshirë masat që pritet të merren nga qeveria.

2. BAZAT E PËRGATITJES (vazhdim)

f) Parimi i vijimësisë (vazhdim)

Drejtimi gjatë vlerësimit të situatës morri parasysh faktet si:

- Shtyrja si dhe pasiguria e kryerjes së tenderave të subjekteve dhe institucioneve shtetërore përsa i përket klientëve të Jetës AP ne Grup, e cila ka rezultuar në një ulje të primeve të shkruara me rreth 70% të kësaj kategorie për periudhën janar-prill 2020 krahasuar me te njëjtën periudhe gjate vitit 2019.
- Anulimi i disa policave te Jetës për Hua, kryesisht te kliente te Credins Bank, si rrjedhojë e uljeve dhe mosarkëtimeve, e cila a rezultuar ne një ulje te primeve te shkruara me rreth 25% te kësaj kategorie për periudhën janar-prill 2020 krahasuar me te njëjtën periudhe gjate vitit 2019.
- Mbyllja e kufijve për një afat te papërcaktuar, i cili ka afektuar ne mos kryerjen e shitjeve te policave Shëndeti ne Udhëtim ose Studenti Jashtë, e cila a rezultuar ne një ulje te primeve te shkruara me rreth 70% te këtyre kategorie për periudhën janar-prill 2020 krahasuar me te njëjtën periudhe gjate vitit 2019.
- Ulja e dëmeve te paguara me rreth 19% për periudhën janar-prill 2020 krahasuar me te njëjtën periudhe gjate vitit 2019.
- Pezullimi i investimeve te parashikuara për vitin 2020 me një vlere afërsisht 1.5 milion leke. Këto investime lidhen kryesisht me rikonstruksionin e ambienteve ne Zyrat Qendrore dhe ngritjen e një aktiviteti te ri (jo ne fushën e sigurimit).

Drejtimi ka ndërmarrë veprime që synojnë zbutjen e risk-ut financiar, të cilat përfshijnë veçanërisht:

- Te negocioje me qiradhënësin e Zyrave qendrore për te ulur këstin me 20%
- Reduktimin e shpenzimeve te parashikuara për shpërblime, trajnime si dhe shpenzime te tjera te përgjithshme
- Reduktimin e kostove të stafit si dhe shtyrja e rekrutimeve te punonjësve te cilët ishin planifikuar te punësoheshin gjate kësaj periudhe.

Drejtimi gjykon qe situata financiare e Grupit është e qëndrueshme, pasi ka siguri qe do te kryhet realizimi i disa tenderave të planifikuar ne 3-mujorin e parë të vitit. Grupi ka likuiditet të mjaftueshëm për të përmbushur detyrimet e tjera tregtare, detyrimet ndaj personelit si dhe ato ndaj autoriteteve tatimore.

Si rrjedhojë, drejtimi parashikon qe Shoqëria do të ketë burime te mjaftueshme për te siguruar vijueshmërinë e biznesit për një periudhë të paktën 12 muaj nga data e raportimit. Drejtimi arriti në përfundimin se tërësia e rezultateve të mundshme të konsideruara për të arritur në këtë gjykim nuk krijon paqartësi materiale në lidhje me ngjarje ose kushte që mund të hedhin dyshime të mëdha në aftësinë e Shoqërisë për të vijuar aktivitetin.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME

Politikat kontabël të paraqitura më poshtë janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare dhe janë aplikuar në mënyrë të vazhdueshme nga Grupi.

a) Ndryshim në politikat kontabël

Gjate vitit 2019, Grupi nuk ka ndryshuar politikat kontabël. Kërkesat e standardit të ri të kontabilitetit për SNRF 16 Qiratë hynë në fuqi në 1 janar 2019. Ndryshimet shpjegohen më hollësisht në shënimet në pjesën e shënimeve shpjeguese përkatëse, parimet që përmbajnë pasqyrat financiare nën ndryshimet në prezantimin e pasqyrave financiare dhe kalimin e SNRF 16.

b) Kombinimi i biznesit dhe emri i mirë

Kombinimet e biznesit kontabilizohen duke përdorur metodën e blerjes në datën e blerjes. Kostoja e blerjes matet si një përbërje e vlerës së transferuar, e cila matet me vlerën e drejtë në datën e blerjes, dhe çdo shumë të ndonjë interesi jo-kontrollues të njësisë së blerë. Për çdo kombinim biznesi, Grupi zgjedhë nëse do të masë interesin jo-kontrollues të njësisë së blerë me vlerë të drejtë ose me vlerën proporcionale të aktiveve te identifikueshme neto.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (vazhdim)

c) Investimi në filiale dhe sipërmarrjet e përbashkëta

Kostot e lidhura me blerjen regjistrohen si shpenzim i ndodhur dhe përfshihen në shpenzimet administrative.

Kur Grupi blen një biznes, ai vlerëson aktivet dhe detyrimet financiare për klasifikim të përshtatshëm dhe paraqitje në lidhje me termat kontraktuale, rrethanat ekonomike dhe kushtet përkatëse në datën e blerjes.

Çdo aktiv i mundshëm për tu transferuar nga blerësi do të njihet me vlerën e drejtë në datën e blerjes.

Emri i mirë matet fillimisht me kosto (duke qenë shuma e mbledhur e tejkalimit të konsideratës së transferuar dhe shumës së njohur si interes jo-kontrollues) dhe ndonjë interes i mëparshëm i mbajtur mbi aktivet neto të identifikueshme dhe detyrimet e supozuara. Nëse vlera e drejtë e aktiveve neto të blera është më e madhe se shuma e agreguar e konsideratës së transferuar, atëherë fitimi njihet në të ardhura dhe shpenzime.

Pas njohjes fillestare, emri i mirë matet me kosto minus çdo humbje të akumuluar nga zhvlerësimi.

Kur emri i mirë është alokuar në një Njësi Gjeneruese të Parasë dhe pjesë e atij aktiviteti brenda njësisë është shitur, emri i mirë lidhur me aktivitetin e shitur përfshihet në vlerën e mbetur të aktivitetit kur përcaktohet fitimi apo humbja nga shitja. Emri i mirë i shitur në këto rrethana matet bazuar në vlerat relative të aktivitetit të shitur dhe pjesës së Njësisë së Gjenerimit të Parasë së mbajtur.

Filialet janë subjekte mbi të cilat grupi ka influencë domethënëse. Influencë domethënëse është fuqia për të marrë pjesë në vendimet për politikat financiare dhe operative të të investuarit, por nuk është kontroll ose kontroll i përbashkët i këtyre politikave.

Një sipërmarrje e përbashkët është një marrëveshje e përbashkët ku palët që kanë kontroll të përbashkët në marrëveshje, kanë të drejta në aktivet neto të marrëveshjes. Kontroll i përbashkët është një ndarje kontraktuale e kontrollit të një marrëveshjeje, e cila ekziston vetëm kur vendimet për aktivitetet relevante kërkojnë konsensus unanim të palëve që ndajnë kontrollin.

Vlerësimet e bëra në përcaktimin e influencës domethënëse ose kontrollit të përbashkët janë të ngjashme me ato vlerësime që janë të nevojshme për të përcaktuar kontrollin ndaj filialeve.

Investimet e Grupit në filiale dhe sipërmarrje të përbashkëta kontabilizohen duke përdorur metodën e kapitalit. Sipas metodës së kapitalit neto, investimi në një filial apo në një sipërmarrje të përbashkët njihet fillimisht me kosto. Emri i mirë në lidhje me një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët përfshihet në vlerën kontabël të investimit. Amortizimi i emrit të mirë nuk lejohet. Vlera mbartëse e investimit rregullohet për të njohur ndryshimet në pjesën e Grupit në aktivet neto të filialeve apo sipërmarrjeve të përbashkëta duke filluar nga data e blerjes. Emri i Mirë që lidhet me filialet apo me sipërmarrjet e përbashkëta është i përfshirë në shumën mbartësve të investimit dhe nuk testohet për zhvlerësim i vetëm. Çdo blerje shtesë e aksioneve në pjesëmarrje, që mbetet një pjesëmarrje, llogaritet nëpërmjet metodës se akumulimit të kostos, d.m.th. çmimi i blerjes i paguar për interesin shtesë i shtohet vlerës kontabël ekzistuese të pjesëmarrjes dhe interesi ekzistues në pjesëmarrje nuk llogaritet përsëri.

Pasqyra e fitimit dhe humbjes përfaqëson pjesën e fitimit ose humbjes së Grupit nga aktivitetet e pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët. Çdo ndryshim në Pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse të të investuarit prezantohet si pjesë e pasqyrës së të ardhurave përmbledhëse të Grupit.

Për më tepër, nëse ka pasur ndonjë ndryshim i regjistruar direkt në kapitalin e pjesëmarrjes ose të sipërmarrjes së përbashkët, Grupi regjistron pjesën e tij të ndryshimit në pasqyrën e lëvizjeve të kapitalit, kur është e aplikueshme. Fitimet ose humbjet e parealizuara, të cilat rezultojnë nga transaksionet mes Grupit dhe pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët eliminohen në masën e interesit në pjesëmarrje ose sipërmarrjen e përbashkët. Pjesa agregate e Grupit në fitimin dhe humbjen e një pjesëmarrje apo sipërmarrje të përbashkët paraqitet në pasqyrën e fitim/humbjes jashtë të ardhurave operative dhe përfaqëson fitimin ose humbjen pas tatimit dhe interesin jo-kontrollues në filialet pjesëmarrjes apo në sipërmarrjet e përbashkëta.

Pasqyrat financiare të pjesëmarrjes ose të sipërmarrjes së përbashkët përgatiten për të njëjtën periudhë raportimi si Grupi. Kur është e nevojshme, bëhen rregullime për të vendosur politikat kontabël në të njëjtën linjë me ato të Grupit.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (vazhdim)

d) Transaksionet në monedhë të huaj

Pas aplikimit të metodës së kapitalit, Grupi vendos nëse është e nevojshme të njohë një zhvlerësim të investimit në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët. Në çdo datë raportimi, Grupi përcakton nëse ka ndonjë të dhënë objektive për zhvlerësimin e investimit në pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët.

Nëse një e dhënë e tillë ekziston, Grupi llogarit shumën e zhvlerësimit të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët si ndryshimin midis shumës së rikuperueshme dhe vlerës kontabël, dhe më pas njeh humbjen si "Pjesa e fitimit në një pjesëmarrje dhe në sipërmarrje të përbashkët" në pasqyrën e fitimit dhe humbjes.

Me humbjen e influencës zotëruese mbi një pjesëmarrje ose sipërmarrje të përbashkët, Grupi mat dhe njeh ndonjë investim të mbajtur me vlerën e drejtë. Çdo diferencë mes vlerës kontabël të pjesëmarrjes ose sipërmarrjes së përbashkët pas humbjes së influencës zotëruese ose kontrollit së përbashkët dhe vlerës së drejtë të investimit të mbajtur dhe të hyrjeve nga shitja, njihet në fitim /humbje.

Transaksionet në monedhë të huaj këmbehen në monedhën funksionale të Grupit sipas kursit të këmbimit në datën e transaksionit. Aktivet dhe detyrimet monetare të regjistruara në monedha të huaja në datën e raportimit, këmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit të datës së raportimit. Fitimi ose humbja që vjen nga këmbimet valutore të aktiveve monetare, është diferenca midis kostos së amortizuar në monedhën funksionale në fillim të vitit, e rregulluar për interesin efektiv dhe pagesat gjatë vitit, dhe kostos së amortizuar në monedhë të huaj të këmbyer me kursin e këmbimit në fund të vitit.

Aktivet dhe detyrimet jo-monetare të regjistruara në monedhë të huaj që maten me vlerën e drejtë, rikëmbehen në monedhën funksionale me kursin e këmbimit në datën kur është caktuar vlera e drejtë. Zërat jo-monetare të regjistruara në monedhë të huaj që maten me kosto historike, këmbehen me kursin e këmbimit në datën kur kryhet transaksioni.

Kurset e këmbimit të përdorura më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë kurset zyrtare të Bankës së Shqipërisë (Lek ndaj monedhave të huaja) të paraqitura si më poshtë.

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
USD	108.64	107.82
EUR	121.77	123.42

e) Klasifikimi i kontratave të sigurimit dhe investimeve

Kontratat nën të cilat Grupi pranon të marrë një rrezik të rëndësishëm nga një palë tjetër (policë-mbajtësi) duke rënë dakot të kompensojë policë-mbajtësin për një ngjarje të caktuar të pasigurtë (ngjarja siguruese) e cila ka efekte negative për policë-mbajtësin, janë klasifikuar si kontrata sigurimi. Rreziku i sigurimit është një rrezik ndryshe nga rreziku financiar. Rreziku financiar është rreziku i ndryshimeve të mundshme të ardhshme në një ose në disa norma interesi specifike, çmimet e letrave me vlerë, kursi i këmbimit, indekset e çmimeve ose të normave, normat e kreditimit apo indekset e kreditimit ose variabla të tjerë, të siguruar në rastin e variablave jo-financiarë kur variabli nuk është specifik për një palë në kontratë. Kontratat e sigurimit mund të transferojnë një pjesë të rrezikut financiar.

f) Njohja dhe matja e kontratave

Primet

Primet për sigurimin e jetës-afat shkurtër

Primet e shkruara bruto përfshijnë detyrimet për shumat gjatë vitit financiar në përputhje me sigurimin direkt, pavarësisht nëse keto shuma mund të lidhen pjesërisht ose plotësisht me periudhat e mëvonshme kontabël. Primet paraqiten bruto nga komisionet e pagueshme ndaj ndërmjetësve dhe paraqiten neto nga taksat e pagueshme mbi to. Pjesa e fituar e primeve njihet si e ardhur. Primet fitohen që nga momenti i lidhjes me rrezikun përgjatë gjithë periudhës së mbuluar në bazë të modelit të rrezikut të marrë përsipër.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (vazhdim)

f) Njohja dhe matja e kontratave (vazhdim)

Primet e sigurimit të jetës – afatgjatë

Për kontratat e sigurimit të huamarrësve të Bankave të nivelit të dytë në Shqipëri dhe që kanë një maturim më të madh se një vit, për mbulimin e huasë gjatë periudhës së ripagimit, Grupi e njeh primin e tij vjetor të shkruar kur lëshon kontratën e tij të sigurimit. Pjesa e mbetur e kontratës afatgjatë të sigurimit, e cila nuk njihet në periudhën raportuese, paraqitet si një angazhim i ardhshëm i Grupit.

Primet e risigurimit

Primet e risigurimit të jashtëm njihen si një shpenzim në përputhje me modelin e shërbimit të risigurimit. Nëse një politikë e sigurimit anulohet, primi i mbetur për t'u paguar ndryshohet në të ardhurat nga primi. Lëvizja e detyrimeve të sigurimit njihet si e ardhur neto e pjesës së risiguruesve, nëse ka.

Të ardhurat nga investimet

Të ardhurat nga investimet paraqiten bruto. Interesi për depozitat me afat dhe letrat me vlerë të investimit grumbullohet në bazë të fitimeve të akumuluara proporcionale.

Rezerva për primin e pafituar

Primet e pafituara janë llogaritur në përputhje me pagesat individuale të rinovueshme të biznesit. Ato paraqesin atë pjesë të primeve të shkruara bruto e cila lidhet me mbulimin e sigurimit nga polica e lëshuar nga Grupi, e cila zgjatet në periudhat e ardhshme mbi datën e raportimit.

Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim

Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim janë shumat e kostove të blerjes të cilat zbriten kur llogaritet rezerva për primin e pafituar. Ato janë përcaktuar si pjesë e kostove të blerjes, llogaritur si përqindje e planit teknik të sigurimit dhe lidhen me periudha midis fundit të periudhës raportuese dhe datës së përfundimit të kontratës së sigurimit. Kostot aktuale të blerjes njihen plotësisht si shpenzim në periudhën aktuale.

Dëmet

Dëmet për sigurimin e jetës

Dëmet e lindura përbëhen nga pagesat e bëra gjatë vitit financiar së bashku me ndryshimin në provigjion për dëmet e ndodhura te ekspozuara gjatë vitit. Dëmet bruto të paguara përfshijë të gjithë shpenzimet e bëra për këto dëme, të cilat llogariten duke përdorur metodat e trekëndëshit.

Provigjionet për dëmet

Provigjionet për dëmet janë shumat e të gjitha dëmeve që kanë lindur gjatë periudhës financiare aktuale dhe të mëparshme, të cilat nuk janë paguar në përfundim të vitit fiskal. Provigjioni përfshin dëmet e ndodhura por të paraportuara, llogaritur si përqindje mbi dëmet e ndodhura por jo të shlyera, duke u bazuar në treg dhe historinë dëmeve të periudhave të mëparshme të grupit.

Biznesi afatgjatë (Rezerva të tjera)

Rezervat e biznesit afatgjatë lidhen me produktin e Jetës me Kursim dhe matet si shuma e plotë e fondit të akumuluar në datën e raportimit.

Risigurimi

Grupi çedon risigurimin në rrjedhën normale të biznesit me qëllim që të zvogëlojë humbjen neto nëpërmjet diversifikimit të rrezikut. Marrëveshjet e risigurimit nuk i heqin Grupit detyrimet ndaj policëmbajtësve. Primet e ceduara dhe përfitimet e rimbursimit paraqiten në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse dhe pasqyrën e pozicionit financiar me baza bruto. Kontratat të cilat kërkojnë një transferim të rrezikut të sigurimit kontabilizohen si sigurim. Shumat e rigjeneruara nga këto kontrata njihen në të njëjtin vit me dëmin përkatës.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (vazhdim)

f) Njohja dhe matja e kontratave (vazhdim)

Dëmet (vazhdim)

Aktivet e risiguruara përfshijnë balanca detyrimi nga shoqëria risiguruese për detyrimet e primeve të ceduara.

Shumat e rikuperueshme nga risiguruesit llogariten në mënyrë të vazhdueshme me provigjionin e dëmeve ose me dëmet e vendosura të lidhura me policën e risiguruar. Shumat e rikuperueshme nën kontratat e risigurimit llogariten për zhvlerësim në çdo datë. Këto aktive zhvlerësohen nëse ka të dhëna objektive, si pasojë e një ngjarje që ka lindur pas njohjes fillestare, për të cilat Grupi mund të mos i rimarrë të gjitha shumat që i detyrohen dhe ngjarja ka një impakt të matshëm në mënyrë të besueshme për shumat të cilat Grupi do të marrë nga risiguruesi.

Testi i mjaftueshmërisë së rezervës

Në çdo datë raportimi Grupi kryen teste për të siguruar mjaftueshmërinë e rezervave të dëmeve. Testet e para që kryhen janë Analiza e Raportit të Dëmeve dhe Analiza e Zhvillimit të provigjionit të dëmeve. Analiza e raportit të dëmeve kryhet çdo vit individualisht për të gjitha produktet kryesore të biznesit nga Grupi. Llogaritja bëhet vetëm mbi dëmet, si dhe mbi dëmet duke përfshirë kostot e blerjes dhe ndonjë kosto tjetër të jashtme si kostoja e mirëmbajtjes.

Për të kryer këtë analize, Grupi merr parasysh parashikimet aktuale për daljet e flukseve të parave. Grupi nuk i skonton këto flukse parash sepse shumica e dëmeve priten të shlyhen brenda vitit.

Gjithashtu, Grupi kryen edhe Analizën e Zhvillimit të provigjioneve të dëmeve për të vlerësuar metodologjinë e saj të përcaktimit të rezervave. Kjo analize kryhet në mënyrë të veçantë, por dhe të kombinuar për RBNS (të raportuara, por ende të pambyllura) dhe IBNR (të ndodhura por të paraportuara). Nëse analiza nxjerr në pah mospërputhje të mëdha, Grupi kryen rregullime në metodologjinë e përdorur. Nëse identifikohet një mungesë ajo shënohet menjëherë në fitim ose humbje duke krijuar një provigjion për rrezikun e paskaduar nga humbjet që dalin nga testi i mjaftueshmërisë së rezervës.

g) Të ardhura nga investimet

Të ardhurat dhe shpenzimet nga interesat e investimeve njihen në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave në bazë të metodës së interesit efektiv. Norma e interesit efektiv është norma që skonton pagesat dhe arkëtimet e ardhshme monetare gjatë jetës së aktivit ose detyrimit financiar (ose kur është e përshtatshme një periudhë më e shkurtër) për t'i barazuar me vlerën kontabël të aktivit ose detyrimit financiar. Norma efektive e interesit vendoset në momentin fillestar të njohjes së aktivit, ose detyrimit financiar dhe nuk ndryshohet në periudhat e mëtejshme.

Llogaritja e normës së interesit efektiv përfshin të gjitha komisionet e paguara ose të marra, kostot e transaksionit, zbritjeve apo primeve të cilat janë pjesë integrale e normës efektive të interesit. Kostot e transaksionit janë kosto shtesë të lidhura në mënyrë direkte me blerjen, emetimin ose çregjistrimin e aktivit ose detyrimit financiar. Të ardhurat nga investimet të paraqitura në pasqyrën përmbledhëse të të ardhurave ose humbjes pasqyrojnë interesin e aktiveve financiare të investuara të Grupit.

h) Instrumentet financiare

(i) Njohja

Grupi fillimisht njeh kreditë dhe depozitat në datën kur lindin të drejtat dhe detyrimet përkatëse. Të gjitha detyrimet dhe aktivet e tjera financiare njihen në datën e transaksionit sipas së cilit Grupi bëhet palë e detyrimeve kontraktore të instrumentit.

(ii) Klasifikimi

Shiko politikat kontabël 3(g) dhe (h).

(iii) Çregjistrimi

Grupi çregjistron një aktiv financiar nëse I mbarojnë të drejtat kontraktuale mbi flukset e ardhshme të parasë, ose transferon të drejtat për të marrë flukset kontraktuale të parasë nga aktivet financiare në transaksione në të cilat i gjithë rreziku dhe përfitimet nga aktivet financiare është transferuar. Çdo interes nga aktivi financiar i transferuar që është krijuar ose mbajtur nga Grupi njihet si aktiv ose detyrim i veçantë. Grupi çregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shuhen, anulohen ose maturohen.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (vazhdim)

h) Instrumentet financiare (vazhdim)

(iv) Netimi

Aktivet dhe detyrimet financiare mund të netohen dhe tepricat neto të paraqiten në bilanc vetëm kur Grupi ka të drejta ligjore për të netuar shumat dhe ka qëllim të arkëtojë ose të mbylli aktivin apo detyrimin neto në të njëjtën kohë. Të ardhurat dhe shpenzimet paraqiten të netuara kur lejohet nga standardet e kontabilitetit, ose për fitime dhe humbje që lindin nga transaksione me natyrë të njëjtë si në aktivitetin tregtar të Grupit.

(v) Matja me kosto të amortizuar

Kostoja e amortizuar e një aktivi financiar është vlera me të cilën aktivi financiar ose detyrimi financiar është matur në njohjen fillestare, duke zbritur këstet e paguara, plus ose minus amortizimin kumulativ që rezulton nga përdorimi i metodës së interesit efektiv duke marrë parasysh diferencat midis vlerës së njohur në fillim dhe vlerës në maturim si dhe humbjet nga rënia në vlerë.

(vi) Matja me vlerë të drejtë

Përcaktimi i vlerës së drejtë të aktiveve dhe detyrimeve financiare është bazuar në çmimet e publikuara të tregut dhe treguesve të instrumenteve financiare në tregjet aktive. Për të gjitha instrumentet financiare të tjerë, vlera e drejtë është përcaktuar duke përdorur teknika vlerësimi. Teknikat e vlerësimit përfshijnë teknika të tilla si vlera reale neto, metoda e aktualizimit të flukseve, krahasimi me instrumente të tjerë të ngjashëm për të cilat çmimet përcaktohen në tregje aktive, si dhe modele të tjera vlerësimi.

(vii) Identifikimi dhe matja e rënies në vlerë

Në datën e përgatitjes së pasqyrave financiare Grupi vlerëson nëse ka të dhëna objektive për rënien në vlerë të aktiveve financiare. Aktivet financiare pësojnë rënie në vlerë kur të dhëna objektive tregon se një ngjarje me pasojë humbje ka ndodhur pas vlerësimit të mëparshëm të aktivit, si dhe kjo ngjarje ndikon në flukset e mjeteve monetare të vlerësueshme në mënyrë të besueshme. Grupi merr në konsideratë të dhënat për rënien në vlerë të aktiveve financiare individualisht dhe në grup. Të gjitha aktivet individualisht të rëndësishme vlerësohen për rënie në vlerë në mënyrë specifike dhe individuale. Të gjitha aktivet që nuk konsiderohen individualisht të rëndësishme grupohen dhe vlerësohen për çdo rënie ne vlerë që ka ndodhur po nuk është identifikuar ende. Të gjitha aktivet që nuk konsiderohen të jenë individualisht të rëndësishëm grupohen dhe vlerësohen duke grupuar aktivet financiare me karakteristika të njëjta risku (të mbajtura me kosto të amortizuar) për rënie në vlerë.

Si e dhënë objektive për rënie në vlerë të aktiveve në pasqyrat financiare mund të përmendet mosshlyerja në kohë apo shkelja e termave nga një debitor, ristrukturimi i një kredie/paradhënie të dhënë nga Grupi me terma të cilat në kushte të tjera nuk do të ishin konsideruar, tregues për falimentimin e mundshëm të një debitori ose të dhëna të tjera të observueshme lidhur me një grup aktivesh si ndryshimi në përkeqësim në statusin e arkëtueshmërisë së një debitori ose kreditori, apo kushte ekonomike që lidhen me përkeqësimin e grupit.

i) Mjete monetare dhe ekuivalentë me to

Mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përfshijnë balancat e gjendjes në arkë, mjetet monetare të depozituara në banka të nivelit të dytë dhe investime afatshkurtra me likuiditet të lartë dhe me maturitet deri në tre muaj ose më pak që nga momenti i blerjes, të cilat nuk mbartin risqe të larta për ndryshime në vlerë. Për qëllime të pasqyrës se konsoliduar të fluksit të parasë së Grupit, mjetet monetare dhe ekuivalentë me to përbëhen nga para në dorë dhe depozita afatshkurtra që janë, siç përkufizohet më lartë, neto nga çdo shumë e kufizuar e mjeteve monetare.

j) Depozitat me afat

Depozitat me afat paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar me shumën e principalit të tyre dhe klasifikohen ato depozita me maturitetit fillestar më të madh se tre muaj. Interesi llogaritet në bazë të metodës së interesit efektiv, dhe interesi i arkëtueshëm pasqyrohet në depozitat me afat me bankat.

k) Letrat me vlerë

Letrat me vlerë janë investime borxhi të cilat Grupi ka për qëllim dhe aftësi t'i mbajë deri në maturim dhe që janë klasifikuar si aktive të mbajtura deri në maturim. Investimet të cilat kanë pagesa fikse ose të përcaktuara dhe të cilat synohen të mbahen deri në maturim si rrjedhim maten me kosto të amortizuar, minus provigjionin për rënien në vlerë.

Kostoja e amortizimit llogaritet duke marrë në konsideratë ndonjë skontim ose prim në blerje. Primet dhe skontimet në investimet e projektuara si të mbajtura deri në maturim amortizohen sistematikisht gjatë maturitetit duke përdorur metodën e interesit efektiv dhe regjistrohen si të ardhura nga interesi.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (vazhdim)

l) Ndërtesa dhe pajisje

(i) Njohja dhe matja

Zërat e ndërtesës dhe pajisjeve (ose aktivet e qëndrueshme të trupëzuara) maten me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe humbjet nga zhvlerësimi. Kostot përfshijnë shpenzime të cilat lidhen direkt me koston e blerjes së aktiveve. Kostoja e aktiveve të ndërtuara vetë përfshin koston e materialeve dhe punën direkte, çdo kosto tjetër që lidhet me vënien e aktivit në punë, dhe kostot e rregullimit të vendit në të cilin ato do të vendosen. Blerja e programeve kompjuterike të cilat janë pjesë integrale e funksionimit të pajisjes kapitalizohet si pjesë e pajisjes. Kur pjesë të një zëri të ndërtesës ose pajisjeve kanë jetëgjatësi të ndryshme ato kontabilizohen si zëra të ndarë (përbërësit kryesor) të ndërtesës dhe pajisjeve.

(ii) Kostot e mëvonshme

Në vlerën e mbartur të një njësie të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara Grupi njeh kostot e zëvendësimit të një pjese të kësaj njësie kur ka ndodhur kjo kosto, në qoftë se është e mundur që përfitimet e ardhshme ekonomike të trupëzuara tek njësia t'i shkojnë Grupit dhe kostoja e njësisë të mund të matet me besueshmëri. Të gjitha kostot e tjera njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si një shpenzim në momentin që ndodh.

(iii) Amortizimi

Amortizimi njihet në fitim dhe humbje me metodën e vlerës së mbetur mbi jetëgjatësinë e llogaritur të aktiveve. Aktive me qira financiare amortizohen me vlerën më të vogël të afatit të qerasë financiare dhe jetës së përdorimit. Veprat e artit nuk amortizohen. Normat e vlerësuara të zhvlerësimit janë si më poshtë:

Ndërtesa (Kioska)	5%
Mobilje dhe pajisje zyrash	20%
Kompjutera	25%
Instalime dhe pajisje	20%
Mjete transporti	20%
Përmirësime në ambientet e marra me qira	Sipas termave të kontratës së qirasë

Aktivet mund të rivlerësohen duke iu referuar të dhënave të vëzhguara duke rregulluar shumën bruto kontabël të aktivit sipas vlerës së tregut ose me përcaktimin e vlerës së tregut të vlerës kontabël dhe rregullimin e vlerës kontabël bruto në mënyrë proporcionale, në mënyrë që rezultojnë që vlera kontabël të jetë e barabartë me vlerën e tregut. Përveç kësaj, amortizimi i akumuluar apo amortizimi është diferenca e shumave bruto me ato neto të aktivit. Gjatë periudhës aktuale nuk ka rivlerësime të kryera, kështu nuk ka ndikim në pasqyrat financiare të kompanisë.

m) Aktivet jo-materiale

Vlera kontabël e aktiveve jo-financiare të Shoqërisë shqyrtohet në çdo datë bilanci për të përcaktuar nëse ekziston ndonjë tregues për rënie në vlerë të aktivit. Në qoftë se ekziston ndonjë tregues i tillë, vlera kontabël zhvlerësohet. Një humbje nga rënia në vlerë njihet kurdoherë që vlera e mbartur e një aktivi ose njësia e tij e gjenerimit të parasë tejkalon shumën e tij të rikuperueshme.

Njësi gjeneruese parasë është njësia më e vogël e identifikueshme e grupimit të aktiveve që gjeneron flukse monetare të pavarura nga aktive dhe grupe të tjera. Humbja nga rënia në vlerë njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Vlera e rikuperueshme e një mjeti ose një njësie para-gjeneruese është vlera më e lartë midis vlerës së përdorimit dhe vlerës reale pasi janë zbritur kostot e shitjes. Në përafrimin e vlerës në përdorim, flukset e pritshme për t'u arkëtuar aktualizohen duke përdorur një normë të rregulluar për efektin e taksës që reflekton vlerësime të krahasueshme me tregun të vlerës në kohë të parasë si dhe risqeve që lidhen me aktivin.

Humbjet nga rënia në vlerë të njohura në periudhat e mëparshme vlerësohen në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse humbja është zvogëluar apo nuk ekziston më. Një humbje nga rënia në vlerë rimerret nëse ka pasur një ndryshim në vlerësimet e përdorura për të përcaktuar shumën e rikuperueshme. Humbja nga rënia në vlerë rimerret vetëm deri në atë masë sa vlera kontabël e aktivit e cila nuk tejkalon vlerën kontabël që do të përcaktohej duke i zbritur amortizimin, në qoftë se nuk do të kishte qenë humbje nga zhvlerësimi i njohur.

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (vazhdim)

n) Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit dhe të tjera llogari të arkëtueshme paraqiten fillimisht me vlerën e drejtë, dhe më vonë në koston e amortizuar minus humbjet nga provigjionet. Llogaritë e arkëtueshme të sigurimit vlerësohen për zhvlerësim në çdo datë raportimi.

o) Kapitali aksionar

Kapitali aksionar njihet në vlerë nominale.

p) Njohja e të ardhurave

Politikat kontabël për njohjen e të ardhurave nga kontratat e sigurimit janë paraqitur në notën 3.f.

q) Shpenzimet

*Shpenzimet p*ër *qiratë operative*

Pagesat për qiratë operative njihen në fitim ose humbje në bazë lineare mbi termat e pagesave të qerasë. Qiratë e marra njihen si pjesë integrale e totalit të shpenzimeve për qiratë.

r) Shpenzimet e marrjes në sigurim

Shpenzimet e marrjes në sigurim përcaktohen si kosto që rrjedhin nga blerja e kontratave të reja të sigurimit, duke përfshirë edhe kostot direkte, të tilla si komisionet e blerjes dhe kostot e krijimit të dokumentit të sigurimit dhe pjesën e shpenzimeve administrative që lidhen me procesin e propozimit dhe emetimit të policave. Shpenzimet e marrjes në sigurim njihen si shpenzime në momentin kur ndodhin.

s) Përfitimet e punonjësve

(i) Kontributet shoqërore të detyrueshme

Grupi paguan kontributet e detyrueshme për sigurimet shoqërore që i sigurojnë punonjësve përfitime pensioni kur këta të fundit dalin në pension. Autoritetet respektive të sigurimeve shoqërore të çdo juridiksioni legal kanë përgjegjësinë të sigurojnë kufirin e minimumit legal të pagesës për pension nën skemën e planit të pensionit me kontribute të përcaktuara. Kontributet e Grupit për planin e përfitimit të pensionit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në momentin që ato ndodhin.

(ii) Leja vjetore e paguar

Grupi njeh si detyrim shumën e pa skontuar të kostove të parashikuara në lidhje me lejen vjetore që pritet të paguhet në shkëmbim të shërbimeve të punonjësve për periudhën e përfunduar.

t) Qiratë

Shoqëria mëmë ka miratuar prononcimet e reja të kontabilitetit të cilat janë bërë efektive këtë vit, si më poshtë: SNRF 16 'Qiratë' SNRF 16 'Qiratë' zëvendëson SNK 17 ' Qiratë ' së bashku me tre interpretime (KIRFN 4 'Përcaktimi nëse një Marrëveshje përmban një Qira ', SIC 15' Qiraja Operative 'dhe SIC 27' Vlerësimi i thelbit të Transaksioneve që përfshijnë Formën Ligjore të Qiradhënies '). Miratimi i këtij Standardi të ri ka bërë që Grupi të njohë një aktiv të së drejtës së përdorimit dhe detyrimin e qirasë në lidhje me të gjitha qiradhëniet e mëparshme, përveç atyre të identifikuara si me vlerë të ulët ose që kanë një afat të mbetur qiraje më pak se 12 muaj nga data e aplikimit fillestar. Standardi i ri është aplikuar duke përdorur qasjen e modifikuar retrospektive. Sipas kësaj qasjeje, Grupi ka matur detyrimin e qirasë në vlerën aktuale të pagesave të mbetura të qirasë, duke zbritur e duke përdorur normat në sektorin e qiradhënies për aktive të ngjashme dhe e drejta për të përdorur aktivin është njohur në një shumë të barabartë me detyrimin e qirasë, të rregulluar nga shuma e çdo pagese të parapaguar ose të llogaritur të qirasë në lidhje me atë qira të njohur në pasqyrën e pozicionit financiar menjëherë përpara datës së aplikimit fillestar. Periudhat e mëparshme nuk janë riparaqitur. Për kontratat e vendosura në datën e aplikimit fillestar, Grupi ka zgjedhur të zbatojë përkufizimin e qirasë nga SNK 17 dhe KIRFN 4 dhe nuk ka zbatuar SNRF 16 për aplikimet që më parë nuk ishin identifikuar si qira sipas SNK 17 dhe KIRFN 4.

Grupi ka zgjedhur të mos përfshijë kostot fillestare direkte në matjen e aktivit të së drejtës së përdorimit për qiratë operative në ekzistencë në datën e aplikimit fillestar të SNRF 16, e cila është 1 janar 2019.

Në vend që të kryejë një rishikim të zhvlerësimit në aktivet e së drejtës së përdorimit në datën e aplikimit fillestar, Grupi është mbështetur në vlerësimin e saj historik nëse qiratë kanë qenë menjëherë të mëdha përpara datës së aplikimit fillestar të SNRF 16. Në tranzicion, për qiradhëniet e llogaritura më parë si qira operative me një afat të

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (vazhdim)

t) Qiratë (vazhdim)

mbetur qiraje më pak se 12 muaj Grupi ka aplikuar përjashtime opsionale për të mos njohur aktivet të së drejtës së përdorimit, por për të llogaritur shpenzimet e qirasë në bazë të drejtpërdrejtë gjatë afatit të mbetur të qirasë. Për ato qira të klasifikuara më parë si qira financiare, aktivi i së drejtës së përdorimit dhe detyrimi i qirasë maten në datën e aplikimit fillestar në të njëjtat shuma si në SNK 17 menjëherë para datës së aplikimit fillestar. Në kalimin në SNRF 16, norma mesatare e ponderuar e huamarrjes në rritje e aplikuar për detyrimet e qirasë të njohura sipas SNRF 16 ishte 6 % p.a.

Kalimi në standardin e ri

Grupi filloi të zbatojë SNRF 16 më 1 janar 2019, duke përdorur një qasje të retrospektive të modifikuar. Prandaj, efekti kumulativ i adoptimit të SNRF 16 do të njihet si një rregullim i shumave të çeljes

Grupi planifikon të zbatojë lehtësi praktike për të trashëguar ndryshimin për përcaktimin e qirasë. Pra, do të aplikojë SNRF 16 për të gjitha kontratat e lidhura para 1 janar 2019 dhe të identifikuara si qira në përputhje me SNK 17 dhe IFRIC 4

Më poshtë paraqitet një rakordim i balancave hapëse për detyrimet e qirasë me 1 janar 2019 bazuar në detyrimet e qirasë operative më 31 dhjetor 2018.

Angazhimet totale të qirasë operative të paraqitura më 31 dhjetor 2018	**81,292,870**
Përjashtimet nga njohja:	
Qiratë e aktiveve me vlerë të ulët	-
Qiratë me afat të mbetur të qirasë më pak se 12 muaj	-
Detyrimet e qirasë operative para zbritjes	**81,292,870**
Zbritur duke përdorur shkallën rritëse te huamarrjes	(17,777,926)
Detyrimet totale të qirasë të njohura sipas SNRF 16 më 1 Janar 2019	**63,514,944**

Aktivet e lidhura me të drejtën e përdorimit për qiratë e aktiveve u njohën me efekt te akumuluar sipas metodës retrospektive të modifikuar. Aktivet e tjera të së drejtës së përdorimit u matën në shumën e barabartë me detyrimin e qirasë, rregulluar nga shuma e çdo pagese të parapaguar ose qirasë të akorduar në lidhje me atë qira të njohura në bilanc, më 31 dhjetor 2018.

Aktivet e njohura të së drejtës së përdorimit kanë të bëjnë me llojet e mëposhtme të pasurive:

	Nr. i aktiveve	**Koha e mbetur në vite**	**31 dhjetor 2019**	**1 janar 2019**
Ndërtesat	12	1-10 vjet	76,220,816	63,514,944
Totali	**12**	**1-10 vjet**	**76,220,816**	**63,514,944**

u) Tatimi

Tatimi mbi fitimin apo humbja për vitin përfshin tatimin aktual dhe atë të shtyrë. Tatimi mbi fitimin njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve me përjashtim të pjesës që lidhet me zëra të njohur në mënyrë direkte në kapital ose në pasqyrën e të ardhurave përmbledhëse.

Tatimi aktual është tatimi i pritshëm i pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke përdorur normat e tatimit në datën e raportimit. Tatimi mbi fitimin llogaritet duke axhustuar fitimin kontabël përpara tatimit për disa zëra të të ardhurave dhe shpenzimeve siç kërkohet nga Ligji Shqiptar.

Tatimi i shtyrë njihet për sa i përket diferencave të përkohshme ndërmjet vlerës kontabël të aktiveve dhe detyrimeve për qëllim raportimi financiar dhe vlerave të përdoruar për qëllim tatimor. Tatimi i shtyrë matet me normat e

3. POLITIKA KONTABËL TË RËNDËSISHME (vazhdim)

tatimit që pritet të aplikohen ndaj diferencave të përkohshme kur ato kthehen mbrapsht, bazuar në ligjet që janë në fuqi ose në fuqi në mënyrë të konsiderueshme në datën e raportimit.

Një aktiv tatimor i shtyrë njihet për aq sa është e mundur që fitimi i tatueshëm i ardhshëm do të jetë i disponueshëm kundrejt të cilit të mund të përdoret. Tatimi i shtyrë rishikohet çdo datë raportimi dhe zvogëlohet deri në masën sa nuk ka më mundësi që përfitimi nga tatimi mund të realizohet.

Shoqëria ka rezultuar me fitim kontabël dhe fiskal për vitin e mbyllur dhe 31 dhjetor 2019, ndërsa për vitin e mbyllur me 31 dhjetor 2018 shoqëria ka rezultuar me fitim kontabël por duke qenë se në vitet 2016-2017 ka rezultuar me humbje e cila në vlerë ishte më e madhe se fitimi i vitit, nuk ka llogaritur tatim mbi fitimin. Gjithashtu Shoqëria në vitin 2019 ka njohur tatim të shtyrë në këto pasqyra financiare të veçanta.

v) Standarde dhe Interpretime në fuqi në periudhën raportuese

a. Standardet e reja dhe interpretimet të cilat nuk janë adoptuar akoma

Në datën e autorizimit të këtyre pasqyrave financiare, disa Standarde të reja, por ende jo efektive, Standarde dhe Ndryshime në Standardet ekzistuese, dhe Interpretime janë botuar nga BSNK. Standardet dhe ndryshimet që nuk janë akoma efektive dhe nuk janë miratuar në fillim nga Grupi përfshijnë:

- Ndryshimet në SNRF 9 “Tiparet e Parapagimit me Kompensim Negativ” (në fuqi më 1 janar 2019).
- Ndryshimet në SNK 28 “Interesat Afatgjatë në Shoqëritë dhe Sipërmarrjet e Përbashkëta” (e detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2019).
- SNRF 17 “Kontratat e Sigurimeve” (që zbatohen në mënyrë të detyrueshme për periudhat që fillojnë më ose pas 1 janarit 2021).
- Përkufizimi i një biznesi (Ndryshimet në SNRF 3)
- Përkufizimi i materialit (Ndryshimet në SNK 1 dhe SNK 8)
- Kuadri Konceptual për Raportimin Financiar

Këto ndryshime nuk pritet të kenë një ndikim të rëndësishëm në pasqyrat financiare në periudhën e aplikimit fillestar dhe për këtë arsye shënimet shpjeguese nuk janë përgatitur.

Asnjë nga këto Standarde ose ndryshime në Standardet ekzistuese nuk janë miratuar më pare nga Grupi. Drejtimi parashikon që të gjitha prononcimet përkatëse do të miratohen për periudhën e parë që fillon në ose pas datës efektive të publikimit. Standardet, ndryshimet dhe interpretimet e reja që nuk janë miratuar në vitin aktual nuk janë paraqitur pasi ato nuk pritet të kenë një ndikim material në pasqyrat financiare të Shoqërisë.

4. MENAXHIMI I RREZIQEVE TË SIGURIMIT DHE FINANCIAR

a) Objektivat e menaxhimit të rreziqeve dhe politikat për të ulur rrezikun e sigurimit

Rreziku nga kontratat e sigurimit është mundësia që ngjarja e siguruar ndodh dhe pasiguria për shumën e dëmit. Për vetë natyrën e kontratave të sigurimit, ky rrezik është i rastësishëm dhe i paparashikueshëm. Grupi e pranon rrezikun nga sigurimi nëpërmjet kontratave të sigurimit dhe disa kontratave të investimeve ku ajo supozon rrezikun e humbjes nga personat ose organizatat që janë të lidhura direkt me humbjen. Grupi është i ekspozuar ndaj pasigurisë së kohës, frekuencës dhe ashpërsisë së dëmeve nën këto kontrata. Risigurimi blihet nga Grupi për të ulur rrezikun potencial nga humbjet si pasojë e ngjarjeve të mëdha individuale ose katastrofa dhe gjithashtu për të pasur akses nga specialistë të rreziqeve dhe asistencë në menaxhimin e kapitalit. Policat e risigurimit nënshkruhen me risigurues të aprovuar në bazë proporcionale ose në bazë të marrëveshjeve për humbjen.

Kapitali rregullator menaxhohet (por jo vetëm) duke iu referuar rrezikut të sigurimit ndaj të cilit Grupi është i ekspozuar. Për një portofol të kontratave të sigurimit ku teoria e probabilitetit është aplikuar për vendosjen e çmimit dhe provigjionimin, rreziku kryesor që Grupi ka nga kontratat e saj të sigurimit është se dëmet aktuale dhe pagesat e përfituesit janë më të mëdha se vlera e mbartur e detyrimeve të sigurimit. Kjo mund të lindë sepse frekuenca ose ashpërsia e dëmit dhe përfitimit janë më të mëdha se çfarë është vlerësuar. Ngjarjet e sigurimit janë të rastësishme

4. MENAXHIMI I RREZIQEVE TË SIGURIMIT DHE FINANCIAR (vazhdim)

a) Objektivat e menaxhimit të rreziqeve dhe politikat për të ulur rrezikun e sigurimit (vazhdim)

dhe numri aktual i dëmeve dhe përfitimeve mund të ndryshojë nga viti në vit nga niveli i caktuar nga teknikat statistikore.

Eksperienca tregon se sa më i madh të jetë portofoli i kontratave të njëjta të sigurimit aq më e vogël do të jetë varianca relative e rezultateve. Gjithashtu, një portofol i diversifikuar më shumë ka më pak mundësi që të ndikohet nga ndryshimet në portofol.

b) Strategjia e marrjes në sigurim

Grupi ka zhvilluar strategjinë e saj të marrjes në sigurim duke diversifikuar llojin e rreziqeve të cilat ajo pranon dhe brenda secilës kategori të arrijë një popullatë rreziku relativisht të madhe për të ulur ndryshueshmërinë e rezultateve të pritshme.

c) Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit

Termat dhe kushtet e kontratave të sigurimit të cilat kanë një efekt material mbi vlerën, kohën dhe pasigurinë e flukseve të ardhshme të parasë janë paraqitur më poshtë.

Natyra e rrezikut të mbuluar

Përgjithësisht, të gjitha produktet e Grupit mbulojnë rrezikun e vdekshmërisë të tilla si paaftësitë e përkohshme ose të përhershme, mbulimin e shpenzimeve mjekësore, shpenzimet spitalore dhe të riaftësimit. Produktet e tjera nga Jeta e Debitorit dhe Jetës me Kursim kanë karakteristika të njëjta të produkteve me afat të shkurtër dhe janë të rinovueshme çdo vit me opsionin për të ndryshuar primin nga Grupi.

Policat e jetës me kursim përmbajnë elemente kursimi dhe rreziku. Përfitimi në rast vdekje është i barabartë me pjesën e rezervës për kursimin dhe shumën e siguruar e cila është nga 5,000 Euro deri në 10,000 Euro. Përfitimi në rast maturimi është i barabartë me pjesën e rezervës për kursimin. Primi është i ndarë në dy pjesë, pjesa e rrezikut e vendosur në fillim të kontratës dhe pjesa e kursimit. Policat e sigurimit për shëndetin dhe të tjera kategori paraqesin polica me afat pa elemente kursimi dhe vlerë të kthyeshme. Përfitimi nga policat e sigurimit të shëndetit paguhet në rast vdekje të të siguruarit ose paaftësie të përkohshme ose të përhershme brenda një periudhe specifike.

d) Risigurimi dhe përqendrimi i rrezikut

Risigurimi përdoret për të menaxhuar rrezikun e sigurimit. Megjithatë kjo nuk e heq përgjegjësinë e Grupit si siguruesi kryesor. Nëse risiguruesi nuk paguan një dëm për arsye të ndryshme, Grupi është i detyruar që të paguajë policëmbajtësin për detyrimin. Grupi ka ceduar rrezikun e sigurimit për të limituar ekspozimin ndaj humbjeve dhe për të minimizuar efektin e humbjeve nga sigurimi i jetës për kreditë nëpërmjet marrëveshjeve risiguruese. Tabela e mëposhtme paraqet përfitimet e agreguara të fundvitit për kontratat e sigurimit të jetës së kredimarrësve sipas moshës për 31 dhjetorin 2019 dhe 2018. Analiza e ekspozimit kontraktual konsiderohet si treguesi më i mirë për përqendrimin e rrezikut të sigurimit.

Mosha për sigurimin e jetës së kredimarrësve	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	në LEK	**në %**	**në LEK**	**në %**
Deri në 29	1,623,401,706	10%	2,030,299,992	13%
30 – 39	5,827,218,120	37%	5,404,471,862	34%
40 – 49	5,305,715,462	33%	4,858,512,360	31%
50 – 59	2,866,929,819	18%	3,179,963,227	20%
Mbi 60	299,633,832	2%	228,768,376	1%
Totali	**15,922,898,938**	**100%**	**15,702,015,817**	**100%**

4. MENAXHIMI I RREZIQEVE TË SIGURIMIT DHE FINANCIAR (vazhdim)

e) Ekspozimi që lidhet me ngjarjet katastrofike

Grupi merr në konsideratë se gjatë aktivitetit të tij të sigurimit ai nuk ka akumuluar ekspozim që lidhet me ngjarjet katastrofike.

f) Menaxhimi i rrezikut financiar

Transaksionet me instrumentet financiare kërkojnë nga Grupi që të llogarisë rrezikun financiar. Këto përfshijnë rrezikun e tregut, rrezikun e kredisë (duke përfshirë rrezikun e kredisë nga risiguruesi) dhe rrezikun e likuiditetit. Secili nga këto rreziqe është i përshkruar më poshtë së bashku me një përmbledhje të mënyrave se si Grupi i menaxhon këto rreziqe.

g) Rreziku i tregut

Rreziku i tregut përfshin tre lloje rreziqesh:

- *Rreziku valutor* – rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të variojë si pasojë e ndryshimeve në kurset e këmbimit.
- *Rreziku i normës së interesit* – rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të variojë si pasojë e ndryshimeve në treg të normës së interesit.
- *Rreziku i çmimit* – rreziku që vlera e instrumenteve financiare do të variojë si rezultat i ndryshimeve të çmimeve të tregut, qofshin këto ndryshime si rezultat i faktorëve specifik të instrumentit financiar ose faktorë që ndikojnë të gjithë instrumentet financiarë që janë në treg.

Rreziku i tregut nuk përfshin vetëm mundësinë për të humbur, por edhe mundësinë për të fituar.

Kurset e këmbimit të përdorura më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë kurset zyrtare të Bankës së Shqipërisë (Lek ndaj monedhave të huaja) të paraqitura si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Dollari Amerikan (USD)	108.64	107.82
Monedha e Përbashkët Europiane (EURO)	121.77	123.42

Përputhja aktive/detyrim

Grupi i menaxhon aktivet duke përdorur një mënyrë që balancon cilësinë, diversifikimin, përputhjen aktive-detyrime, likuiditetin dhe të ardhurat nga investimet. Qëllimi i procesit të investimit është që të optimizojë të ardhurat pas taksave nga investimi ndërkohë që siguron që aktivet dhe detyrimet janë menaxhuar në bazë të fluksit të parave dhe zgjatjes së tyre.

Natyra e rrezikut të sigurimit, maturimi i tyre dhe struktura e monedhës së vendosur për të shprehur detyrimin kanë një ndikim tek strategjia e investimit të Grupit. Gjithashtu Grupi duhet të plotësojë limitet e vendosura nga rregulluesit e sigurimeve të cilët kërkojnë që aktivet financiare të investuara në institucionet jo-financiare nuk duhet të kalojnë limitin prej 10% të kapitalit aksionar.

Grupi vendos objektiva për portofol asetesh për çdo produkt sigurimi, që përfaqëson strategjinë e investimit të përdorur për të financuar detyrimet brënda niveleve të pranueshme të rrezikut. Këto strategji përfshijnë objektiva për kohëzgjatjen, ndjeshmërinë, likuiditetin, përqendrimin e sektorit të aktiveve dhe cilësinë e kreditit. Llogaritjet e përdorura për të përcaktuar sasitë e përafërta dhe kohën e pagesave të detyrimeve ndaj të siguruarve vlerësohen rregullisht.

Shumica e këtyre llogaritjeve janë subjektive dhe mund të ndikojnë në aftësinë e Grupit për të arritur objektivat e menaxhimit të aseteve/detyrimeve. Grupi ka ndërmarrë disa transaksione në monedhë të huaj. Kështu që, ekspozimi ndaj lëvizjeve në kursin e këmbimit rritet.

Grupi ka ekspozim minimal ndaj rrezikut valutor sepse aktivet financiare të Grupit përputhen kryesisht me të njëjtat monedha me detyrimet e sigurimit dhe kontratat e investimeve. Si rezultat, rreziku nga këmbimet valutore lind nga aktive dhe detyrime të tjera në monedha të tjera.

4. MENAXHIMI I RREZIQEVE TË SIGURIMIT DHE FINANCIAR (vazhdim)

g) Rreziku i tregut (vazhdim)

1- Menaxhimi i rrezikut të këmbimeve valutore

Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2019 janë si më poshtë (shumat të përkthyera në Lek):

31 dhjetor 2019	në LEK	në EURO	në USD	Totali
Aktivet				
Mjete monetare ne arke dhe ne banke	9,781,833	19,229,385	34,798	**29,046,016**
Depozitat me afat dhe te ardhurat nga interesi	268,999,397	112,562,209	22,794,384	**404,355,990**
Letra me vlere te qeverise	148,846,354	-	-	**148,846,354**
Fonde investimi	15,141,330	-	-	**15,141,330**
Te arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi	23,085,018	12,498,053	9,300	**35,592,371**
Parapagime te tatim fitimit	114,001			**114,001**
Aktive te tjera	5,732,180	2,704,065	1,628	**8,437,873**
Totali i Aktiveve	**471,700,113**	**146,993,712**	**22,840,110**	**641,533,935**
Detyrimet dhe kapitali aksionar				
Detyrimet për humbjet dhe rregullimet për humbjet	23,619,030	6,759,525	51,948	**30,430,503**
Rezerva te tjera	-	35,348,623	-	**35,348,623**
Llogari të pagueshme sigurimi dhe risigurimi	7,599,350	4,253,820	-	**11,853,170**
Detyrime ndaj institucioneve te kreditit	-	3,198,735	-	**3,198,735**
Detyrime te tjera	9,669,310	5,077,626	(891)	**14,746,045**
Totali i detyrimeve	**40,887,690**	**54,638,329**	**51,057**	**95,577,076**
Pozicioni neto	**443,319,776**	**79,857,330**	**22,779,753**	**545,956,859**

Aktivet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2018 janë si më poshtë (shumat të përkthyera në Lek):

31 dhjetor 2018	në LEK	në EURO	në USD	Totali
Aktivet				
Mjete monetare në arke dhe në bankë	18,985,175	19,170,439	37,779	**38,193,393**
Depozitat me afat	267,488,339	91,968,949	22,281,529	**381,738,817**
Letra me vlere të qeverisë	139,193,922	-	-	**139,193,922**
Të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi	43,030,129	-	-	**43,030,129**
Parapagime të tatim fitimit	1,020,748	-	-	**1,020,748**
Aktive të tjera	9,271,428	5,107,259	1,616	**14,380,303**
Totali i Aktiveve	**478,989,741**	**116,246,647**	**22,320,924**	**617,557,312**
Detyrimet dhe kapitali aksionar				
Detyrimet për humbjet dhe rregullimet për humbjet	10,575,387	5,029,383	16,739	**15,621,509**
Rezerva të tjera	-	37,267,672	-	**37,267,672**
Llogari të pagueshme sigurimi dhe risigurimi	7,118,546	2,198,972	-	**9,317,518**
Detyrime ndaj institucioneve të kreditit	-	359,531	-	**359,531**
Detyrime të tjera	9,501,161	9,993,835	(1,070)	**19,493,926**
Totali i detyrimeve	**27,195,094**	**54,849,393**	**15,669**	**82,060,156**
Pozicioni neto	**451,794,647**	**61,397,254**	**22,305,255**	**535,497,156**

4. MENAXHIMI I RREZIQEVE TË SIGURIMIT DHE FINANCIAR (vazhdim)

g) Rreziku i tregut (vazhdim)

2- Analiza e riçmimit të normës së interesit

Tabelat e mëposhtme paraqesin aktivet dhe detyrimet financiare interes-mbartëse të Grupit të analizuara në bazë të periudhave të riçmimit e përcaktuar si periudha më e hershme midis periudhës së mbetur deri në maturim sipas kontratës dhe periudhës së riçmimit sipas kontratës. Tabelat janë një llogaritje e rrezikut të normës së interesit për Grupin më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 dhe nuk janë tregues për periudha të tjera gjatë vitit por japin një të dhënë për ndjeshmërinë e të ardhurave të Grupit ndaj lëvizjeve në normat e interesit. Të ardhurat ndikohen gjithashtu nga monedha e aktiveve, detyrimeve dhe kapitalit. Grupi ka një pjesë të rëndësishme të aktiveve që mbartin interesa të shprehura në monedhë të huaj.

31 dhjetor 2019	Norma efektive e interesit	Deri në 6 muaj	6-12 muaj	1-5 vite	Shuma me norma fikse	Që nuk mbartin interes	Totali
Aktive Financiare							
Mjete monetare në arkë dhe në bankë						29,046,016	**29,046,016**
Depozita me afat	1.34%	241,524,500	110,407,535	49,115,279	-	-	**401,047,314**
Investime në letra me vlerë	4.77%	30,000,000	13,820,000	103,200,000	-	-	**147,020,000**
Totali i aktiveve financiare		**271,524,500**	**124,227,535**	**152,315,279**	**-**	**29,046,016**	**577,113,330**
Detyrimet financiare							
Detyrime ndaj institucioneve financiare	5.90%	(3,198,735)	-	-	-	-	(3,198,735)
Total i detyrimeve financiare		**(3,198,735)**	**-**	**-**	**-**	**-**	**(3,198,735)**
31 dhjetor 2018							
Aktive Financiare							
Mjete monetare në arkë dhe në bankë		-	-	-	-	38,193,393	**38,193,393**
Depozita me afat	1.83%	232,255,650	110,182,167	39,301,000	-	-	**381,738,817**
Investime në letra me vlerë	4.76%	29,946,123	29,623,261	79,624,537	-	-	**139,193,921**
Totali i aktiveve financiare		**262,201,773**	**139,805,428**	**118,925,537**	**-**	**38,193,393**	**559,126,131**
Detyrimet financiare							
Detyrime ndaj institucioneve financiare	4.87%	(359,531)	-	-	-	-	(359,531)
Totali i detyrimeve financiare		**(359,531)**	**-**	**-**	**-**	**-**	**(359,531)**

h) Rreziku i kredisë

Rreziku i kredisë i referohet rrezikut që pala tjetër do të dështojë në përmbushjen e detyrimeve kontraktuale duke sjellë humbje financiare për Grupin. Grupi është i ekspozuar ndaj rrezikut të kredisë në depozitat me afat dhe të arkëtueshmet nga sigurimi dhe risigurimi i palës tjetër. Menaxhimi beson se rreziku i kredisë i lidhur me depozitat me afat nuk është i rëndësishëm.

Grupi e menaxhon ekspozimin ndaj rrezikut të kredisë në baza të vazhdueshme duke monitoruar vazhdimisht të arkëtueshmet nga sigurimi dhe risigurimi.

Të arkëtueshmet nga sigurimi dhe risigurimi më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 sipas vjetërsisë së tyre janë si më poshtë:

4. MENAXHIMI I RREZIQEVE TË SIGURIMIT DHE FINANCIAR (vazhdim)

h) Rreziku i kredisë (vazhdim)

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
	në LEK	**në %**	**në LEK**	**në %**
1 – 90 ditë	28,847,183	81%	35,765,821	83%
91-365 ditë	5,939,906	17%	6,209,047	14%
Më shumë se një 365 ditë	805,283	2%	1,055,261	2%
Totali	**35,592,372**	**100%**	**43,030,129**	**100%**

i) Rreziku i likuiditetit

Rreziku i likuiditetit është rreziku që Grupi nuk do të mund të përballojë detyrimet që lidhen me detyrimet financiare kur ato lindin.

Grupi ka adoptuar një strukturë të përshtatshme për menaxhimin e rrezikut të likuiditetit për menaxhimin e kërkesave të likuiditetit të Grupit. Grupi e menaxhon rrezikun e likuiditetit duke mbajtur mjete monetare bankare dhe rezerva për huatë duke monitoruar vazhdimisht flukset monetare të parashikuara dhe aktuale dhe duke përputhur maturitetin e aktiveve dhe detyrimeve. Grupi është i ekspozuar ndaj rrezikut të likuiditetit që lind nga klientët si pasojë e kontratave të sigurimit.

Menaxhimi i likuiditetit siguron që Grupi ka fonde të mjaftueshme për të mbuluar dëmet nga sigurimi dhe detyrimet e maturuara.

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2019 është si më poshtë:

31 dhjetor 2019	Më pak se 1 muaj	1 – 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 - 5 vite	Më shumë se 5 vite	Totali
Aktive monetare						
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	29,046,016	-	-	-	-	**29,046,016**
Depozitat me afat dhe të ardhurat nga interesi	119,014,849	22,359,962	213,460,695	24,888,463	24,632,021	**404,355,990**
Investime në letra me vlerë	30,372,674	-	13,991,679	58,922,989	45,559,012	**148,846,354**
Fonde investimi	15,141,330	-	-	-	-	**15,141,330**
Të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi	16,833,755	215,108	18,543,508	-	-	**35,592,371**
Parapagime te tatim fitimit	114,001	-	-	-	-	**114,001**
Aktive të tjera	6,525,397	860,109	1,052,367	-	-	**8,437,873**
Totali i Aktiveve	**217,048,022**	**23,435,179**	**247,048,249**	**83,811,452**	**70,191,033**	**641,533,935**
Detyrimet dhe kapitali aksionar						
Detyrimet për humbjet dhe rregullimet për humbjet	980,171	302,947	18,283,783	7,806,350	3,057,252	**30,430,503**
Rezerva të tjera	-	8,182,944	3,167,359	20,497,957	3,500,363	**35,348,623**
Llogari të pagueshme sigurimi dhe risigurimi	11,337,437	470,033	45,700	-	-	**11,853,170**
Detyrime ndaj institucioneve të kreditit	487,911	178,416	825,271	1,707,137	-	**3,198,735**
Detyrime të tjera	11,929,418	1,173,445	1,643,182	-	-	**14,746,045**
Totali i detyrimeve	**24,734,937**	**10,307,785**	**23,965,295**	**30,011,444**	**6,557,615**	**95,577,076**
Hendeku i maturitetit	**192,313,085**	**13,127,394**	**223,082,954**	**53,800,008**	**63,633,418**	**545,956,859**
Efekti i akumuluar	**192,313,085**	**205,440,479**	**428,523,433**	**482,323,441**	**545,956,859**	**-**

4. MENAXHIMI I RREZIQEVE TË SIGURIMIT DHE FINANCIAR (vazhdim)

i) Rreziku i likuiditetit (vazhdim)

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2018 është si më poshtë:

31 dhjetor 2018	Më pak se 1 muaj	1 – 3 muaj	3 muaj deri në 1 vit	1 - 5 vite	Më shumë se 5 vite	Totali
Aktive monetare						
Aktive monetare	38,193,393					**38,193,393**
Mjete monetare në arkë dhe në bankë	119,268,685	41,250,907	183,101,432	25,501,082	12,616,711	**381,738,817**
Depozitat me afat	30,215,757	-	30,215,757	58,618,569	20,143,839	**139,193,922**
Investime në letra me vlerë	24,209,608	754,600	18,065,921	-	-	**43,030,129**
Të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi	-	-	808,748	212,000	-	**1,020,748**
Parapagim i tatim fitimit	11,659,088	574,950	1,507,351	18,300	620,614	**14,380,303**
Totali i aktiveve	**223,546,531**	**42,580,457**	**233,699,209**	**84,349,951**	**33,381,164**	**617,557,312**
Detyrime monetare						
Detyrimet për humbjet dhe rregullimet për humbjet	646,089	421,109	9,517,454	4,663,881	372,976	**15,621,509**
Rezerva të tjera	-	-	9,960,112	21,472,263	5,835,297	**37,267,672**
Llogari të pagueshme sigurimi dhe risigurimi	8,671,574	645,944	-	-	-	**9,317,518**
Detyrime ndaj institucioneve të kreditit	359,531	-	-	-	-	**359,531**
Detyrime të tjera	18,944,475	200,873	348,578	-	-	**19,493,926**
Totali i detyrimeve	**28,621,669**	**1,267,926**	**19,826,144**	**26,136,144**	**6,208,273**	**82,060,156**
Hendeku i maturitetit (neto)	**194,924,862**	**41,312,531**	**213,873,065**	**58,213,807**	**27,172,891**	**535,497,156**
Efekti i akumuluar	**194,924,862**	**236,237,393**	**450,110,458**	**508,324,265**	**535,497,156**	**-**

j) Interesi teknik

Norma e interesit teknik për vitin 2019 është llogaritur për secilën nga monedhat: ALL 2.88%, EUR 1.68%, dhe USD 1.72 % (2018: ALL 2.88 %, EURO 0.2%, dhe USD 1.15 %), në varësi të normat mesatare të depozitave. Norma e interesit teknik është minimumi i kthimit të garantuar për çdo kontratë sigurimi për jetën. Ekziston rreziku që të ardhurat nga investimet nuk do të mbulojnë minimumin e kthimeve të garantuara. Në 2018-ën të ardhurat neto të gjeneruara nga investimet (duke përfshirë edhe rezervën matematikore) mbulojnë minimumin e të ardhurave të garantuara, duke siguruar fitime shtesë mbi interesin teknik.

Analiza e parametrave aktuariale të përdorura në llogaritjen e tarifave dhe rezervave të sigurimit të jetës tregon se supozimet e bëra janë të përshtatshme. Zhvillimi i favorshëm i rreziqeve në krahasim me vlerat e pritura, garanton se rezervat janë të ngarkuar në mënyrë adekuate.

k) Rezervat dhe testi i mjaftueshmërisë për supozimet aktuariale

Grupi llogarit dhe ngarkon rezervat e sigurimit për jetën (rezervat matematikore) për të paraqitur pagesat e ardhshme nën policat e sigurimit me afat të gjatë. Shumë faktorë ndikojnë llogaritjen e këtyre rezervave duke përfshirë vdekshmërinë, anulimet dhe interesin teknik. Rezerva për sigurimin e jetës është llogaritur në bazë të supozimeve aktuale për parametrat bazë.

Testi i mjaftueshmërisë së detyrimeve është i limituar në analizën e parametrave kryesorë të cilat kanë ndikimin më të madh në llogaritjen e rezervës.

4. MENAXHIMI I RREZIQEVE TË SIGURIMIT DHE FINANCIAR (vazhdim)

k) Rezervat dhe testi i mjaftueshmërisë për supozimet aktuariale (vazhdim)

"Vdekshmëria" është rreziku që mbulohet nga të gjithë produktet e sigurimit që Grupi ka. Të dhënat për rrezikun e "vdekshmërisë" për vitin 2019 dhe për vitin 2018 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Numri i personave të dyshuar për rrezikun e vdekjes	22,381	53,688
Mosha e personave të dyshuar për rrezikun e vdekjes	18-70	18-70
Numri i pagesave për të siguruarit që kanë vdekur gjatë vitit	34	27
Numri i vdekshmërisë i llogaritur në 1000 njerëz	0.33-42.3	0.33-24.42
Numri i vdekshmërisë në 1000 njerëz	1.50	0.50

Kështu që, rreziku i "vdekshmërisë" i paraqitur në këtë tabelë është brenda pritshmërisë.

l) Rreziku i risigurimit

Grupi cedon rrezikun e sigurimit që të kufizojë ekspozimin e humbjeve nën marrëveshje të ndara për çdo lloj sigurimi. Këto marrëveshje risigurimi e shpërndajnë rrezikun dhe minimizojnë efektin e humbjes. Shuma e secilit rrezik të mbetur varet nga vlerësimi që Grupi i bën rreziqeve specifike, subjekt i disa rrethanave për limitet maksimale të bazuara në karakteristikat e mbulimit. Nën termat e marrëveshjes së risigurimit, risiguruesi bie dakord që të rimbursojë shumën e ceduar në rastin e dëmeve të paguara. Megjithatë, Grupi mbetet i detyruar ndaj police-mbajtësve të saj në lidhje me sigurimin e ceduar nëse risiguruesi nuk përmbush detyrimet e tij.

Kur zgjedh risiguruesin Grupi merr në konsideratë sigurinë e tij relative. Siguria e risiguruesit vlerësohet nga informacionet publike të kategorizimeve dhe nga investigime të brendshme. Risiguruesi aktual ka një vlerësim A+/ Pozitiv nga "Standard and Poor's". Gjatë vitit 2019 Grupi ka lidhur kontrata risigurimi për kontrata të veçanta sigurimi me Risiguruesin QBE Re (Europë) Ltd e cila ka një vlerësim A+/Stable nga "Standard and Poor's".

m) Analiza e sensitivitetit

Faktorët kryesorë të cilët ndikojnë në fitimin e Grupit janë niveli i dëmeve dhe shpenzimet.

	(Humbja)/Fitimi	Kapitali Neto	Fondi i Garancisë i kërkuar
Situata më 31 dhjetor 2019			
Aktual	37,491,384	493,747,071	370,000,000
Rritje në dëmet e ndodhura	(6,484,062)	487,263,009	370,000,000
Rritje në shpenzime (+10%)	(10,938,459)	476,324,551	370,000,000
Situata më 31 dhjetor 2018			
Aktual	12,954,298	465,590,753	370,000,000
Rritje në dëmet e ndodhura	(6,927,062)	458,663,691	370,000,000
Rritje në shpenzime (+10%)	(11,848,056)	446,815,635	370,000,000

Tabela më sipër paraqet një simulim, duke marrë në konsideratë ndryshime drastike për dëmet e ndodhura ose rritje në shpenzime dhe efekti i saj në kapitalin neto të Grupit dhe aftësinë paguese në dispozicion. Për qëllime të simulimit, modeli përdor një rritje të dëmeve të barabartë me dëmin më të madh të ndodhura gjatë dy viteve të fundit dhe një rritje të shpenzimeve administrative prej 10%.

4. MENAXHIMI I RREZIQEVE TË SIGURIMIT DHE FINANCIAR (vazhdim)

n) Menaxhimi i kapitalit

Objektivat kryesore të Grupit kur menaxhon kapitalin janë përputhshmëria me kërkesat nga entet rregullatore Shqiptare për tregun e sigurimit duke mbajtur kapital mbi limitin e kërkuar; ruajtjen e aftësisë për vijimësinë e aktivitetit të Grupit në mënyrë që të mund të vazhdojë të gjenerojë fitime për aksionaret dhe përfitime për përfituesit e tjerë. Enti rregullator i Grupit Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare Shqiptare vendos dhe monitoron kërkesat për kapitalin në mënyrë që të mbajë në çdo kohë kapitalin e sigurimit për sigurimin e jetës dhe jo-jetës i cili të paktën është i barabartë me nivelin e detyrueshëm të aftësisë paguese për sipërmarrjen siguruese. Në përputhje me ligjin shqiptar për sigurimin, kapitali rregullator përbëhet nga kapitali bazë dhe kapitali shtesë.

Kapitali bazë përfshin:

- kapitalin e paguar;
- rezervën e sigurimit e cila nuk i përket drejtpërsëdrejti kontratave efektive të sigurimit
- ose atyre të cilat kanë qenë efektive;
- rezervat statutore;
- fitimin e vitit aktual dhe të akumuluar;
- Kapitali bazë nuk përfshin:
- kapitalin e papaguar;
- aktivet e patrupëzuara;

Kapitali bazë nuk përfshin kontributet në natyrë dhe nuk duhet të jetë më i vogël se fondi i garancisë së përcaktuar. Fondi i garancisë është 370 milion lekë.

- Kapitali shtesë përfshin:
- Kapitalin e paguar në bazë të aksioneve preferenciale;
- Borxhin e varur;
- Letra me vlerë të vazhdueshme

Grupi mund t'i investojë aksionet e tij në aktive të qëndrueshme dhe aktive financiare. Ekspozimi i Grupit me një bankë të vetme është e rregulluar me akte ligjore vetëm për investimin e fondit të Garancisë në limitin 25% të Fondit te garancisë, megjithatë shoqëria mëmë është përpjekur të ruajë diversifikimin e investimeve në banka të ndryshme në nivelin 30% të kapitalit rregullator dhe 10% për institucionet jo-bankare edhe për investimet financiare në tërësi.

o) Mjaftueshmëria e kapitalit

Shoqëria mëmë SiCRED Sh.a ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me ligjin Nr. 52/2014 datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit". Sipas neneve 75-80 të ligjit të mësipërm Shoqëria llogarit mjaftueshmërinë e kapitalit që përbën dhe aftësinë paguese të saj. Aftësia paguese përbëhet nga aktivet e shoqërisë së sigurimit të lira nga çdo përgjegjësi e parashikueshme, duke zbritur prej tyre elementët e zbritshëm sipas Rregullores së Bordit te Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare Nr. 87 datë 27 qershor 2016. Me date 31 dhjetor 2019 Shoqëria rezultoi me mjaftueshmëri kapitali në vlerën + 59,251,386 lekë.

5. PERDORIMI I LLOGATITJEVE DHE GJYKIMIT

Grupi bën vlerësime dhe supozime që influencojnë shumat e raportuara të aktiveve dhe detyrimeve gjatë një viti fiskal. Vlerësimet dhe gjykimet janë vlerësuar rregullisht dhe janë bazuar në informacionet e tregut dhe faktorë të tjerë, duke përfshirë pritshmëritë e ngjarjeve të ardhshme që besohet të jenë të arsyeshme nën rrethana të caktuara.

(i) Vlerësimi i drejtimit për vijimësinë e aktivitetit

Pasqyrat financiare janë përgatitur duke u bazuar në parimin e vijimësisë.

5. PERDORIMI I LLOGATITJEVE DHE GJYKIMIT (vazhdim)

Gjatë muajve të parë të viti 2020, situata e krijuar nga pandemia globale Covid-19 pati efekt në aktivitetin ekonomik të vendit. Grupi ka marrë masat për drejtimin e situatës duke orientuar të gjitha palët e interesuara në përdorimin e platformave online dhe jo vetëm, gjithsesi shoqëria mëmë është përballur me një rënie të të ardhurave në 3-mujorin e parë të vitit. Ajo vlerëson që kjo situatë mund të ketë një impakt financiar me rënie të të ardhurave me rreth 5-20%, shumë kjo që në gjykimin e drejtimit mund të amortizohet deri në fund të vitit 2020. Shoqeria mëmë sipas raportit të shitjeve faktike të realizuara gjatë periudhës janar – mars 2020, ka pësuar një rënie të të ardhurave mesatarisht me rreth 21,58 % krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2019. Gjithashtu gjendja e aftësisë paguese si me 31/12/2019 dhe gjendja e likuiditetit gjate muajve mars-prill 2020, janë një tregues sipas të cilëve në një periudhë afatmesme Grupi nuk parashikon një rrezik të papërballueshëm të situatës financiare.

(i) Llogaritja e detyrimit nga sigurimi

Shiko shënimin 3.d.

(ii) Përcaktimi i vlerës së drejtë

Politika kontabël e Grupit për matjen e vlerës së drejtë është diskutuar në politikën kontabël 3.f.(vi). Grupi e mat vlerën e drejtë duke përdorur hierarkinë e mëposhtme të vlerës së drejtë e cila reflekton rëndësinë e inputeve në bërjen e matjeve:

-Niveli 1: Çmimet e tregut të kuotuara (të pakorrigjuara) në një treg aktiv për instrumente identik.

-Niveli 2: Metoda vlerësimi të bazuara në të dhëna të vëzhgueshme, ose në mënyrë të drejtpërdrejte (për shembull çmimi) ose në mënyrë jo të drejtpërdrejtë (për shembull si rezultat i çmimit). Kjo kategori përfshin instrumente të vlerësuar duke përdorur: çmimet e kuotuara në tregje aktive për instrumente të njëjtë; çmimet e kuotuara për instrumente identik ose të njëjtë në treg që konsiderohen më pak aktive; ose metoda vlerësimi ku të gjithë të dhënat hyrëse janë në mënyrë të drejtpërdrejte ose në mënyrë jo të drejtpërdrejte të vëzhgueshme nga të dhënat e tregut.

-Niveli 3: Metoda vlerësimi duke përdorur të dhëna të rëndësishme të pavëzhgueshme. Kjo kategori përfshin të gjithë instrumentet ku metoda e vlerësimit merr parasysh faktorë jo të bazuar në të dhëna të vëzhgueshme dhe të dhëna të pavëzhgueshme të cilat kanë një efekt të rëndësishëm në vlerësimin e instrumentit. Kjo kategori përfshin instrumente të cilat janë vlerësuar në bazë të çmimeve të kuotuara për instrumente të njëjtë ku korrigjime të pavëzhgueshme të konsiderueshme ose supozime janë të detyruara që të reflektojnë diferencat midis instrumenteve.

Metodat e vlerësimit përfshijnë vlerën aktuale neto dhe modelet e skontuara të flukseve të parasë, krahasime me instrumente të njëjtë për të cilat ekzistojnë çmime të vëzhgueshme në treg dhe të bazuara në ecurinë aktuale të "yield"-it të përshtatshme për pjesën e mbetur të maturitetit. Supozimet dhe faktorët e përdorur në metodat e vlerësimit përfshijnë norma interesi pa rrezik dhe të tregut, normat e kredidhënies dhe prime të tjera të përdorura në llogaritjen e normave të skontuara, obligacionet dhe çmimi i kapitalit, kurset e këmbimit, çmimi i kapitalit dhe çmimi i indeksuar i kapitalit dhe luhatjet e pritshme dhe të lidhura me njëra tjetrën. Objektivi i metodave të vlerësimit është që të arrijë në përcaktimin e vlerës së drejtë e cila reflekton çmimet e instrumenteve financiarë në datën e raportimit, që do të ishin përcaktuar nga pjesëmarrësit në treg duke vepruar në kushte normale tregu.

6. PARAQITJA E VLERES SE DREJTE

Vlerësimet e vlerës së drejtë janë bazuar në paraqitjen e pozicionit financiar të instrumenteve ekzistuese financiare pa u përpjekur të vlerësojnë vlerën e biznesit të pritshëm dhe vlerën e aktiveve dhe pasiveve që nuk konsiderohen instrumente financiarë.

Mjete monetare dhe ekuivalentet me to dhe Depozitat me afat ne banka – të cilat përfshijnë mjetet monetare në bankë dhe depozita me afat. Duke qenë se depozitat kanë detyrim te mbetur me pak se një vit dhe me norma te luhatshme vlera e tyre e drejtë konsiderohet e përafërt me vlerën kontabël.

Letrat me vlerë - Investimet në bonot janë aktive që fitojnë interes dhe janë të mbajtura deri në maturim. Për shkak se nuk ekziston një treg aktiv për këto letra me vlerë, vlera e drejtë është vlerësuar duke përdorur një model të skontimit të rrjedhjeve të parasë bazuar në një kurbë të normës së kthimit aktual të përshtatshme për afatin e mbetur deri në maturim.

6. PARAQITJA E VLERES SE DREJTE (vazhdim)

Të arkëtueshme nga sigurimet dhe të tjera të arkëtueshme - Vlera e drejtë e të arkëtueshmeve nga sigurimet dhe të tjera të arkëtueshme, është afërsisht e barabartë me vlerën kontabël, për shkak të maturitetit të shkurtër të tyre.

Aktive të tjera – Vlera e drejtë e aktiveve të tjera, është përafërsisht e barabartë me vlerën kontabël

Parapagim i tatim fitimit – Vlera e drejtë është përafërsisht e barabartë me vlerën kontabël, për shkak të maturimit të tyre afatshkurtër.

Llogari të pagueshme nga sigurimet dhe të tjera të arkëtueshme - Vlera e drejtë është afërsisht e barabartë me vlerën kontabël, për shkak të maturitetit të shkurtër të tyre.

Detyrime ndaj institucioneve te kreditit - Vlera e drejtë është afërsisht e barabartë me vlerën kontabël, për shkak të maturitetit të shkurtër të tyre dhe normave variabël.

Detyrime të tjera – Vlera e drejtë e detyrimeve të tjera, është përafërsisht e barabartë me vlerën kontabël.

	Të mbajtura deri në maturim	Kreditë dhe të arkëtueshmet	Totali i vlerës kontabël	Vlera e drejtë
31 dhjetor 2019				
Mjete monetare dhe ekuivalente	-	29,046,016	**29,046,016**	**29,046,016**
Depozita me afat	-	404,355,990	**404,355,990**	**404,355,990**
Letra me vlere	148,846,354		**148,846,354**	**154,038,968**
Fond Investimi		15,141,330	**15,141,330**	**15,141,330**
Te arkëtueshme nga sig. dhe risig.		35,592,371	**35,592,371**	**35,592,371**
Aktive te tjera		8,437,873	**8,437,873**	**8,437,873**
Llogari te pagueshme sig. dhe risig.		(11,853,170)	**(11,853,170)**	**(11,853,170)**
Detyrime ndaj institucioneve te kreditit		(3,198,735)	**(3,198,735)**	**(3,198,735)**
Detyrime te tatim fitimit		114,001	**114,001**	**114,001**
Detyrime te tjera		(14,746,045)	**(14,746,045)**	**(14,746,045)**
31 dhjetor 2018				
Mjete monetare dhe ekuivalente me to	-	38,193,393	**38,193,393**	**38,193,393**
Depozita me afat	-	381,738,817	**381,738,817**	**381,738,817**
Investime në letra me vlerë	139,193,922	-	**139,193,922**	**145,814,557**
Të arkëtueshme nga sigurimi dhe risigurimi		43,030,129	**43,030,129**	**43,030,129**
Parapagim i tatim fitimit		1,020,748	**1,020,748**	**1,020,748**
Aktive të tjera		14,380,303	**14,380,303**	**14,380,303**
Llogari të pagueshme sigurimi dhe risigurimi		(9,317,518)	**(9,317,518)**	**(9,317,518)**
Detyrime ndaj institucioneve të kreditit		(359,531)	**(359,531)**	**(359,531)**
Detyrime të tjera		(19,392,845)	**(19,392,845)**	**(19,392,845)**

7. INFORMACION MBI GRUPIN

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit përfshijnë:

Emri	Aktivitetet kryesore	Vendi i themelimit	Periudha e konsolidimit		% interesit të kapitalit	
			31/12/2019	31/12/2018	31/12/2019	31/12/2018
Credins Invest	Kompania e administrimit të fondit vullnetar të pensionit	Shqipëri	-	-	12%	12%
SiCRED Assistance	Shërbime menaxhimi dhe konsulence	Shqipëri	01/01/2019 31/12/2019	01/01/2018 31/12/2018	100%	100%

Me datë 16.11.2016 është lidhur kontrata e blerjes nga SiCRED sha të aksioneve ne Credins Invest te zotëruara me pare nga KURUM Internacional sha. Blerja e aksioneve është miratuar nga AMF me datë 28.04.2017 dhe regjistruar në QKB me datë 16.05.2017. Pas këtij regjistrimi SiCRED sha zotëron 24% të aksioneve të Credins Invest. Me vendimin Nr.12 datë 15.10.2018 dhe Nr.14 datë 13.12.2018 të Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë SiCRED sha është miratuar shitja e kuotave aksionare të SiCRED sha në Shoqërinë Administruese të Fondit të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive CREDINS INVEST sh.a., në masën 12%. Sipas Vendimit Nr. 3, Datë 26.12.2018, të Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë Credins Invest u miratua ndryshimi i nenit 5 të Statutit "Kapitali i Shoqërisë".
Ndryshimet konsistojnë në pjesëmarrjen aksionare të SiCRED sh.a. dhe aksionarët e rinj të Shoqërisë, respektivisht SiCRED sh.a. bëhet zotërues në 12.00 % të paketës aksionare.

8. MJETE MONETARE NE ARKE DHE BANKE

Mjetet monetare në arkë dhe bankë janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Mjete monetare në arkë	52,413	19,801
Mjete monetare në bankë		
Mjete monetare në bankë në monedhë të huaj	*19,228,826*	*19,196,990*
Mjete monetare në bankë në monedhë vendase	*5,367,901*	*17,429,941*
Nëntotali i mjeteve monetare në bankë	24,596,727	36,626,931
Mjete monetare në arkë dhe bankë	**24,649,140**	**36,646,732**
Balancat e kushtëzuara	4,396,876	1,546,661
Totali	**29,046,016**	**38,193,393**

Më 31 dhjetor 2019, balanca e kushtëzuar për vlerën 4,296,876 Lekë (2018: 1,446,661 Lekë) lidhet me garancinë bankare që Grupi ka vendosur për sigurimin e kontratës së Sigurimit të Jetës të punonjësve të Bankës së Shqipërisë, në bashkëpunim me Shoqërinë INSIG sh.a. e cila do të lirohet pas përfundimit të kontratës së sigurimit, 12 Prill 2022, dhe për 100,000 lekë lidhet me Fond garancie për SiCRED Asistence për licenca shtesë të lidhura me aktivitetin.

Mjetet monetare në bankë në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Në EURO	19,194,028	19,159,211
Në USD	34,798	37,779
	19,228,826	**19,196,990**

9. DEPOZITAT ME AFAT

Depozitat me afat janë të përbëra si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Depozita Garancie	330,524,500	310,248,001
Fond kursimi	57,964,265	49,314,065
Depozita të tjera	12,558,550	18,513,000
Interesi i përllogaritur	3,308,675	3,663,751
Totali	**404,355,990**	**381,738,817**

Depozitat e garancisë përfaqësojnë depozita të shprehura në lekë, euro, dollar me afat maturimi një vjeçar në banka lokale të cilat janë të kufizuara dhe mbahen si garanci në përputhje me kërkesat e përcaktuara nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare. Depozita të tjera lidhet me një depozitë të lirë me afat 1 vjeçar dhe konsiderohet si Aktiv në mbulim të provigjioneve.

10. LETRAT ME VLERE TE QEVERISE

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Bono Thesari (Fond Garancie)	43,820,000	60,000,000
Skonto për tu amortizuar	(248,739)	(430,615)
Bono thesari, neto	**43,571,261**	**59,569,385**
Obligacione	103,200,000	78,200,000
Interesi i llogaritur	2,075,093	1,424,537
Obligacione, neto	**105,275,093**	**79,624,537**
	148,846,354	**139,193,922**

Gjatë vitit 2019, Grupi nuk ka ndryshuar politikën për investimet në letrat me vlerë, në Bono Thesari dhe Obligacione.

Tabela më poshtë paraqet minimumin dhe maksimumin e normave të interesit që janë aplikuar për letrat me vlerë të mbajtura deri në maturim gjatë vitit 2018, sipas maturitetit të tyre:

	31 dhjetor 2019		31 dhjetor 2018	
Maturiteti	**Minimumi i Normës së interesit**	**Maksimumi i Normës së interesit**	**Minimumi i Normës së interesit**	**Maksimumi i Normës së interesit**
Bono Thesari Lekë				
12 muaj	1.30%	1.94%	1.50%	2.70%
Obligacione qeveritare Lekë				
3 vjet				
5 vjet	5.45%	6.45%	5.45%	6.45%
7 vjet	3.98%	7.80%	4.90%	7.80%
10 vjet	7.90%	7.90%	7.90%	7.90%

11. FONDE INVESTIMI

Me datë 08.07.2019, sipas kontratës së anëtarësimit në Fondin e Investimeve "Credins Premium" me Shoqërinë Administruese Credins Invest sh.a., është investuar për blerjen e 11,808.0307 kuota të Fondit të Investimit, me çmim për kuotë 1,270.3219 lekë me vlerë totale prej 15,000,000 lekë.
Me datë 31 dhjetor 2019, kuotat e blera të vlerësuara me çmimin e tyre në këtë datë paraqiten si më poshtë:

Fond investimi ne CREDINS Premium	31-Dec-19	31-Dec-18
Çmimi i kuotës	1,282.2909	-
Numri i kuotave të blera	11,808.0307	-
Vlera e investimit	**15,141,330**	**-**

12. TË ARKËTUESHMET NGA SIGURIMI DHE RISIGURIMI

Të arkëtueshmet nga sigurimi dhe sigurimi sipas llojeve të produkteve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Debitor Jetë dhe Aksidente në Grup	25,228,704	27,016,636
Debitor Cash Plan	3,437,527	3,791,265
Debitor Jeta për Hua	12,193,560	13,562,075
Debitor Jetë dhe Shëndet në Udhëtim	1,068,473	1,419,947
Debitor Jetë me Mbijetesë	2,664,630	1,341,450
Debitor Jetë Nxënësi e Studenti	-	1,728,200
Të arkëtueshme nga sigurimi, bruto	**44,592,894**	**48,859,573**
Provigjione për klientë të paarkëtuar	(9,000,523)	(5,829,444)
Të arkëtueshme nga sigurimi, neto	**35,592,371**	**43,030,129**

Lëvizjet në zhvlerësimin e të arkëtueshmeve nga sigurimi dhe risigurimi paraqitet më poshtë:

	2019	2018
Gjendja në fillim të vitit	5,829,444	5,006,292
Shtesa	3,171,079	823,152
Rimarrje	-	-
Gjendja në fund të vitit	**9,000,523**	**5,829,444**

Vjetërsia e të arkëtueshmeve nga sigurimi dhe risigurimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqitet në shënimin 5.c.

13. SHPENZIMET E MARRJES NE SIGURIM, TE SHTYRA

	31/12/2019	Ndryshimi për vitin	31/12/2018	Ndryshimi për vitin	31/12/2017
Jeta dhe shëndeti në udhëtim	275,816	(217,334)	493,150	(673,054)	1,166,204
JSHU jashtë vendit - Studentët	572	(16,315)	16,887	16,484	403
Sigurimi Jetë&Shëndet (Cash Plan)	21,156,205	8,945,838	12,210,367	(3,636,628)	15,846,995
Jetë vizitori	-	(1,076)	1,076	1,011	65
	21,432,593	**8,711,113**	**12,721,480**	**(4,292,187)**	**17,013,667**

14. AKTIVET E RISIGURIMIT

Shoqëria cedon primet e sigurimit dhe rrezikun në aktivitetin normal të biznesit për sigurimin e jetës në mënyrë që të limitojë potencialin e humbjeve që lindin nga ekspozime më të gjata dhe më të ashpra të dëmeve. Këto risigurime përfshijnë bazat e marrëveshjeve, tejkalimin e humbjeve dhe pjesë të aksioneve. Shoqëria cedon sigurim ndaj shoqërive të tjera dhe këto kontrata risigurimi nuk e përjashtojnë shoqërinë nga detyrimi ndaj policëmbajtësve. Kështu që, ekziston një ekspozim kredie në lidhje me risigurimin e ceduar deri në masën që një risigurues nuk është në gjendje që të përmbushë detyrimet e tij sipas marrëveshjes risiguruese. Shoqëria nuk mban kolateral sipas marrëveshjeve risiguruese. Më 31 dhjetor 2019, shuma prej 9,849,108 lekë (2018: 8,663,205 lekë) paraqet pjesën e risiguruesit për detyrimet për primin e pafituar Jetë për Hua, Jetë dhe Shëndet në Udhëtim, Jetë dhe Aksidente në Grup dhe Jetë me Mbijetesë. Lëvizjet e aktiveve të risigurimit për 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Në fillim të vitit	8,663,205	10,702,165
Ndryshimi për vitin	1,185,903	(2,038,960)
Totali	**9,849,108**	**8,663,205**

15. AKTIVE TE TJERA

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Shpenzime të parapaguara	1,403,157	2,177,700
Inventari i policave	2,912,469	2,927,517
Inventari i materialeve të tjera	63,620	36,380
Paradhënie e punonjësve	626,250	56,100
Të drejta për t'u arkëtuar nga rimbursime	7,221,726	7,258,606
Investime në pjesëmarrje	0	620,614
Debitorë të tjerë	4,208,992	4,922,481
Aktive të tjera, bruto	**16,436,214**	**17,999,398**
Zhvlerësimi i debitorëve të tjerë	(3,619,095)	(3,619,095)
Aktive të tjera, neto	**12,817,119**	**14,380,303**

16. INVESTIME NE FILIALE DHE PJESEMARRJE

Me vendimin Nr.12 datë 15.10.2018 dhe Nr.14 datë 13.12.2018 të Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë SiCRED sha u miratua shitja e kuotave aksionare të SiCRED sha në Shoqërinë Administruese të Fondit të Pensionit dhe Sipërmarrjeve të Investimeve Kolektive CREDINS INVEST sh.a., në masën 12%. Sipas Vendimit Nr. 3, Datë 26.12.2018 të Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë Credins Invest u miratua ndryshimi i nenit 5 të Statutit "Kapitali i Shoqërisë". Ndryshimet konsistojnë në pjesëmarrjen aksionare të SiCRED sh.a. dhe aksionarët e rinj të Shoqërisë, respektivisht SiCRED sh.a. bëhet zotërues në 12.00 % të paketës aksionare.

Grupi ka arritur në përfundimin se ka ndikim të konsiderueshëm kundrejt të investuarit në përfundim të të dyja periudhave raportuese, duke marrë për bazë se ai përfaqësohet në Bordin Mbikëqyrës dhe komitetet e tjera të brendshme të të investuarit si dhe Drejtori i Përgjithshëm i Shoqërisë SiCRED sha është aksionar ne shoqërinë Credins Invest duke zotëruar 3.5% te aksioneve.

Investimi i Grupit në Credins Invest paraqitet në pasqyrat financiare te konsoliduara si një investim në pjesëmarrje dhe kontabilizohet duke përdorur metodën e kapitalit neto. Tabela më poshtë ilustron informacionin financiar të

16 INVESTIME NE FILIALE DHE PJESEMARRJE (vazhdim)

përmbledhur të investimit të Grupit në Credins Invest më 31 dhjetor 2019 dhe më 31 dhjetor 2018:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Aktivet afatshkurtra	30,849,247	16,017,613
Aktivet afatgjata	29,503,807	27,353,906
Detyrimet afatshkurtra	(3,437,242)	(2,360,245)
Detyrimet afatgjata	(4,244,512)	-
Kapital	**52,671,300**	**41,011,274**
Pjesa e kontrollit në pjesëmarrje	12%	12%
Vlera kontabël e investimit të Grupit	**6,320,556**	**4,921,353**

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2018
Të ardhurat	54,795,605	34,212,285
Shpenzimet administrative	(42,826,727)	(29,908,329)
Shpenzime financiare	49,379	24,397
Fitimi para tatimit	**12,018,257**	**4,328,353**
Shpenzimi i tatim fitimit	(358,231)	-
Humbja për periudhën	**11,660,026**	**4,328,353**
Humbja Gjithëpërfshirëse për periudhën	-	-
Humbja Gjithëpërfshirëse neto për periudhën	**11,660,026**	**4,328,353**
Përqindja e investimit në pjesëmarrje	*12%*	*24%*
Përqindja e Grupit në humbje për periudhën	**1,399,203**	**1,038,805**

Diferenca në vlerën kontabël të investimeve të aktiveve neto për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 është paraqitur më poshtë, duke treguar ndryshimin në humbjen e grupit për çdo periudhë dhe çdo fitim / humbje nga ndryshimi në vlerën kontabël neto të investimit në pjesëmarrje:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Balanca në fillim të periudhës	4,921,353	8,803,901
Balanca në fund të periudhës	6,320,556	4,921,353
Diferenca në vlerën kontabël të investimeve të aktiveve neto	**1,399,203**	**(3,882,548)**
Pjesa e Fitimit / Humbjes së grupit për periudhën	*1,399,203*	*1,038,805*
Fitimi / Humbje nga ndryshimi në vlerën kontabël neto të investimit në pjesëmarrje	-	*(4,921,353)*

Gjatë vitit 2019, Grupi nuk ka investuar fonde shtesë në Credins Invest për rritje kapitali por ne vitin 2018 Shoqëria SiCRED sha ka shitur 12% të aksioneve që zotëronte pranë Credins Invest, vlera kontabël e të cilave është 13,927,823 lekë (shënimi 8) e cila pakësohet në vlerën kontabël të investimeve të aktiveve neto më 31 dhjetor 2019:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Vlera kontabël e grupit të investimit	6,320,556	4,921,353
Shtesë: Pagesë për shtese kapitali	-	-
Shuma totale kontabël e Investimit në Pjesëmarrje	**6,320,556**	**4,921,353**

17. AKTIVE TË PATRUPËZUARA NË PROCES

Grupi ka lidhur një kontratë për program kompjuterik të integruar me Subjektin "Infosoft SD" shpk me vlerë fillestare totale 6,666,000 lekë e cila është amenduar me datë 22.10.2019 për shërbime shtesë në vlerë 400,000 lekë dhe me datë 31 dhjetor 2019 vijon të jetë akoma në stad zhvillimi. Sipas fazave të përcaktuara në kontratë janë faturuar në vlerë 6,732,700 lekë që përfaqëson Aktivet e patrupëzuara në proces (2018:6,332,700 leke).

18. AKTIVET E TRUPEZUARA

	Pajisje zyre informatike	Mobilje dhe pajisje	Automjete	Automjete me qira financiare	Ndërtesa të përkohshme (Kioska)	Vepra arti	Instalime të përgjithshme	Rikonstruksion i ambienteve me qira	Aktive ne përdorim (ambiente me qira)	Totali
Kosto										
Gjendja 01/01/2018	**21,610,363**	**22,549,497**	**15,163,586**	**-**	**753,496**	**258,313**	**574,380**	**51,318,919**	**-**	**112,228,554**
Shtesa	389,048	247,004	-	-	-	-	-	-	-	636,052
Pakësime	(433,600)	(756,179)	-	-	-	-	-	-	-	(1,189,779)
Shitje	(159,996)	(586,565)	-	-	(325,000)	-	-	-	-	(1,071,561)
Gjendja 31/12/2018	**21,405,815**	**21,453,757**	**15,163,586**	**-**	**428,496**	**258,313**	**574,380**	**51,318,919**	**-**	**110,603,266**
Shtesa	1,328,454	168,292		4,247,012		44,355		314,760	87,444,137	93,547,010
Pakësime	(2,328,077)	(207,842)	-	-	-	-	-	-	-	(2,535,919)
Shitje	-	-	(3,428,000)	-	-	-	-	-	-	(3,428,000)
Gjendja 31/12/2019	**20,406,192**	**21,414,207**	**11,735,586**	**4,247,012**	**428,496**	**302,668**	**574,380**	**51,633,679**	**87,444,137**	**198,186,357**
Amortizimi i akumuluar										
Gjendja 01/01/2018	**14,166,340**	**13,310,782**	**11,001,612**	**-**	**247,427**	**-**	**410,701**	**22,795,494**	**-**	**61,932,356**
Ndryshimet e periudhës	1,887,688	1,853,306	832,395	-	20,115	-	32,736	3,558,495	-	8,184,735
Pakësimet	(498,752)	(1,155,473)	-	-	(122,662)	-	-	-	-	(1,776,887)
Gjendja 31/12/2018	**15,555,276**	**14,008,615**	**11,834,007**		**144,880**	**-**	**443,437**	**26,353,989**	**-**	**68,340,204**
Ndryshimet e periudhës	1,511,655	1,497,920	616,518	465,869	14,181	-	26,189	3,310,952	11,223,321	18,666,605
Pakësime	(1,987,976)	(189,905)	(3,078,649)			-	-	-		(5,256,530)
Gjendja 31/12/2019	**15,078,955**	**15,316,630**	**9,371,876**	**465,869**	**159,061**	**-**	**469,626**	**29,664,941**	**11,223,321**	**81,750,279**
Vlera e mbetur										
Gjendja 31/12/2017	**7,444,023**	**9,238,715**	**4,161,974**	**-**	**506,069**	**258,313**	**163,679**	**28,523,425**	**-**	**50,296,198**
Gjendja 31/12/2018	**5,850,539**	**7,445,142**	**3,329,579**	**-**	**283,616**	**258,313**	**130,943**	**24,964,930**	**-**	**42,263,062**
Gjendja 31/12/2019	**5,327,237**	**6,097,577**	**2,363,710**	**3,781,143**	**269,435**	**302,668**	**104,754**	**21,968,738**	**76,220,816**	**116,436,078**

19. DETYRIME PËR QIRA TE AKTIVEVE NE PERDORIM

Duke filluar nga data 01 Janar 2019, Grupi aplikoi SNRF 16 për Qiratë duke njohur një aktiv me të drejtë përdorimi si dhe një detyrim për qiratë e klasifikuara më parë si qira e zakonshme për ambientet në përdorim. Matja fillestare është bëre me vlerën aktuale të pagesave të qirasë të cilat nuk janë paguar deri në këtë datë, duke përdorur një normë skontimi prej 5% për të gjitha kontratat e qirave. Gjatë vitit Grupi ka llogaritur dhe njohur në Pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve vlerën e interesit të llogaritur dhe vlerën e amortizimit për Aktivin me të drejtë përdorimi. Gjithashtu, vlera e aktivit në përdorim dhe e detyrimit për qira është rregulluar për kontratat që kanë parashikuar modifikime në pagesat e detyrimeve.

Detyrimet për qira të aktiveve në përdorim analizohen si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrime për qira (për ambiente)	87,444,137	-
Interesi i llogaritur	3,813,972	-
Pagesa e detyrimit	(13,862,537)	-
	77,395,572	**-**

Angazhimet e shoqërisë si qiramarrës, referuar kontratave për përdorimin e aktiveve, paraqitur me vlerë të paskontuar me 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Jo më shumë se 1 vit	13,560,210	13,138,297
Më shumë se 1 vit por më pak se 5 vjet	50,443,153	52,567,094
Më shumë se 5 vjet	28,750,795	41,340,996
	92,754,158	**107,046,387**

20. DETYRIME TE TJERA

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Furnitorë	8,921,238	7,149,344
Kontributet shoqërore dhe tatimi	2,712,458	2,060,529
Taksa të tjera të ndryshme nga tatime	183,609	410,601
Kreditorë të tjerë	2,928,740	9,873,452
-Parapagime Banka Credins	-	*6,765,610*
-Parapagime nga individë ne vlerësim risku	*448,500*	*809,706*
-Kreditorë të tjerë	*2,480,240*	*2,298,136*
	14,746,045	**19,493,926**

21. LLOGARI TE PAGUESHME NGA SIGURIMI DHE RISIGURIMI

Detyrimet nga sigurimi dhe sigurimi për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrime nga veprimtaria sigurimit	9,061,808	8,223,567
Detyrime nga veprimtaria risigurimit	2,791,362	1,093,951
	11,853,170	**9,317,518**

22. DETYRIME NDAJ INSTITUCIONEVE TE KREDITIT

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Furnitorë për qira financiare	2,813,363	-
Llogari të zbuluara (Overdraft)	385,372	359,531
	3,198,735	**359,531**

Gjatë vitit 2019, Shoqëria Mëmë ka blerë dy autovetura me qira financiare pranë Bankës Credins sipas Aktmarrëveshjeve përkatëse me Nr. 325 datë 06.02.2019 dhe Nr. 1613 datë 04.07.2019, me afat 36 muaj dhe me normë interesi Libor i euros 1 vjeçare +5% por jo më pak se 6%.

Teprica me datë 31 dhjetor 2019 prej 385,372 lekë përfaqëson tepricën e zbuluar të llogarisë së kartës së kreditit MasterCard Business referuar kontratës së overdraftit Nr.6204 / Datë 18.03.2019 me afat 12 mujor, me limit 15,000 euro dhe me normë interesi mbi balancën debitore të pjesës së përdorur Libor i Euros 12 mujore + 4.87 % me bazë vjetore. Njëkohësisht në këtë datë është bllokuar si kolateral për overdraftin depozita me afat me nr. 946791, me vlerë 2,557,288.36 Lekë.

23. DETYRIMET PËR HUMBJET DHE RREGULLIMI I SHPENZIMEVE PËR HUMBJEN

Lëvizjet e detyrimeve për humbjen dhe rregullimi i shpenzimeve për humbjen është si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrimet bruto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes	15,621,509	19,416,002
Risigurimi i rikupereueshëm	-	-
Detyrimet neto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes	**15,621,509**	**19,416,002**
Humbjet dhe shpenzimi i rregullimit të humbjes të ndodhura	(47,424,563)	(58,535,217)
Humbjet dhe shpenzimi i rregullimit të humbjes të paguara	62,233,557	54,740,724
Detyrimet neto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes më 31 dhjetor	**30,430,503**	**15,621,509**
Risigurimi i rikupereueshëm		
Detyrimet bruto të sigurimit për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes	**30,430,503**	**15,621,509**

Vonesa të konsiderueshme ndodhin në njoftimin e dëmeve dhe një masë e konsiderueshme e përvojës dhe gjykimit përfshihet në vlerësimin e detyrimeve të papaguara të sigurimit, kostot përfundimtare të të cilave nuk mund të vlerësohen me siguri në datën e raportimit. Detyrimet e sigurimit për humbjet dhe shpenzimet për rregullimet nga humbjet përcaktohen mbi bazën e informacionit në dispozicion; gjithsesi, është e natyrshme në natyrën e biznesit që detyrimet përfundimtare mund të variojnë si rezultat i zhvillimeve të mëvonshme. Më 31 dhjetor 2019 Shoqëria ka 229 dëme të pazgjidhura (2018: 187) shumica e të cilave kanë të bëjnë me Sigurim Jete Cash Plan (176) dhe Jeta dhe Shëndeti në Udhëtim (23), për të cilat duhet më shume kohë për investigim.

Numri i dëmeve Pezull	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Sigurimi i Jetës për Hua	16	18
Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit në Udhëtim	23	25
Sigurimi i Jetës dhe Aksidenteve	13	9
Sigurimi i Jetës “Cash Plan”	176	130
Sigurimi i Jetës me Kursim	1	5
Të tjera	-	-
Totali	**229**	**187**

23. DETYRIMET PËR HUMBJET DHE RREGULLIMI I SHPENZIMEVE PËR HUMBJEN (vazhdim)

Rezervat për humbjet dhe shpenzimin e rregullimit të humbjes sipas produkteve për vitin që mbyllet më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Provigjione dëme pezull për Jeta për Hua	10,198,169	5,387,695
Provigjione për dëme te Jeta dhe Shëndeti në Udhëtim	1,763,207	1,102,272
Provigjione për dëme Jetë dhe Aksident në Grup	4,441,283	1,294,784
Provigjione për dëme për Cash Plan	14,027,844	7,836,758
Provigjione për dëme për Vizitor	-	-
	30,430,503	**15,621,509**
Të raportuara por jo të paguara (RBNS)	17,832,768	14,875,957
Të ndodhura por jo të raportuara (IBNR)	11,568,684	745,552
Provigjione për trajtim dëmesh	1,029,051	-
	30,430,503	**15,621,509**

Humbja dhe shpenzimi për rregullimin e humbjes së paguar dhe asaj të ndodhur është si më poshtë:

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime për dëme	33,640,717	33,625,006
Shpenzime për dalje nga skema Jetë me Kursim	13,783,846	24,910,211
Shpenzim provigjioni për dëme	14,808,994	-
Rimarrje provigjioni për dëme	-	(3,794,493)
	62,233,557	**54,740,724**

24. REZERVA PER PRIMIN E PAFITUAR

	31/12/2019	Ndryshimi për periudhën	31/12/2018	Ndryshimi për periudhën	31/12/2017
Jeta për Hua	88,350,145	(17,591,499)	105,941,644	19,092,165	86,849,479
Jetë & Aksidente në Grup	6,753,337	(4,166,520)	10,919,857	(9,072,663)	19,992,520
Jeta & Shëndeti në Udhëtim	985,119	18,124	966,995	(827,165)	1,794,160
Jetë Nxënësi & Studenti	48,099	(174,647)	222,746	(119,831)	342,577
JSHU - Studenti Jashtë	57,109	(224,287)	281,396	241,114	40,282
Jeta & Shëndeti (Cash Plan)	37,821,900	5,628,659	32,193,241	(14,415,569)	46,608,810
Jeta me Mbijetesë (Endowment)	5,852,255	2,252,757	3,599,496	1,644,778	1,954,718
Jeta e Vizitorit	-	(17,895)	17,895	(3,908)	21,803
Total	**139,867,964**	**(14,275,308)**	**154,143,270**	**(3,461,079)**	**157,604,349**

25. REZERVA MATEMATIKORE E TE TJERA

Rezervat e tjera më 31 dhjetor 2019 në shumën 35,348,623 Lekë (2018: 37,267,672 Lekë) paraqesin rezervën për sigurimin e jetës të krijuar për produktin e Jetës me Kursim dhe Jetës me Mbijetesë. Për produktin e Jetës me Kursim Shoqëria kontabilizon të gjithë shumën e fondit të akumuluar deri në datën e raportimit.

	31/12/2019	Ndryshimi për periudhën	31/12/2018	Ndryshimi për periudhën	31/12/2017
Rezerva matematikore	35,180,045	(1,265,431)	36,445,476	(15,090,537)	51,536,013
UPR Sig. Jetë me Kursim	149,168	(286,998)	436,166	(100,420)	536,586
RBNS Sig. Jetë me Kursim	19,410	(366,620)	386,030	(542,037)	928,067
	35,348,623	**(1,919,049)**	**37,267,672**	**(15,732,994)**	**53,000,666**

26. KAPITALI AKSIONAR

a) Kapitali i paguar

Me 31 dhjetor 2019 struktura aksionare paraqitet si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Aleksandër Pilo	46.39%	46.30%
Renis Tërshana	30.16%	30.10%
Kristino Kromidha	4.05%	4.13%
Emi Santo	2.38%	2.37%
Egi Santo	2.38%	2.37%
Monika Milo	4.75%	4.74%
Maltin Kolkuti	4.75%	4.74%
Petraq Shomo	2.06%	2.10%
Arben Taipi	2.06%	2.10%
Artan Xhori	1.03%	1.05%
	100.00%	**100.00%**

Kapitali aksionar me 31 dhjetor 2019 është në vlerën 490.062.000 lekë (2018 - 490.062.000 lekë) dhe përbëhet nga 490.062 aksione me vlerë nominale prej 1,000 lekë për aksion.

Me vendimin Nr. 4, datë 06 mars 2018, Asambleja e Aksionarëve miratoi shtesë kapitali në vlerën 10,000,000 lekë e cila u arkëtua në vlerën 9,062,000 lekë. Me vendimin Nr. 7, datë 15 qershor 2018, Asambleja e Aksionarëve miratoi strukturën aksionare pas rritjes së kapitalit në vlerën 9,062,000 lekë dhe kapitali i nënshkruar dhe i paguar me 31 dhjetor 2018 është 490,062,000 lekë (2017: 481,000,000 Lekë). Vendimi Nr. 8, i datës 15 qershor 2018, i Asamblesë së Aksionarëve të Shoqërisë, është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit. Me vendimin Nr. 6, datë 31 Maj 2019, Asambleja e Aksionarëve miratoi rezultatin e vitit 2018, fitim 12,594,295 lekë si dhe destinimin e tij në mbulimin e humbjes së mbartur të vitit 2016 i cili është regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me 17 korrik 2019.

b) Fondi i Garancisë

Fondi i garancisë më 31 dhjetor 2019 dhe 2018 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Depozita me afat, fondi i garancisë	330,524,500	310,248,001
Bono thesari, fondi i garancisë	43,820,000	60,000,000
	374,344,500	**370,248,001**

Rezervat Ligjore dhe rezerva sigurimi

Me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr. 52/2014 datë 22.05.2014 "Për veprimtarinë e sigurimit dhe risigurimit" krijimi i rezervës ligjore dhe rezervës së sigurimit nuk është më e detyrueshme. Me Vendimin Nr. 7 datë 29 qershor 2017 nga Asambleja e Përgjithshme e Aksionarëve u vendos që rezerva ligjore dhe rezerva e sigurisë të krijuara nga vitet e mëparshme të destinohet për mbulimin e humbjes së vitit 2016.24.5 Dividendët e paguar.

c) Dividendët e paguar

Vendimi për shpërndarjen e dividendëve u takon aksionarëve dhe shpërndahen në përputhje me ligjin "Për Shoqëritë Tregtare" nr. 9901, datë 14 prill 2008 (ndryshuar). Duke qenë se Shoqëria rezultoi me humbje te mbartur nga vitet 2016-2017, Asambleja e Aksionarëve me vendimin Nr. 6 datë 31 Maj 2019 ka vendosur që fitimi i vitit 2018 të mbulojë humbjen e mbartur pjesërisht dhe si rrjedhojë gjatë vitit 2019 nuk ka pagesa për dividend.

27. PRIMET E SHKRUARA BRUTO

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2018
Prime nga Sigurimi Jetë për Hua	119,754,343	115,420,797
Prime nga Sigurimi Jetë dhe Aksidente në Grup	45,618,926	52,065,378
Prime nga Sigurimi Jetë dhe Shëndet (Cash Plan)	52,120,115	36,256,591
Prime nga Sigurimi Jetë dhe Shëndeti në Udhëtim	3,952,947	20,416,044
Prime nga Sigurimi i Jetës me Mbijetesë (Endowment)	25,950,595	17,196,935
Prime nga Sigurimi i Jetës me kursim (Fondi)	10,889,006	12,356,427
Prime nga Sigurimi i Jetës me Kursim	1,433,717	1,672,238
Prime nga Sigurimi Jetë Nxënësi dhe Studenti	(107,058)	1,619,300
Prime nga Sigurimi Jetë dhe Shëndet në Udhëtim St.Jashtë	53,222	425,209
Prime nga Sigurimi Jetë Vizitori	854	111,644
Prime nga Sigurimi Jetë e Kombinuar	58,294	107,506
	259,724,961	**257,648,069**

Me 6 mars 2019, Universiteti Luarasi ka kërkuar anulimin e policave Sigurimi Jetë Nxënësi dhe Studenti prerë me 01 prill 2018. Shuma e anuluar është në vlerën prej 129,058 lekë.

28. PRIMET E SHKRUARA CEDUAR RISIGURUESIT

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2018
Për sigurimin Jetë për Hua	11,987,692	10,530,543
Për sigurimin Jetë dhe Aksidente në Grup	-	1,558,163
Për sigurimin Jetë dhe Shëndet në Udhëtim	3,307,621	1,783,788
	15,295,313	**13,872,494**

29. TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET FINANCIARE

	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura financiare		
Të ardhura nga interesat e depozitave me afat	6,112,904	6,598,639
Të ardhura nga interesat e Obligacioneve	5,387,613	5,278,059
Të ardhura nga interesat e Bonove te Thesarit	828,129	1,393,935
Të ardhura/humbje nga shitja e aksioneve etj.	(133,459)	26,159
Totali 1	**12,195,187**	**13,296,792**
Te ardhura nga vlerësimi me vlerë të drejtë (F. Investimi)	141,330	-
Totali	**12,336,517**	**13,296,792**
Shpenzime financiare		
Shpenzime interesi	(151,801)	(40,980)
Shpenzime për interesa të Aktiveve në përdorim	(3,813,973)	-
Totali	**(3,965,774)**	**(40,980)**
Fitimi/(humbja) nga kursi i këmbimit		
Fitim nga kursi i këmbimit	14,123,831	19,026,009
Humbja nga kursi i këmbimit	(14,916,078)	(28,439,851)
Totali	**(792,247)**	**(9,413,842)**
Të ardhura financiare, neto	**7,578,496**	**3,841,970**

30. TE ARDHURA TE TJERA OPERATIVE

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2018
Të ardhura nga komisioni nga Risiguruesi	4,065,874	4,434,204
Të ardhura nga delegimi i shërbimeve	131,670	10,952
Të ardhura nga AMF (parapagime të kuotës)	270,682	850,427
Të ardhura të tjera operative	9,687,964	3,635,883
	14,156,190	**8,931,466**

Zëri "Të ardhura të ndryshme", kryesisht përbëhet nga të ardhurat e përfituara nga realizimi i pjesshëm i kontratës me Bankën Credins, kontratë kjo e lidhur më 06.06.2017 e cila konsiston në kryerjen e shërbimit të sigurimit të një kategorie të përcaktuar të klientëve të bankës, por jo vetëm, kundrejt një pagesë parapagimi të pakthyeshme në shumën prej 100,000 Eur. Kontrata ka përfunduar më 31/12/2018 dhe deri në atë datë shuma prej 54,818 Eur nuk është përdorur nga Banka Credins.

31. KOSTOT E MARRJES NE SIGURIM

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2018
Komisione	32,071,494	39,006,428
Shpenzime publiciteti	17,727,824	21,085,514
Shpenzime ekzaminimi	14,678,193	11,874,945
Shpenzime për policat	494,518	1,421,284
	64,972,029	**73,388,171**

Tek kostot e marrjes në sigurim, nën zërin e komisioneve janë përfshirë edhe shpërblim personeli që lidhen me shitjen e realizuar të kontratave të sigurimit në vlerën 812,565 lekë (2018: 3,612,038 lekë).

Kostot e marrjes në sigurim sipas çdo produkti për periudhën deri më 31 dhjetor 2019 dhe 31 dhjetor 2018 detajohen më poshtë:

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2018
Sigurimi i Jetës dhe Shëndetit Cash Plan	29,060,605	14,057,479
Sigurimi Jetë për Hua	14,049,311	20,340,040
Sigurimi Jetë dhe Shëndet në Udhëtim	1,123,302	10,607,526
Sigurimi Jetë dhe Aksidente në Grup	8,678,213	16,003,787
Sigurimi Jetë Nxënësi dhe Studenti	321,033	1,770,271
Sigurimi i Jetës me Kursim	166,883	780,617
Sigurimi i Jetës me Mbijetesë	11,572,056	9,798,023
Sigurimi Jetë dhe Shëndet në Udhëtim St. Jashtë	598	24,154
Sigurime Jete të tjera	27	6,275
	64,972,028	**73,388,172**

32. SHPENZIME PERSONELI

	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2019	Viti i mbyllur 31 dhjetor 2018
Shpenzime personeli		
- Paga	50,048,319	54,018,121
- Shpërblime	10,259,259	7,663,333
- Sigurime shoqërore	7,021,256	7,458,586
- Sigurim jete dhe kontribut për pensionin	3,126,489	3,921,116
- Shpërblim që lidhen me kontratat e sigurimit	(812,565)	(3,612,038)
	69,642,758	**69,449,118**

33. SHPENZIME ADMINISTRATIVE

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2018
Shpenzime qiraje	70,440	16,310,837
Shërbime të jashtme	3,840,307	3,794,395
Tarifa, tatime dhe gjoba	5,298,667	8,431,330
Ujë, energji dhe komunikim	3,765,156	3,967,818
Ruajtje objekti	1,953,252	2,942,031
Publicitet, reklama	3,012,917	3,936,442
Shpenz. pritje e dhurata	2,572,804	2,028,461
Transferime, udhëtim, dieta	2,431,306	1,517,586
Zhvlerësim për borxhin e keq	3,171,079	1,297,399
Të tjera	13,529,369	6,380,495
	39,645,297	**50,606,794**

Në zërin shpenzime administrative të tjera, gjatë vitit 2019 përfshihen edhe komisionet për rakordimin e pagesave/ arkëtimeve te primeve te sigurimit nga Banka OTP, të cilat bazuar në vendimmarrjen e drejtimit të ri të bankës kategorizohen si veprime operacionale dhe Shoqeria si rrjedhojë i ka kategorizuar si shpenzime operacionale dhe jo si kosto të marrjes në sigurim, siç janë paraqitur në vitin 2018.

34. SHPENZIME PER TATIMIN

	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2019	Viti mbyllur më 31 dhjetor 2018
Fitim/(Humbje) para tatimit	38,494,664	9,292,024
Shpenzimi i tatimit për vitin aktual (2018: 15%)	5,576,285	1,393,804
Efekti i tatimit për shpenzimet e pazbritshme	1,205,353	1,165,766
Efekti i tatimit në mosnjohjen e emrit të mirë	-	582,382
Diferenca të përkohshme të panjohura të tatimit		-
Përdorimi i humbjeve te mbartura	(5,874,891)	(3,141,952)
Shpenzimi i tatim fitimit	**906,747**	**-**

Në përputhje me rregulloret tatimore Shqiptare norma e aplikueshme për tatimin 2019 është 15% (2018: 15%). Deklarimet tatimore plotësohen çdo vit por fitimet ose humbjet e deklaruara për qëllim tatimi mbesin të provigjionuara deri kur autoritetet tatimore vlerësojnë kthimet dhe japin një vlerësim përfundimtar. Ligjet tatimore shqiptare janë subjekt i interpretimeve nga autoritete tatimore. Shpenzimet e pazbritshme për qëllim tatimi paraqesin shpenzime të cilat nuk janë të mbështetura me dokumentacion të përshtatshëm ose shpenzime të cilat nuk konsiderohen të klasifikueshme për qëllime fiskale.
Gjatë vitit 2018, Shoqëria Mëmë SiCRED sha ishte objekt kontrolli tatimor për vitet 2013-2017 dhe nga kontrolli rezultoi humbja fiskale e saj në vlerën 59,892,010 lekë:

- për vitin 2016 humbja fiskale është 54,343,852 lekë dhe
- për vitin 2017 humbja fiskale është 5,548,158 lekë.

Sipas Nenit 27 “Mbartja e humbjes” e Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Mbi tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, humbjet e rezultuara mund të mbulohen me fitimet në tri periudhat e ardhshme tatimore, sipas parimit ‘‘humbja e parë më përpara se ajo e fundit”, kështu që fitimi fiskal i rezultuar për vitin 2018 në vlerë 20,726,071 lekë mbuloi humbjes fiskale së vitit 2016 dhe humbja fiskale e mbartur në fund të vitit 2018 është 39,165,939 lekë.

35. ANGAZHIME DHE DETYRIME

Ligjore

Në aktivitetin normal të biznesit Grupit i raportohen çështje ligjorë të cilat janë të lidhura me sigurimin; menaxhimi i Grupit është i opinionit që nuk do të ketë humbje materiale të cilat do të lindin në lidhje me ndonjë nga këto çështje deri më 31 dhjetor 2019 dhe 2018.

Detyrime të kushtëzuara

Deri më 31 dhjetor 2019, Grupi nuk ka detyrime të kushtëzuara në pasqyrat e tij të konsoliduara që vijnë si rezultat i aktivitetit të tij.

Angazhimet kontraktuale me klientët

Grupi hyn në marrëveshje afatgjate me huamarrësit e Bankave të nivelit të dytë në Shqipëri për produktin e saj "Jete për hua", i cili mbulon rrezikun e mortalitetit të debitorëve gjatë periudhës së huamarrjes. Siç është detajuar në shënimin 3.d të pasqyrave financiare, Grupi rivlerëson primin vjetor të shkruar bruto të lëshuar gjatë periudhës raportuese. Pjesa e mbetur e primeve të shkruara bruto të kontraktuara që do të njihen në periudhat e ardhshme është një angazhim i ardhshëm që pritet nga klientët, përveç rasteve kur kontratat e huamarrjes anulohen ose paguhen herët. Primi bruto i shkruar që pritet të njihet në të ardhmen është si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Jo më shumë se 1 vit	59,019,592	31,715,740
Më shumë se 1 vit por më pak se 5 vjet	205,516,150	111,269,600
Më shumë se 5 vjet	265,782,870	360,957,506
	530,318,612	**503,942,846**

36. TRANSAKSIONE ME PALET E LIDHURA

Palët konsiderohen të jenë të lidhura nëse njëra nga palët ka mundësinë që të kontrollojë ose që të ketë influencë të rëndësishme mbi palën tjetër në marrjen e vendimeve financiare ose operacionale, ose palët janë nën kontroll të përbashkët me Grupin. Një numër transaksionesh janë kryer me palët e lidhura në aktivitetin normal të biznesit. Këto transaksione janë kryer me terma tregtare dhe në kushte tregu si më poshtë:

	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
Detyrime	**1,928,488**	**2,171,238**
Të pagueshme ndaj Fondit të Pensionit	1,928,488	2,171,238
	-	-
Te ardhura	**3,313,854**	**3,688,350**
Prime të shkruara, bruto	3,313,854	3,688,350
Dëme	**1,308,936**	**2,060,213**
Dëme të paguara	1,308,936	2,060,213
Shpenzimet administrative	**5,139,139**	**3,898,983**
Shpenzime për ambiente me qira	2,529,139	2,138,983
Shpenzime për shpërblime etj.	2,610,000	1,760,000
Shpërblimi i menaxhimit	**7,680,000**	**7,680,000**

37. NGJARJET PAS DATES SE BILANCIT

Gjatë fillimit të vitit 2020, globalisht u përhap pandemia e COVID -19. Në Shqipëri, impaktin masiv e pati prej muajit mars 2020, kur qeveria morri masa drastike duke pezulluar gjithë aktivitetet te cilat nuk ishin jetike. Shoqëria ka kryer procesin e vlerësimit dhe ka marre masat e nevojshme për parandalimin e ndikimeve negative në aktivitetet e saj. Ajo vlerëson që kjo situatë do të ketë një impakt financiar në ulje të të ardhurave mesatarisht me 5%-20%, nivel ky që pritet të amortizohet deri në fund të vitit. Drejtimi gjykon që aktiviteti i Shoqërisë në një periudhë afatmesme do të vijojë normalisht. Nuk ka pasur asnjë ngjarje tjetër pas datës së raportimit, e cila kërkon ndonjë paraqitje apo rregullim në pasqyrat financiare. Nuk ka ngjarje pas datës së bilancit që mund të kërkojë korrigjim ose shënime shtesë në pasqyrat financiare të shoqërisë.

Rrjeti i Degeve

Zyrat Qendrore SiCRED
Adresa: Njësia Bashkiake Nr.5, Rr. “Brigada VIII”, Vila Nr. 3/1, Tiranë
Tel: +355 4 22 37 549
Cel: + 355 69 20 84 026
Fax: +355 4 22 37 530
e-mail: contact@sicred.com.al
web: www.sicred.com.al

Dega Tiranë
Adresa: Njësia Bashkiake Nr.5, Rr. “Brigada VIII”, Vila Nr. 3/1, Tiranë
Tel: +355 4 22 37 549
Cel: + 355 69 20 84 026
Fax: +355 4 22 37 530
e-mail: shitje@sicred.com.al

Dega Durrës
Adresa: Lagjja Nr.3, Rr. “Rruga Tregtare”, (Blv. “Epidam”), Durrës
Tel/Fax: +355 52 90 66 35
Cel: +355 69 60 65 916
e-mail: durres@sicred.com.al

Dega Fier
Adresa: Lagjja “Konferenca e Pezës”, Rr. “Jakov Xoxa”, Fier
Tel/Fax: +355 33 60 10 60
Cel: +355 69 40 88 721
e-mail: fier@sicred.com.al

Dega Elbasan
Adresa: Hotel “Skampa”, Kati II, Elbasan
Cel: +355 69 70 10 736
e-mail: elbasan@sicred.com.al

Dega Vlorë
Adresa: Pallati “Riviera 2”, Kati II, Vlorë
Tel/Fax: +355 34 60 11 10
Cel: +355 69 70 76 621
e-mail: vlore@sicred.com.al



Dega Shkodër
Adresa: Lagjja “Parrucë”, Blv. Zogu I (pranë ish-MAPOs), Shkodër
Tel/Fax: +355 22 25 21 81
Cel: +355 69 60 65 917
e-mail: shkoder@sicred.com.al

Dega Gjirokastër
Adresa: Lagjja “18 Shtatori”, (Mbrapa Drejtorisë Tatimore Rajonale Gjirokastër), Gjirokastër
Tel: +355 84 26 90 19
e-mail: gjirokaster@sicred.com.al

Dega Korçë
Adresa: Rr. “Kristaq Grabocka”, (Mbrapa Bankës CREDINS), Kati I, Korçë
Tel/Fax: +355 82 50 01 00
Cel: +355 69 20 36 691
e-mail: korce@sicred.com.al